



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË OPERATORIN E SISTEMIT
TË TRANSMETIMIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Mbi Përputhshmërinë
Në Operatorin e Sistemit të Transmetimit SHA
Për Projektet:
“Ndërtim i Linjës së Transmetimit 400 Kv Shqipëri-Kosovë”
“Linja 400 Kv Shqipëri-Maqedoni”
“Ndërtimi i Linjës së Transmetimit me dy Qarqe 220 Kv Tiranë –Rrashbull dhe Unaza 110 Kv e
Tiranës, Loti 1 dhe Loti 2”

TIRANË 2024

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
II. HYRJA	9
1. Objektivat dhe qëllimi.....	9
2. Identifikimi i çështjes	9
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të auditur lidhur me çështjen nën auditim 10	
4. Përgjegjësitë e audituesve	10
5. Kriteret e vlerësimit	10
6. Standardet e auditimit të aplikuara.....	11
7. Metodatat e auditimit	11
8. Dokumentimi i auditimit.....	11
1. Informacioni i përgjithshëm.....	12
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT, SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:.....	13
3.1- Auditimi i zbatimit të detyrave të lëna në auditimet e mëparshme.....	13
3.2- Për marrëveshjen e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i tyre, lidhur me projektin/tet.....	28
3.3- Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve, kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.....	37
3.4- Mbi auditimin e zbatimit të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshjet me huadhënësit ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime.....	56
3.5- Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime.....	59
3.6- Mbi administrimin e veprave të dorëzuara, funksionimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve.	72
IV. REKOMANDIME.....	77
V. ANEKSE	82

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i institucionit.

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST SHA) është institucion publik në vartësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe ku parimet e përgjithshme, fusha e veprimit si dhe mënyra e funksionimit të tij janë të përcaktuara në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Statuti i Shoqërisë etj. Ky institucion funksionon mbi bazën e këtij ligji dhe akteve të dala në funksion të tij.

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST SHA) është një kompani publike me 100% të aksioneve në pronësi të shtetit. Bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, OST SHA ka përgjegjësinë të operojë, të mirëmbajë dhe të zhvillojë rrjetin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkuftare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike;

a- Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për dispeçerimin e energjisë elektrike nga centralet prodhuese dhe përdorimin e linjave të interkoneksionit, pa ndikuar në detyrimet kontraktore të furnizimit me energji elektrike, duke marrë parasysh realizimin e të gjitha shërbimeve ndihmëse që lidhen me qëndrueshmërinë e sistemit si dhe shkëmbimet me sistemet e tjera.

OST SHA zhvillon sistemin e transmetimit në përputhje me kërkesat afatgjata të furnizimit të vendit me energji elektrike, me planet e zhvillimit të burimeve të reja të energjisë elektrike dhe koordinon zhvillimin e rrjetit të interkoneksionit me vendet fqinje.

Një rol i rëndësishëm është dhe ai i Operatorit të Tregut të energjisë elektrike, funksionet e të cilit po zgjerohen gradualisht me hapat që po hidhen për krijimin e nje tregu të lirë të energjisë elektrike në Shqipëri, si dhe integrimin e këtij tregu në tregun rajonal të energjisë elektrike.

b- Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim.

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditori, Operatorin e Sistemit të Transmetimit, për periudhën prej fillimit të projekteve deri më datë 31.12.2024, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me efektivitetin e përdorimit të fondeve të kredive si dhe zbatimin e përcaktimeve në Marrëveshjet e Kredisë për projektet:

- “Ndërtim i linjës së transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë”;

- “Linja 400 kV Shqipëri Maqedoni”;

- “Ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220kV Tiranë –Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës, loti 1 dhe 2”;

c- Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Auditimi është kryer me zgjedhje për prokurimet dhe pagesat e situacioneve dhe në total për amendamentet referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion.

d- Nr. i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Nga auditimi rezultuan 7 gjetje dhe 7 rekomandime.

2. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm për projektin “Eficienca Energjitike – Programi për Sektorin e Transmetimit të Energjisë Elektrike” me shkresën nr. 281/7 Prot., datë 31.12.2021, është si më poshtë:

Janë rekomanduar 8 masa organizative, prej të cilave 7 masa janë pranuar plotësisht dhe 1 masë nuk është pranuar. Prej të pranuarave janë zbatuar 2 masa dhe 5 masa janë në proces zbatimi. Është rekomanduar 1 masë për shpërbllim dëmi në vlerën 4,745,742.21 lekë pa TVSH, e cila nuk

është pranuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit. Sa trajtuar, është jo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm për projektin “Ndërtim i linjës së transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë”, me shkresën nr. 477/9 Prot., datë 26.09.2017 është si më poshtë:

Janë rekomanduar 5 masa organizative, të cilat janë pranuar. Nga këto, 3 masa janë në proces, 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe 1 masë është zbatuar plotësisht.

Janë rekomanduar dhe pranuar 2 masa shpërblim dëmi të cilat janë në proces.

Janë rekomanduar 2 masa për shpenzime pa efektivitet të cilat janë në proces zbatimi.

Sa trajtuar, është jo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se projekti “Linja 400 kV Shqipëri, Maqedonia e Veriut”, ishte parashikuar të përfundonte në dhjetor të vitit 2020, por ende nuk ka përfunduar, pra projekti është me 3 vite vonësë deri më datë 23.12.2023. Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se ecuria kronologjike e këtij projekti nga data e finalizimit të nënshkrimit të marrëveshjes e deri në miratimin e lejes së ndërtimit ka kaluar një periudhë kohe prej 7.3 vjet (88 muaj). Për projektin “Linja 400 kV Shqipëri Maqedoni (Fier, Elbasan, Qafë Thanë)”, afati i fundit i disbursimeve (sipas marrëveshjes së Huasë), është data 30.06.2020. Në lidhje me disbursimet janë bërë shtyrje të afatit të tyre dy herë e konkretisht në datat 30.12.2023 dhe 30.12.2025. Për rastin konkret është parashikuar të realizohet plotësisht për një periudhë kohore 3.5 vjet me të gjithë fazat e në fakt kemi një realizim 11.25 % deri në datën 31.12.2023, ose mbas tre vjetësh nga data e përcaktuar e përfundimit në marrëveshjen bazë.

Realisht, vetëm implementimi i projektit për secilin lot, në kushtet normale (edhe pa iu referuar amendimeve përkatëse të deritanishme për të dy lotet dhe të pritshme), do të zgjaste 2 vjet, që nga hyrja në fuqi e kontratave të zbatimit për të dy lotet pa llogaritur këtu, periudhën e domosdoshme për: Zhvillimin e procedurës së tenderimit për përzgjedhjen e konsulentit; Hartimin nga Konsulenti të raporteve që i paraprijnë procedurës së tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit; Zhvillimi i procedurës së tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorëve të të dy loteve; Fazës së klarifikimit të kontratave dhe hyrjes në fuqi të tyre (disa muaj); Fazës së implementimit e cila është penguar dhe rrjedhimisht zgjatuar në kohë nga një sërë faktorësh sikurse janë situata pandemike Covid 19, lufta Rusi Ukrainë, vonesa të tejzgjatura në zbardhjen e lejeve të ndërtimit, moslejimin nga banka financuese që të nisin punimet në pjesë të linjës/ sheshit ku nuk janë paguar kompesimet e personave të prekur nga projekti.

Nga auditimi i tarifës së angazhimit për kredinë e marrë për projektin “Linja 400 kV Shqipëri Maqedonia e Veriut”, pagesat e kryera nga OST SHA për tarifën e angazhimit deri në fund të vitit 2023, janë në shumën 802,441.74 Euro, nga 458,750 Euro që ishte parashikuar deri në përfundim të projektit, ose janë paguar **343,691.74 Euro më tepër** nga programimi, vlerë e cila përbën kosto shtesë për projektin, pra zgjatja e afatit të disbursimeve shoqërohet dhe me pagesa shtesë për tarifën e angazhimit.

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i financimit të projektit “Linja 400 kV Shqipëri Maqedonia e Veriut”, rezulton se:

- disbursimet kanë ecur me ritme të ulëta dhe kanë nisur në vitin 2021, ndërkohë që sipas marrëveshjes bazë disbursimi i fundit duhej të realizohej më 30.06.2020.

- Kontratat për dy lotet dhe konsulencën nga 48,280,598.02 euro vlerë të kontraktuar, mbas amendimeve janë në shumën 66,581,160.53 euro ose janë rritur 37.9%.

- Vlera e kontratës së konsulentit është rritur me 42.5 % pasi ai luan rolin e mbikëqyrësit dhe me shtimin e afatit të kontratave të punimeve rritet edhe vlera e kontratës së tij. Pra, zgjatja e afatit të punimeve ka sjellë rritje të kostos së konsulentit/mbikëqyrësit në vlerën 1,048,323 euro.

Gjetje nga auditimi:

- Nga auditimi rezulton se projekti “Programi për efikasitetin e energjisë në sektorin e transmetimit-ndërtimit të linjës së transmetimit me dy qarqe 220 kV Tiranë – Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës”, ishte parashikuar të përfundonte në qershor të vitit 2019, por ende nuk ka përfunduar, pra projekti është me 5 vite vonësë deri më datë 23.12.2023. Në pikën 2.2 të Marrveshjes së Huasë datë 30.06.2015, parashikohet se afati i fundit për të kërkuar disbursime është data 30.06.2019. Realisht vetëm implementimi i projektit për secilin lot, në kushtet normale (edhe pa iu referuar amendimeve përkatëse të deritanishme për të dy lotet dhe të pritshme), do të zgjasë 3 vjet, kjo referuar amendimeve përkatëse të deritanishme për të dy lotet me kohëzgjatje 36 muaj secila duke filluar nga viti 2019, kur këto kontrata kanë hyrë në fuqi, pa marrë në konsideratë këtu, periudhën e domosdoshme për: Zhvillimin e procedurës së tenderimit për përzgjedhjen e konsulentit (periudha 2015 – 2016); Hartimin nga Konsulenti të raporteve që i paraprijnë procedurës së tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit (periudha 2016 -2017); Zhvillimi i procedurës së tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorëve të të dy loteve (2017 -2018 dhe 2019 hyrja në fuqi e kontratave të loteve); Fazës së klarifikimit të kontratave dhe hyrjes në fuqi të tyre (disa muaj); Fazës së implementimit e cila është penguar dhe rrjedhimisht zgjatuar në kohë nga një sërë faktorësh sikurse janë situata pandemike Covid 19, lufta Rusi Ukrainë, vonesa të tejzgjatura në zbardhjen e lejeve të ndërtimit, moslejimin nga banka financuese që të nisin punimet në pjesë të linjës/sheshit ku nuk janë paguar kompesimet e personave të prekur nga projekti.

- Nga auditimi i tarifës së angazhimit për kredinë e marrë për projektin rezulton se pagesat e kryera nga OST SHA për tarifën e angazhimit deri në fund të vitit 2023, janë në shumën 710,625.42 Euro, nga 430,945.16 Euro që ishte parashikuar deri në përfundim të projektit, ose janë paguar 279,680.26 Euro më tepër nga programimi, vlerë e cila përbën kosto shtesë për projektin, pra zgjatja e afatit të disbursimeve shoqërohet dhe me pagesa shtesë për tarifën e angazhimit.

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i financimit të projektit “Programi për efikasitetin e energjisë në sektorin e transmetimit -ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220 kV Tiranë – Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës”, rezulton se:

- Disbursimet kanë ecur me ritme të ulëta dhe vonesa të theksuara nga ku për vitet 2015, 2016 dhe 2018 nuk është kryer asnjë disbursim.

- Kontratat për dy lotet dhe konsulencën nga 40,141,726.36 Euro vlerë të kontraktuar, mbas amendimeve janë në shumën 49,173,745.10 euro. Nga kjo kosto shtesë 2,000,000 euro janë me financim nga OST SHA (5 % të vlerës së Kredisë) sipas Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të OST SHA, me nr. 12, datë 21.12.2021. Për këtë projekt kosto shtesë të pambuluara me fonde janë në shumën - **7,173,745 euro**. Fakt që tregon për planifikim jo të duhur të fondeve.

- Vlera e kontratës së konsulentit është rritur me 75% pasi ai luan rolin e mbikëqyrësit dhe me shtimin e afatit të kontratave të punimeve rritet edhe vlera e kontratës së tij. Pra zgjatja e afatit të punimeve ka sjellë rritje të kostos së konsulentit/mbikëqyrësit në vlerën 1,845,986 euro.

Gjetje nga auditimi:

- Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kolaudimin e linjës “Linja 400 kV Shqipëri – Kosovë”, nga ana e ish Administratorëve të OST SHA, kanë dalë urdhra të brendshëm për kolaudimin e segmenteve të ndryshëm të linjës deri në kolaudimin e plotë të saj, me komisione të përbëra nga punonjës të OST SHA.

- Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kolaudimin e punimeve lidhur me projektin “Programi për efikasitetin e energjisë në sektorin e transmetimit-ndërtimit të linjës së transmetimit me dy qarqe 220 kV Tiranë – Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës”, për vendosjen e autotransformatorit të ri dhe paisjeve të tij sekondare në nënstacionin e Rrashbullit, nga ana e Administratorit të OST SHA, kanë dalë urdhra të brendshëm për kolaudimin tyre, me komisione të përbëra nga punonjës të OST SHA.

Nga auditimi rezultoi se punonjësit e OST SHA të caktuar nga administratorët në grupet e kolaudimit të linjës, nuk janë të licensuar, kërkesë e nenit 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

Mos kolaudimi i veprës nga persona të licensuar është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, nenet: 1 dhe 2.

e- Paraqitja e rekomandimeve kryesore.

Rekomandimi: OST SHA, Njësia e Zbatimit të Projektit, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, të hartojë një plan veprimi për detyrat e përcaktuara duke përcaktuar afatet dhe personat përgjegjës për zbatimin e tyre.

Rekomandimi: OST SHA, Njësia e Zbatimit të Projektit, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, të hartojë një plan veprimi për detyrat e përcaktuara duke përcaktuar afatet dhe personat përgjegjës për zbatimin e tyre.

Rekomandimi: Operatori i Sistemit të Transmetimit, Drejtoria e Projekteve të Huaja, në bashkëpunim me Njësinë e Zbatimit të Projekteve, në propozimin për përcaktimin e afateve të marrëveshjeve duhet të marrë në konsideratë afatet e procedurave ligjore dhe të zbatimit të projektit, deri në realizimin e plotë të punimeve dhe jo të propozojë afate marrëveshje huaje vetëm për realizimin e punimeve.

Rekomandimi: Operatori i Sistemit të Transmetimit, Drejtoria e Projekteve të Huaja, në bashkëpunim me Njësinë e Zbatimit të Projekteve, në propozimin për përcaktimin e afateve të marrëveshjeve duhet të marrë në konsideratë afatet e procedurave ligjore dhe të zbatimit të projektit, deri në realizimin e plotë të punimeve dhe jo të propozojë afate marrëveshje huaje vetëm për realizimin e punimeve, për të eliminuar në këtë mënyrë kostot shtesë që lindin nga shtyrja e afateve të disburimit apo shtesën në vlerë të kontratës së konsulentit të projektit.

Rekomandimi: Operatori i Sistemit të Transmetimit, Drejtoria e Projekteve të Huaja, në bashkëpunim me Njësinë e Zbatimit të Projekteve, në propozimin për përcaktimin e afateve të marrëveshjeve duhet të marrë në konsideratë afatet e procedurave ligjore dhe të zbatimit të projektit, deri në realizimin e plotë të punimeve dhe jo të propozojë afate marrëveshje huaje vetëm për realizimin e punimeve.

Rekomandimi: Operatori i Sistemit të Transmetimit, Drejtoria e Projekteve të Huaja, në bashkëpunim me Njësinë e Zbatimit të Projekteve, në propozimin për përcaktimin e afateve të marrëveshjeve duhet të marrë në konsideratë afatet e procedurave ligjore dhe të zbatimit të projektit, deri në realizimin e plotë të punimeve dhe jo të propozojë afate marrëveshje huaje vetëm për realizimin e punimeve, për të eliminuar në këtë mënyrë kostot shtesë që lindin për tarifën e angazhimit dhe kontratën e konsulentit.

Rekomandimi: Operatori i Sistemit të Transmetimit, Drejtoria e Projekteve të Huaja, Njësia e Zbatimit të Projektit, të marrë masa për kryerjen e kolaudimeve nga struktura përkatëse të licencuara për këtë qëllim.

3. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

Opinion për auditimin e përputhshmërisë:

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Drejtorisë së Projekteve të Huaja, Njesisë së Zbatimit të Projektit, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Drejtorisë së Projekteve të Huaja, Njesisë së Zbatimit të Projektit, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

Opinion i modifikuar i kualifikuar:

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se veprimtaria e strukturave të përfshira në realizimin e projektit përveç rasteve të cilësuar në Bazën për opinion e auditimit, është në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Shkeljet e konstatuara janë materiale por jo të përhapura, gjë e cila justifikon dhënien e një opinionin të kualifikuar.

Baza për opinionin e kualifikuar.

Ne kemi audituar veprimtarinë e subjektit “Operatori i Sistemit të Transmetimit, (Drejtoria e Projekteve të Huaja, Njësia e Zbatimit të Projektit)” në zbatim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet ISSAI-P1, “Deklarata e Limës”; ISSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI P-12, ISSAI P-20, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 400 dhe 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”.

Në i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Në besojmë së dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë, si dhe evidentimin e çështjeve të mëposhtme:

Çështjet kryesore:

1. Projektet nuk kanë përfunduar në kohë duke sjellë efekte negative në vazhdim si rritjen e tarifës së angazhimit apo rritjen e kostove për mbikëqyrësit dhe konsulentët, rritjen e vlerës së kostos, rritjen e shtrirjes në kohë të përfundimit të Projektit.

1.1. Projekti “Linja 400 kV Shqipëri Maqedonia e Veriut” ishte parashikuar të përfundonte në dhjetor të vitit 2020, por ende nuk ka përfunduar, duke rezultuar **me 3 vite vonesë**, duke shkaktuar rritje të kostove e konkretisht:

- Pagesat e kryera nga OST për tarifën e angazhimit deri në fund të vitit 2023, janë në shumën 802,441.74 EUR, nga 458,750 EUR që ishte parashikuar deri në përfundim të projektit, ose janë paguar **343,691.74 EUR më tepër nga programimi**.

- Vlera e kontratës së konsulentit/mbikëqyrësit është rritur **me 1,048,323 EUR**, kundrejt vlerës së kontratës fillestare;

1.2. Projekti “Programi për efikasitetin e energjisë në sektorin e transmetimit ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220 kV Tiranë – Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës”, ishte parashikuar të përfundonte në qershor të vitit 2019, por ende nuk ka përfunduar, pra projekti është **me 5 vite vonesë** deri më datë 23.12.2023, duke shkaktuar rritje të kostove në lidhje me:

- Pagesat e kryera nga OST për tarifën e angazhimit deri në fund të vitit 2023, janë në shumën 710,625.42 EURO, nga 430,945.16 EURO që ishte parashikuar deri në përfundim të projektit, ose janë paguar **279,680.26 EURO më tepër nga programimi.**

Vlera e kontratës së konsulentit/mbikëqyrësit është rritur me **1,845,986 EURO**, kundrejt vlerës së kontratës fillestare.

2. Komisionet e kolauditimit të punimeve, kanë në përbërje, punonjës të OST SHA të pa licensuar për kolauditim punimesh.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Menaxhimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Drejtoria e Projekteve të Huaja, Njësia e Zbatimit të Projektit, janë përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatore në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e audituesit është të shprehë një opinion bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë siguri të arsyeshme, që veprimtaria e subjektit nën auditim, në të gjitha aspektet, është pa gabime dhe anomali materiale. Audituesit e KLSH-së nëpërmjet auditimit të realizuar në këtë institucion krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), Objektivi ynë lidhet me dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të projekteve të huaja, me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara, administrative si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare e administrative të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Për këtë audituesit e KLSH, aplikojnë gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese nëpërmjet të cilës, audituesit identifikojnë çështjet më të rëndësishme që trajtohen në këtë material.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr. 135/1 Prot., datë 08.02.2024, nga data 08.02.2024 deri më datë 29.03.2024, në subjektin Operatori i Sistemit të Transmetimit, për periudhën nga data prej fillimit të projekteve deri më datë 31.12.2023, u krye auditimi “Përputhshmërisë” mbi “Auditim përputhshmërie për projektet:

- *“Ndërtim i linjës së transmetimit 400 kV Shqipëri Kosovë”;*
- *“Linja 400 kV Shqipëri Maqedoni”;*
- *“Ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220kV Tiranë –Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës, loti 1 dhe 2”;*

nga grupi i auditimit me përbërje:

1. L. B., përgjegjës grupi;
2. A. R., auditues;
3. B. Sh., auditues.

1. Objektivat dhe qëllimi

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Operatorin e Sistemit të Transmetimit duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me efektivitetin e përdorimit të fondeve të kredive si dhe zbatimin e përcaktimeve në Marrëveshjet e kredisë për projektet:

- *“Ndërtim i linjës së transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë”;*
- *“Linja 400 kV Shqipëri Maqedoni”;*
- *“Ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220kV Tiranë –Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës, loti 1 dhe 2”.*

Pjesë e rëndësishme e auditimit kanë qenë rregullshmëria e realizimit të objektivave të Projektit, niveli dhe ecuria e disbursimeve, procedurave të prokurimit konform rregullave dhe udhëzimeve të miratuara nga Banka KfW, korrektësia e zbatimit të kontratave të punëve civile dhe konsulencës si edhe ndryshimet ligjore të tyre. Nga grupi i auditimit u audituan realizimi i objektivave të përcaktuara në Marrëveshje për komponentët e Projektit si dhe disbursimet referuar realizimit të tyre. Realizimi i raporteve të përcaktuara në Marrëveshje dhe dorëzimi në kohë i tyre në KfW raportimet mbi disbursimet dhe shpenzimet. Hartimi i pasqyrave financiare dhe dorëzimi i tyre në Ministri të Financave dhe Ekonomisë kanë qenë pjesë e auditimit në përputhje me drejtimit e auditimit të përcaktuara në programin e miratuar. Veç kësaj është pasur në qendër të vëmendjes edhe fakti i marrjes në dorëzim i raporteve/shërbimeve të kryera nga konsulenti pasi kontratat për punime civile ende nuk kanë filluar deri në fazën e përfundimit të Auditimit.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, termave dhe kushteve, në përputhje me ligjin e buxhetit të shtetit, me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe kornizës ligjore të prokurimit publik.

Me auditimin e përputhshmërisë, përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara, zbatimin e kontratave, zbatimin e kërkesave të Marrëveshjes në periudhën nën auditim. Auditimi do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

2. Identifikimi i çështjes

Raporti mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të njësisë së zbatimit të projekteve, për periudhën nga fillimi i projekteve deri më datë 31.12.2023, për projektet:

- “Ndërtim i linjës së transmetimit 400 kV Shqipëri Kosovë”;
- “Linja 400 kV Shqipëri Maqedoni”;
- “Ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220kV Tiranë –Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës, loti 1 dhe 2”, ka identifikuar sipas kriterëve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

1. Auditimi i zbatimit të detyrave të lëna në auditimet e mëparshme.
2. Për marrëveshjen e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i tyre, lidhur me projektin/tet.
3. Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve, kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.
4. Mbi auditimin e zbatimit të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshjet me huadhënësit ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime.
5. Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime.
6. Mbi administrimin e veprave të dorëzuara, funksionimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të auditur lidhur me çështjen nën auditim

Drejtori i Projektit: Drejtori i Projektit duhet të garantojë implementimin optimal të Projekteve të zhvillimit të rrjetit, të financuara nga komuniteti i donatorëve të huaj. Ndjek dhe zbaton legjislacionin përkatës për përmbushjen dhe implementimin e Projektit të huaj që në fazat e para të financimit e deri në përfundimin dhe marrjen në dorëzim të veprës.

Drejton dhe ndjek procedurat e Marrëveshjeve të Kredisë me donatorët që bashkë-financojnë Projektin: ndjek procesin e tenderimit në bashkëpunim me asistencën e konsulencës së huaj në të gjitha fazat. Merr pjesë në negociimin e kontratave që parashikohen të nënshkruhen, ndjek administrimin e kontratave, zbatimin në kohë, me efektivitet dhe cilësi të Projektit, zbatimin e Marrëveshjes së Huas sipas kushteve përkatëse. Monitoron ecurinë e Projektit, ndjek zbatimin në kohë të problemeve financiare, siguron kontroll financiar dhe siguron cilësinë e Projektit, etj.

Shefi i Sektorit të Projekteve: Ndjek projektet me financim të huaj që nga procedurat e Marrëveshjes së kredisë, hartimin e dokumenteve të tenderit, procesin e tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit apo konsulencës, menaxhimin implementimin e projektit deri në finalizimin dhe dorëzimin e tij dhe marrjen në shfrytëzim nga strukturat përkatëse, etj. Specialisti financiar: Ndjek procedurat në lidhje me çështjet financiare duke u bazuar në Marrëveshjen e Huas duke respektuar afatet dhe kushtet e përcaktuara. Ndjek regjistrimet financiare dhe mirëmban gjithë dokumentacionin me karakter financiar që ka lidhje me projektet e huaja.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit e KLSH janë përgjegjës për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e opinionit, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

5. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, në dispozita të tjera si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC etj.;
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji 88/2015 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KFW) për Projektin “Efiçenca energjetike, programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike” ;
- Ligji nr. 10248, datë 11.03.2010, “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe KFW”;
- Ligji nr. 12/2014për “Ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe projektit”;;
- Ligji nr. 64/2016 datë 19.6.20164 për “Ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe projektit”;
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe dispozitave ligjore në zbatim të tij;
- VKM nr. 116, datë 24.02.1997 “Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huaja që i jepen Qeverisë së Republikës së Shqipërisë”.
- VKM nr. 452, datë 01.07.1998 "Për disa masa në përmirësimin e punës për financimin e projekteve që financohen nga donatorë të huaj”;
- Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 17.02.2003 “Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja, në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj”;
- Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 20, datë 24.12.2003 “Për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të huaj”;
- Udhëzuesit e prokurimit të huadhënësit për prokurimet e fondeve për mallra, punime dhe shërbime;
- Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit;
- Manualet e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH.

6. Standardet e auditimit të aplikuara

Bazuar në standardet ISAI 100 “Parimet themelore të auditimit në sektorin publik” dhe ISAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë” si edhe në Kodin Etik të KLSH.

7. Metodatat e auditimit

Auditimi është kryer me zgjedhje për prokurimet dhe pagesat e situacioneve dhe në total për amendamentet referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion.

Periudha e zgjedhjes së auditimit të transaksioneve është përcaktuar sipas gjykimit të audituesit por duke përfshirë në kohë të gjithë periudhën e zbatimit të Projektit deri në momentin e auditimit.

8. Dokumentimi i auditimit

Është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI), për të mundur natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë.

II. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm

Rëndësia e auditimit të Projekteve:

- *“Ndërtim i linjës së transmetimit 400 kV Shqipëri Kosovë”*

Ky projekt ka një impakt të rëndësishëm në rritjen e kapacitetit të shkëmbimit të energjisë elektrike midis dy vendeve dhe me vendet e rajonit, krijimin e mundësive më të mira tregtare për shkëmbime të energjisë dhe transite në rrjetin rajonal. Linja ndikon në krijimin e mundësive të shfrytëzimit optimal të burimeve të përbashkëta të prodhimit të energjisë elektrike duke minimizuar kostot dhe rritur efikasitetin e prodhimit. Vepra rrit besueshmërinë e operimit të sistemit elektroenergetik të dy vendeve dhe atij rajonal. Kjo linjë redukton riskun hidrologjik në Shqipëri, ku prodhimi i energjisë elektrike është i bazuar tërësisht në hidrocentrale. Gjithashtu ndihmon në reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit dhe përmirësimin e balancimit të rrjetit të transmetimit dhe manovrueshmërisë së tij.

- *“Linja 400 kV Shqipëri Maqedoni”*

Sistemet energjetike të dy vendeve nuk kanë qenë të lidhura direkt deri më sot e për rrjedhojë Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut nuk kanë mundur të kishin shkëmbim të energjisë elektrike. Ky projekt shënon një etapë të re për të dy kompanitë OST SHA dhe MEPSO pasi po hyjnë në një proces që jo vetëm do të lidh të dy sistemet, por do t'i hapë rrugë edhe bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike Shqipëri Maqedoni e Veriut, Kosovë dhe më tej me vendet e BE. Me vënien në operim të linjës 400kV Shqipëri-Maqedoni e Veriut, do të rritet kapaciteti total ndërkufitar i sistemit të transmetimit shqiptar me vendet fqinje në 1500MW, duke plotësuar në këtë mënyrë dhe një ndër objektivat kryesorë të qeverisë shqiptare që është të qenurit një vend lider energjetik në rajon dhe një eksportues neto i energjisë deri në vitin 2030. Duke qenë pjesë e infrastrukturës për Korridorin e 8-të Evropian, ky projekt do të krijojë mundësi shumë të mira për lidhjen me rrjetin Italian përmes linjave nënujore. Gjithashtu, ky investim do të ketë ndikim në zhvillimin e rrjetit 400 kV në zonën e Shqipërisë së Jugut, si dhe do të mbështesë çdo investim të nisur sot dhe të tjera që parashikohen të realizohen në të ardhmen për zhvillimin e energjisë së rinovueshme si dhe për zhvillimin ekonomik dhe turistik të vendit. Jo më pak e rëndësishme është edhe rruga digjitale që do të ndërtohet, e cila do të rrisë aftësinë komunikuese mes dy vendeve me kapacitet 200 giga/sek në hapin e parë. Ulja e kostos së transmetimit do të ndikojë në uljen e kostos së ofrimit të shërbimit të internetit për konsumatorët. Një nga prioritetet e OST SHA është edhe përmirësimi i shërbimit “data” në zona ku tregu nuk ka depërtuar dhe kostoja e shërbimit është e lartë.

- *“Ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220kV Tiranë –Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës, loti 1 dhe 2”*,

Ky projekt do të bëjë të mundur rritjen e besueshmërisë së funksionimit të rrjetit 220 kV të rajonit të Durrësit dhe të Jugut të Shqipërisë. Gjithashtu do të përmirësojnë kushtet aktuale të furnizimit me energji elektrike të qytetit të Tiranës. Projekti është financuar nga një kredi prej 40,000,000.00 Euro e akorduar nga Qeveria Gjermane, nëpërmjet Bankës KfW. Projekti është në implementim.

Këto projekte të realizuara ose në proces realizimi në OST SHA, janë një kontribut në rritjen e efikasitetit të transmetimit të energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet shtimit dhe fuqizimit të kapaciteteve të nënstacioneve elektrike dhe linjave të transmetimit të tensionit të lartë, për të minimizuar humbjet teknike dhe për të siguruar vazhdimësinë pa ndërprerje të transmetimit të energjisë elektrike.

Grupi i auditimit ka planifikuar auditimin e drejtimeve të auditimit në masë të konsiderueshme të transaksioneve, duke përfshirë të gjithë numrin e tyre dhe të raporteve të rezultuara gjatë

periudhës së implementimit të Projektit. Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, termave dhe kushteve, në përputhje me ligjin e buxhetit të shtetit, me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe kornizës ligjore të prokurimit publik. Në përfundim të procesit të auditimit për secilin drejtim të auditimit, rezultoi për sa më poshtë vijon:

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT, SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:

3.1- Auditimi i zbatimit të detyrave të lëna në auditimet e mëparshme.

3.1/1 Për projektin “Efiçenca Energjitike – Programi për Sektorin e Transmetimit të Energjisë Elektrike”.

Në zbatim të programit të auditimit u verifikua dokumentacioni si më poshtë:

- Raporti Përfundimtar për auditimin e ushtruar në OST SHA për projektin “Efiçenca Energjitike – Programi për Sektorin e Transmetimit të Energjisë Elektrike”;
- Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në KLSH me nr. 281/7, Prot., datë 31.12.2021 dhe në OST SHA me nr. 9 prot., datë 05.01.2022;
- Shkresa e OST SHA me nr. 435 Prot., datë 20.01.2022 “Mbi evadimin e masave të rekomanduara nga KLSH në Raportin Përfundimtar”;
- Shkresa nr. 9/2 Prot., datë 20.01.2022 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të raportit të KLSH nr. 281/7 Prot., datë 31.12.2021”;
- Korrespondenca me email;

Nga auditimi rezulton se:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

KLSH me shkresën përcjellëse nr. 281/7 Prot., datë 31.12.202, ka dërguar në subjektin OST SHA, rekomandimet e auditimit, ndërsa nga OST SHA, nuk është kthyer përgjigjia në afatin ligjor prej 20 ditësh, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15-Rekomandimet e KLSH, si dhe kërkesën e përcaktuar në shkresën e mësipërme.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecursisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Nga ana e subjektit të audituar është hartuar plani i masave për zbatimin e rekomandimeve, ku përcaktohen persona, apo struktura konkrete për zbatimin e secilit rekomandim por nuk është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30.

III. Rekomandimet e KLSH. Me shkresën përcjellëse administruar në KLSH me nr. 281/7 Prot., datë 31.12.2021 dhe në OST SHA me nr. 9 Prot., datë 05.01.2022, është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet. Nga KLSH i janë rekomanduar OST SHA gjithsej 8 masa organizative, prej të cilave 7 masa janë pranuar plotësisht dhe 1 masë nuk është pranuar. 2 masa janë zbatuar dhe 5 masa janë në proces zbatimi.

Është rekomanduar 1 masa për shpërblim dëmi në vlerën 4,745,742.21 lekë pa TVSH, e cila nuk është pranuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit.

Nga auditimi lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm për projektin “Efiçenca Energjitike – Programi për Sektorin e Transmetimit të Energjisë Elektrike”, rezultoi se niveli i zbatimit të rekomandimeve të lëna, është si më poshtë:

Janë rekomanduar 8 masa organizative, prej të cilave 7 masa janë pranuar plotësisht dhe 1 masë nuk është pranuar. Prej të pranuarave janë zbatuar 2 masa dhe 5 masa janë në proces zbatimi. Është rekomanduar 1 masë për shpërblim dëmi në vlerën 4,745,742.21 lekë pa TVSH, e cila nuk është pranuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit. Veprimet e mëprimit e mësipërme, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe shkresa nr. 281/7 Prot., datë 31.12.2021.

Rekomandimi: OST SHA, Njësia e Zbatimit të Projektit, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, të hartojë një plan veprimi për detyrat e përcaktuara duke përcaktuar afatet dhe personat përgjegjës për zbatimin e tyre.

Në mënyrë të analitike statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ndryshimet e Marrëveshjes së huas, shkaqeve dhe argumentimit të tyre, u konstatua se subjekti në auditim OST SHA, në rolin e huamarrësit dhe KFË-ja në rolin e huadhënësit, kanë realizuar amendime të shumta të marrëveshjes së huas së datës 30.06.2015, ku në mënyrë të përmbledhur, ato pasqyrohen sa më poshtë vijon:

Amendimi i marrëveshjes së huas për riskedulimin e pagesave

Administratori i OST SHA me shkresën nr. 2728 Prot., datë 13.04.2018, ka paraqitur kërkesën pranë KfW për rishikimin e termave të huas, mbi rishqyrtimin e afatit të disbursimeve dhe skedulit të pagesave të huas. Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Përgjithshme, miratoi ndryshimet e kërkuara nga administratori i OST SHA, për ndryshimet e marrëveshjes së huas.

Amendimi i marrëveshjes së huas për zgjatjen e afatit të disbursimit të huas. Administratori i OST SHA ka kërkuar përsëri shtyrjen e afatit të disbursimit deri më datë 30.12.2022 nga KfW. KfW, zgjatjen e afatit të disbursimit të huas, e kishte kushtëzuar, me detyrimin e OST SHA për kryerjen e pagesës në shumën 861,206 euro si tarifë kompensimi. Pas përfundimit të negociatave të OST SHA me KfW, tarifa e kompensimit është përcaktuar në vlerën 377,519 euro, e cila përbën kosto shtesë për këtë projekt dhe është paguar nga buxheti i OST SHA, si kosto shtesë për këtë projekt. Amendimi i marrëveshjes së datës 27.09.2019, ka shtyrë, afatin e disbursimit deri më datë 31.12.2022. Këshilli Mbikëqyrës, ka miratuar me vendimin nr. 80 datë 16.09.2019, amendimin e marrëveshjes për shtyrjen e afatit të disbursimit. Vlera e penalitetit të vendosur për shkak të shtyrjes së afatit të disbursimit nuk është argumentuar nga ana e KfW, por edhe administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës i OST SHA, nuk kanë kërkuar shpjegime mbi mënyrën e llogaritjes së penalitetit në vlerë 377,519 euro nga KfW.

Amendimi i aneksit 6 i marrëveshjes së veçantë. Marrëveshja e veçantë është amenduar pas miratimit dhe dhënies së autorizimit për miratimin e saj nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 12, datë 14.04.2017 dhe asambleja e përgjithshme e aksionarëve me nr. 4160/1, datë 5.05.2017. Në këtë amendim është ndryshuar aneksi 6 (gjastë) ku janë përfshirë komponentët kryesor të projektit dhe kërkesat për procedurën e tenderit.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e projekteve të huaja, në bashkëpunim me njësinë e zbatimit të projekteve të bëjnë parashikime të sakta për kostot e financimit dhe afatet e realizimit të projektit mbi bazën e studimit të fizibilitetit apo rishikimit të komponentëve të projektit në Këshillin Teknik, dhe pasi ti miratojnë në Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë, të pasqyrohen në marrëveshje të huas.

Në vijimësi

Ky rekomandim do të verifikohet kur OST SHA të ketë projekte të tjera me financim të huaj.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ndryshimin e komponentit II të marrëveshjes së huas së datës 30.06.2015 u konstatua se, Këshilli Teknik i OST SHA në mbledhjen e datës 14.11.2016 ka shqyrtuar dy opsione të paraqitura nga ana e konsulentit të projektit “F.”, si më poshtë:

Opsioni i parë: Lidhet me kërkesën e konsulentit për ndryshimin e linjave të hyrjes në nënstacionet 110kV nga linja ajrore (OHL) në linja kabllore për komponentin II të përcaktuar në marrëveshjen e huas, me objekt: “Ndërtimi/fuqizimi i linjave të reja të transmetimit 110 kV: Tirana 1-Traktori-Tirana 3, Tirana 3-Selitë dhe Tirana 3-Farkë”.

Opsioni i dytë: Paraqet kërkesën e konsulentit, mbi nevojën e realizimit të një studimi të plotë për koordinimin e mbrojtjes rele për rrjetin 110 kV të rajonit të Tiranës (ku përfshinë të gjitha nënstacionet dhe linjat në këtë projekt). Anëtarët e Këshillit Teknik shprehën dakordësi, kryesisht për kërkesën e konsulentit për opsionin e dytë, duke marrë vendimin:

Të negociohen të dy opsionet dhe ti hapet rrugë konsulentit për realizimin e një studimi të koordinimit të mbrojtjes rele për një pjesë sa më të gjerë të sistemit të transmetimit (opsioni i dytë).

Pra, anëtarët e Këshillit Teknik miratuan kërkesën e konsulentit për kryerjen e një studimi të plotë, për koordinimin e mbrojtjes rele për rrjetin 110 KV të rajonit të Tiranës, e cila sipas tyre, do ti shërbejë qëndrueshmërisë së sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në afat më të gjatë. Pavarësisht vendimit të Këshillit Teknik nr. 7096 Prot., datë 14.11.2016, OST SHA ka bërë amendimin e kontratës së konsulentit me nr. 1585/1 Prot, datë 24.03.2017, duke pasqyruar vetëm opsionin e parë të propozuar nga konsulenti. Ndërkohë që në Marrëveshjen e Huas komponenti II “Ndërtimi/fuqizimi i linjave të reja të transmetimit 110 kV: Tirana 1-Traktori-Tirana 3, Tirana 3-Selitë dhe Tirana 3-Farkë” është parashikuar që hyrjet në këto nënstacione të jenë linja ajrore. Në dokumentet e tenderit për termat e referencës (ToR) të përgatitura nga Agjenti i Tenderit në bashkëpunim me OST SHA dhe të dakordësuara nga KfW, për komponentin II, hyrja në nënstacionet 110 kV është përcaktuar me linjë ajrore. Amendimi i kontratës së konsulentit rriti kostot e shërbimit të konsulencës me 326,645 euro mbi vlerën e kontratës fillestare si rrjedhim i ndryshimit të konfigurimit të komponentit të dytë të parashikuar në marrëveshjen e huas së datës 30.06.2015 dhe në studimin e fizibilitetit të këtij projekti. Si pasojë Amendimi i kontratës së konsulentit rriti kostot e shërbimit të konsulencës me 326,645 euro, mbi vlerën e kontratës fillestare, ku vlera totale e kontratës së konsulentit pas amendimit është 2,458,615 euro, ose 208,615 euro më shumë se vlera e planifikuar në Marrëveshjen e Huas së datës 30.06.2015.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Projekteve të Huaja, gjatë fazës së hartimit të termave të referencës për tenderin e shërbimit të konsulencës së projekteve duhet të bashkëpunojë me Këshillin Teknik të OST SHA, për të analizuar dhe reflektuar ndryshime të mundshme, të komponentëve të projektit të përcaktuara në marrëveshjen e huas.

Në vijimësi

Qëndrimi i OST SHA për Rekomandimin: Gjatë periudhës pas raportit përfundimtar dhe rekomandimeve nuk ka pasur tendera.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: proces

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ndryshimin e “Komponentit I” të Marrëveshjes së huas, u konstatua se: Në Marrëveshjen e Huas, objekti për “komponentin I” ishte “Ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220 kV Tirana2 - Rrashbull dhe unaza 110 kV e Tiranës”. Pra sipas përcaktimit në Marrëveshjen e huas, ndërtimi i linjës Tirana2-Rrashbull me dy qarqe duhej të realizohej me bazamente, shtylla të tensionit të lartë, izolatorë dhe përcjellës me tension 220 kV. Këshilli Teknik në mbledhjen e datës 14.11.2016 ka marrë në shqyrtim studimin e shkurtuar për opsionet e ndërtimit të linjës Tirana 2-Rrashbull, hartuar nga konsulenti F. Në përfundim

Këshilli Teknik ka marrë vendim që ndërtimi i linjës Tirana 2 - Rrashbull me dy qarqe, të realizohet me bazamente dhe shtylla për tensionin 400 kV dhe me përcjellës me tension 200 kV. Këshilli Teknik në mbledhjen e datës 12.11.2018 ka marrë në shqyrtim vlerësimin e 2 (dy) konfigurimeve për ndërtimin e linjës 220 kV me dy qarqe Tirana2-Rrashbull, të cilat paraqiten si më poshtë:

Konfigurimi A, parashikon që ndërtimi i linjës Tirana2-Rrashbull me dy qarqe, të bëhet me: “Bazament dhe shtylla të tensionit të lartë për tension 400kV, por me izolator dhe përcjellës për tension 220 kV”. Pra ndryshe nga parashikimi i komponentit I, në marrëveshjen e huas së datës 30.06.2015, “Konfigurimi A” ndryshon shtyllat e tensionit të lartë nga 220 kV në 400kV.

Konfigurimi B, parashikon që ndërtimi i linjës Tirana2-Rrashbull me dy qarqe, të bëhet me:

“Shtylla të tensionit të lartë për tension 400kV, ku njëri qark të ketë izolator dhe përcjellës për tension 400 kV, kurse qarku tjetër të ketë izolator dhe përcjellës për tension 220 kV”.

Pra ndryshe nga parashikimi i “komponentit I”, në marrëveshjen e huas së datës 30.06.2015, me “Konfigurimin B”, do të kemi shtylla të tensionit 400 kV, ku në njërin qark do të ketë izolator dhe përcjellës për tension 400 kV dhe në qarkun tjetër do të ketë izolator dhe përcjellës për tension 220 kV.

Pavarësisht zgjedhjes së konfigurimit A apo B, linja Tirana2 -Rrashbull, të dyja qarqet, do të operojnë vetëm me tension 220 kV, edhe për një kohë të gjatë sipas anëtarëve të Këshillit Teknik.

Këshilli Teknik në mbledhjen e datës 12.11.2018 nuk ka marrë vendim për asnjë nga opsionet e propozuara, pasi nga 10 (dhjetë) anëtarë pjesëmarrës në mbledhje, 5 (pesë) prej tyre pranuan konfigurimin A dhe 5 (pesë) të tjerët konfigurimin B. Në këto kushte është rënë dakord nga anëtarët e këshillit teknik, që ti paraqesin opinionet e tyre administratorit dhe në varësi të situatës financiare të kompanisë, të vendoset për variantin që do të implementohet.

Në mbledhjen e Këshillit Teknik të datës 23.11.2018, janë risjellë për rivlerësim të dyja konfigurimet për projektin “Linja 220 kV me dy qarqe Tirana2-Rrashbull dhe unaza 110 kV e Tiranës”. Në përfundim Këshilli Teknik është shprehur me vendimin:

Linja me dy qarqe Tirana 2-Rrashbull të ndërtohet sipas variantit të dytë (konfigurimi B), pra njëri qark për tension 220 kV dhe qarku tjetër për tension 400 kV.

Disa prej anëtarëve të këshillit teknik, nuk ishin dakord me implementimin e konfigurimit B, pasi sipas tyre, ky opsion do të rriste kostot e financimit me 141,726.36 Euro mbi vlerën e huas.

Zv/Kryetari i këshillit teknik i përmbahet variantit të parë (konfigurimit A) pasi: vërtetë tendenca në perspektiv është për zhvillimin e rrjetit 400 kV, por edhe varianti i parë (konfigurimi A) nuk e përjashton këtë mundësi nëse perspektiva e zhvillimit e kërkon në të ardhmen. Rrjeti 220 kV tek ne është shumë i zhvilluar dhe do të mbetet ende në operim për një kohë të gjatë. (Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 15-17, të Raportit të Auditimit.)

3.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë në bashkëpunim me këshillin teknik dhe konsulentin, të dakordësojnë termat e referencës për kontraktorët e zbatimit të projektit, mbi bazën e studimit të fizibilitetit, dhe nëse ky i fundit ka nevojë për ndryshime ato të miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës dhe të pasqyrohen në amendimin e marrëveshjes para se të përfshihen në dokumentet e tenderit për kontraktorët e zbatimit të projektit.

Në vijimësi

Qëndrimi i OST SHA për Rekomandimin: Pas ndryshimeve të kryera i është propozuar donatorit ndryshimi në marrëveshje nga komunikimet me email donatori ka shprehur se aprovimet e dhëna me email janë të mjaftueshme për ta.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në stafin e PIU-t nuk ka specialistë të fushës së inxhinierisë, të cilët janë të nevojshëm përgjatë gjithë fazave të zhvillimit të projektit.

Sipas përcaktimeve të *seksionit 2* të Marrëveshjes së veçantë (zbatimi i projektit), struktura përgjegjëse për zbatimin e projektit në OST SHA është njësia e përhershme e zbatimit të projektit (PIU). Njësia e zbatimit të projektit (PIU) është në varësi të Drejtorisë së projekteve të huaja.

Në rregulloren e OST SHA Seksioni VII.2 dhe VII.2.1, detyrat funksionale dhe kriteret e punësimit për pozicionet e punës në aparatin qendror të OST SHA, përcaktohet se:

Drejtoria e projekteve të huaja garanton implementimin optimal të projekteve të zhvillimit të rrjetit, të financuara nga komuniteti i donatoreve të huaj. Ndjek dhe zbaton legjislacionin përkatës për përmbushjen dhe implementim e projektit të huaj që në fazat e para të financimit, e deri në përfundimin dhe marrjen në dorëzim të veprës.

Spektori i projekteve PIU ndjek projektet me financim të huaj që nga procedurat e Marrëveshjes së kredisë, hartimin e dokumenteve të tenderit, procesin e tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit apo konsulencës, menaxhimin implementimin e projektit deri në finalizimin dhe dorëzimin e tij, dhe marrjen në shfrytëzim nga strukturat përkatëse.

Nga auditimi konstatohet se, njësia e zbatimit të projektit përbehet nga:

- Shefi i sektorit të njësisë së zbatimit të projektit (PIU);
- 2(dy) jurist;
- 2(dy) ekonomist;
- 1(një) sekretar/arkivist.

Pra, ky sektor ka në përbërjen e vet 6 (gjashtë) specialistë të fushave të ndryshme, por nuk ka asnjë specialist të fushës së inxhinierisë elektrike në përbërjen e vet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 12, të Raportit të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë të marrë masa për të plotësuar strukturën e njësisë së zbatimit të projekteve me specialistë inxhinier të fushës së zbatimit për projektin “Eficienca energjetike programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike”.

Brenda vitit 2020

Qëndrimi i OST SHA për Rekomandimin: me shkresën nr. 435 Prot., datë 20.01.2022, Administratori i është drejtuar OST SHA duke kundërshtuar masën.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I papranuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vlerësimin e shkallës së realizimit të objektivave dhe komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjen e huas, grupi i auditimit konstatoi se:

Nuk janë realizuar objektivat e parashikuara në marrëveshjen e huas.

I. Objektivi për arritjen e rezultateve të pritshme në drejtim të rritjes së fuqisë së transmetimit të energjisë elektrike, sigurisë dhe cilësisë së furnizimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.

Pasi bazuar në treguesit e performancës për vlerësimin sasior të këtij objektivi, parashikohet që kapaciteti i transmetimit në rrjetën midis Tiranë - Rrashbull dhe Fier, të rritet me të paktën 155 MW në vitin e dytë të funksionimit të dy komponentëve.

Nga auditimi konstatohet se brenda periudhës së auditimit, ky objektivi nuk është realizuar, për shkak të mos implementimit të dy komponentëve të projektit.

II. Në marrëveshjen e veçantë të Huas së datës 02.07.2015, në aneksin 2 të saj, është përcaktuar skeduli kohor i realizimit të projektit përgjatë viteve 2015 – 2018, sipas dy komponentëve të saj, të pasqyruar në pikën a dhe b, sa më poshtë:

a. Faza e zbatimit për Komponentin parashikohej të zgjaste 3(tre) vjet, dhe të përfundonte në fund të vitit 2017.

b. Faza e zbatimi për Komponentit II parashikohej të zgjaste 4 (katër) vjet, dhe të përfundonte në fund të vitit 2018.

Ky objektiv nuk është realizuar dhe shtyrja në kohë e tij, është shoqëruar me kosto të shumta shtesë mbi vlerën e huas.

III. Nga auditimi konstatohet se, afati i ri për realizimin e këtij projekti respektivisht sipas dy komponentëve nuk është pasqyruar në amendimet e marrëveshjes së veçantë.

5.1.Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, të analizojë ecurinë dhe problematikat e shfaqura gjatë implementimit të projektit "Eficienca energjetike-programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike", si dhe të autorizojë administratorin e shoqërisë për nënshkrimin e amendimit të marrëveshjes së veçantë, ku të përcaktohet afati i përfundimit të projektit sipas të dy komponentëve të tij.

Brenda vitit 2020

Qëndrimi i OST SHA për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokumentacion në dispozicion.

Për sa trajtuar është paraqitur komenti i protokolluar në KLSH me nr. 135/2 Prot., datë 08.04.2024, me numër shkresë përcjellëse 889/13 (OST), datë 05.04.2024

Koment: Me shkresën nr. 889/12 Prot., datë 05.04.2024, mbi akt verifikimin nr. 2, datë 29.03.2024, për zbatimin e rekomandimeve të lëna (hyrje në OST SHA nr. 889/4 Prot., datë 28.03.2024).

Lidhur me amendimin e Marrëveshjes së veçantë, Komunikimi me KfW ka nisur nga ana jonë që në vitin 2020 dhe ka vijuar deri në mars 2022, ku banka nuk e ka konsideruar të nevojshëm formalizimin e këtyre ndryshimeve nëpërmjet një amendamenti, duke u mjaftuar vetëm me komunikimin elektronik OST – KfW.

Nga ana jonë janë ndërmarrë me kohë (që në muajin Gusht 2020) veprimet për ndryshimin e kësaj marrëveshje duke ia kërkuar këtë gjë bankës dhe duke cituar pikat e marrëveshjes që kërkonin ndryshim. Pas përgjigjes së Bankës se për ta nuk nevojitej amendamenti i kësaj marrëveshje por nga ana e OST SHA mund të paraqitej një draft në shtator 2020 i janë përcjellë draft ndryshimet për secilën pikë të marrëveshjes së veçantë. Dhe se shkëmbimi i e mail^{-eve} midis tyre dhe OST SHA është i mjaftueshëm. Nisur nga këto fakte Këshilli Mbikëqyrës nuk ka çfarë të analizojë për nënshkrim.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Amendimi i Marrëveshjes është kërkuar me shkresën e OST SHA nr. 388 Prot., datë 11.06.2019 për vonesat e theksuara në implementimin e projektit, për rishikimin e termave të Huas dhe shtyrjen e afatit të disbursimeve deri në Korrik të vitit 2022. Banka KfW, me letrën e datës 26.08.2019, ka pranuar në parim shtyrjen e afatit të disbursimit, por thekson pagesën e një vlere kompensimi si pasojë e shtyrjes së afatit të disbursimit, ku Huadhënësi pranon se kjo vlerë është bazuar në kushtet e tregut të kapitalit që ka preluar në kushtet e llogaritjes së kësaj vlere, duke theksuar se asnjë kosto shtesë nuk përfshihet në vlerën prej 861,206 Euro. KfW në kuadër të bashkëpunimit afatgjatë me OST SHA pranon të mbulojë 50% të shumës dhe pjesa tjetër të mbulohet nga OST SHA, dhe për këtë nuk ka asnjë llogaritje ose mënyra e llogaritjes nga banka KfW për caktimin e vlerës prej 377,519 Euro. Huamarrësi (OST) ka rënë dakord për të paguar detyrimin e paraqitur nga banka KfW dhe ka likuiduar vlerën **377,779 Euro** (377,519 Euro + 260 Euro komision banke), e cila përbën efekt financiar negativ për OST SHA. Për këtë vlerë nuk është paraqitur nga KfW asnjë dokument për mënyrën e llogaritjes si edhe nga Drejtoria Ekonomike e OST SHA nuk disponohet dokumentacion mbi përcaktimin e vlerës. Referuar Marrëveshjes së nënshkruar nga palët me amendimet përkatëse

plani i disbursimeve është shtyrë deri në korrik të vitit 2022, ose me 3 vjet nga afati i parashikuar si pasojë e vonesave të ardhura nga procedurat e tenderimit. Vlera e detyrimit në favor të KfW është kontabilizuar në llogarinë 233 “Investime të projektit”. Veprimet në kontabilitet, janë kryer në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 8, datë 17.02.2003 “Për evidentimin regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj”.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e menaxhimit të projekteve, në të ardhmen të marrë masat e duhura që ecuria e disbursimeve për projektet e financuara nga KfW apo donatorë të tjerë të huaj, të përfundojë brenda afateve të përcaktuara në marrëveshjet e financimit, me qëllim shmangien e kostove shtesë që mbart zgjatja në kohë e afatit të disbursimit, si dhe shmangien e procedurave të tej zgjatura që nevojiten për miratimin e ndryshimeve financiare në marrëveshjet e ratifikuara.

Në vijimësi

Qëndrimi i OST SHA për Rekomandimin: Do të verifikohet në projektet e ardhshme.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: Proces

7. Gjetje nga auditimi: Nga shuma e kredisë prej 40 milionë euro, deri në datën 03.03.2020 është disbursuar 5,231,789 Euro, dhe shuma e pa disbursuar është në nivelin e 34,768,211 Euro, ose 13% e shumës së kredisë. Pra, është disbursuar vetëm 13% e shumës së kredisë në një kohë që është konsumuar koha e efektshmërisë së përdorimit të Huas sipas Marrëveshjes.

-Disbursimet kanë ecur me ritme tejet të ulëta dhe vonesa të theksuara nga ku për vitet 2015, 2016 dhe 2018 nuk është kryer asnjë disbursim ato janë në nivelin 0.

-Projekti është parashikuar të përfundojë në dhjetor të vitit 2018 dhe ende nuk ka filluar faza e implementimit, pra projekti është me vonesë prej 18 muaj deri në periudhën e auditimit.

Amendimi i Marrëveshjes është kërkuar me shkresën e OST SHA nr. 388 Prot., datë 11.06.2019 për vonesat e theksuara në implementimin e projektit, për rishikimin e termave të Huas dhe shtyrjen e afatit të disbursimeve deri në Korrik të vitit 2022. Në datën 29.06.2018 është nënshkruar amendimi i parë i Marrëveshjes së Huas referuar skedulit të ripagesave, duke lënë të pandryshuar termat e tjerë të saj.

-Miratimi për shtyrjen e afatit të disbursimit deri në vitin 2022, nuk do të jetë i mjaftueshëm pasi nisur nga ecuria dhe problematikat në faza të ndryshme të projektit ku ende nuk janë kryer procedurat e shpronësimeve dhe kontratat e nënshkruara për kryerjen e punimeve ende nuk kanë filluar, nuk dihet ecuria e tyre.

7.1.Rekomandimi: OST SHA dhe NJZP të marrin masa që në të ardhmen, për projektet me financime të huaja të zbatojnë me korrektësi afatet kohore për realizimin e projekteve sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjet financiare, me qëllim minimizimin e kostove shtesë dhe krijimin e një opinionimi pozitiv ndaj huadhënësit në përdorimin e financimit.

Në vijimësi

Qëndrimi i OST SHA për Rekomandimin: Do verifikohet në projektet me financim të huaj.

Statusi i zbatimit të rekomandimit:Proces

8. Gjetje nga auditimi: Shkelje e procedurave të tenderit në procesin e prokurimit për shërbimin e konsulencës.

Në proces-verbalin nr. 4944 Prot., datë 26.08.2015, ora 16:20, i mbajtur nga z. Y. D. Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit është deklaruar hapja gabimisht nga ana e punonjëses së protokollit e kutisë dhe e zarfit të ofertës ekonomike për ofertuesin M. D.-C.

Por, me e-mailⁱⁿ e datës 26 Gusht 2015 ora 14:05 nga Njësia e Zbatimit të Projekteve (PIU) të OST SHA është njoftuar agjenti i tenderit për mbërritjen e ofertave të aplikantëve F., C. M. D. dhe G. I.

Hapja e tenderit ka qenë parashikuar në datën 28 Gusht 2015. Në këtë mënyrë, nga ana e Njësisë së Zbatimit të Projekteve (PIU) të OST SHA nuk është marrë asnjë masë për ruajtjen e tyre në gjendje të vulosur deri në momentin e hapjes.

Hapja e ofertës sa më sipër është kryer në kundërshtim me procedurën e parashikuar në pikën 2.3, paragrafi 2.12 “Udhëzuesit për Caktimin e Konsulentëve në Kooperimin Financiar me vendet Partnere”, ku përcaktohet se: *Oferta e shërbimeve do të jetë hapur menjëherë pas skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave. Zarfet, që përmbajnë kuotimet e çmimeve do të mbahen të vulosur dhe do të jenë hapur vetëm me miratimin e KfW për ato ofertues, që kanë arritur të paktën 75 % të pikëve.*

Me shkresën nr. 5056 Prot., datë 01.09.2015, të Administratorit të OST SHA z. E. Z. është njoftuar përfaqësuesi i bankës KfW mbi ngjarjen e ndodhur sa më sipër, si edhe për këtë shkak është kërkuar njëkohësisht anulimi i procedurës së tenderit për shërbimin e konsulentit.

Sa sipër, kërkesa për anulimin e tenderit nuk është mbështetur në asnjë nga rastet e parashikuara në Paragrafin 2.6 në “Udhëzimin për Prokurimet e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve në Kooperimin Financiar me Vendet Partnere”.

Në aneksin 2 bashkëlidhur “Udhëzuesit për Caktimin e Konsulentëve në Kooperimin Financiar me vendet Partnere”, pika 2, paragrafi “përpara një anulimi të mundshëm të tenderit” është parashikuar se: propozimi nga klienti që tenderi të anulohet duhet të jetë me arsyetim, i cili duhet të ndjekë kriteret e këtij udhëzuesi dhe duhet të shoqërohet me dokumentet përkatëse si kërkohej nga Banka.

Sa sipër, për shkak se procesi i vlerësimit të ofertave nuk ka mundur të realizohej, nuk ka rezultuar pasoja në vlerë. Gjithashtu, për shkak të mangësive në menaxhimin e procedurave të tenderit nga njësia përgjegjëse, është konstatuar vonesa për rreth 1 vit për realizimin e prokurimit për caktimin e konsulentit.

9. Gjetje nga auditimi: Deformim i procesit të vlerësimit të ofertave të kontraktorëve.

Në procesverbalin të mbajtur nga KVO nr. 53/8 Prot. datë 06.04.2017, kanë kaluar fazën e pare të para-kualifikimit si më poshtë:

-K. P. P. E. T. E. I. është kualifikuar pa kushte;

-A. S.p.A, E.E. e S., C. GE G. G. M. S.A me kushtin, që mangësitë respektive të konstatuara do të rregullohen në fazën vijuese të tenderit.

Në raportin paraprak të vlerësimit të ofertave teknike, të prezantuar nga Konsulenti dhe miratuar nga OST SHA në Mars 2018, është ngritur pretendimi i verifikimit të saktësisë në kriteret para-kualifikuese për K. P. P. E.T. E. I. si më poshtë:

-është konstatuar se në dokumentacionin e dorëzuar prej tij ka mospërputhje të dhënash (datat) për përfundimin e projektit “Ndërtimi i N/st Zerjanevic” (viti 2007 apo viti 2005) dhe për këtë arsye është kërkuar plotësim dokumentacioni.

Për këtë arsye pas saktësimeve, është kërkuar s’kualifikimi i këtij aplikanti.

Gjithashtu, në e-mailⁱⁿ e saj, datë 26 Mars 2018 banka (KfW) ka sqaruar se:

Me e-mailⁱⁿ e KfW, datë 11 Maj 2018 jepet dakordësia (No-Objection) e Raportit të Vlerësimit Final me shënimin “se ne nuk do të ndajmë plotësisht opinionin e punëdhënësit dhe konsulentit lidhur me mospërmbushjen e ofertës së prezantuar nga K. P. P. E. T. E. I. në lidhje me kriterin e para-kualifikimit”.

Seksioni 2.7 i “Udhëzimit për Prokurimet e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve në Kooperimin Financiar me Vendet Partnere” Gusht 2016, nuk është përjashtues në thelbin e tij, por lejon krahasimin e të gjithë ofertuesve për të përcaktuar avantazhet më të dobishme.

Pra, sa sipër në rastin e aplikantit Koncar nuk qëndron argumentimi se ekziston dyshimi për përmbushjen e kushteve minimale të parashikuara në fazën para-kualifikuese, për arsyen e thjeshtë se ky aplikant ka kaluar fazën e para-kualifikimit në mënyrë të pakushtëzuar.

Pra, edhe në këtë fazë të procesit të përzgjedhjes së kontraktorit janë vërejtur mangësi në ushtrim të detyrave funksionale nga ana e OST SHA për koordinimin dhe ndjekjen e procesit të vlerësimit.

9.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të shoqërisë, Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës duhet të marrin masat e nevojshme për të implementuar një sistem eficient të menaxhimit të projekteve të huaja, duke përfshirë të gjitha proceset e zhvillimit të projektit, me qëllim arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e risqeve që kërcënojnë shoqërinë.

Në vijimësi

Qëndrimi i OST SHA për Rekomandimin: Nuk u vendos asnjë dokument në dispozicion

Për sa trajtuar është paraqitur komenti i protokolluar në KLSH me nr. 135/2, datë 08.04.2024, me numër shkresë përcjellëse 889/13 (OST SHA), datë 05.04.2024

Koment: Me shkresën nr. 889/12 Prot., datë 05.04.2024, mbi akt verifikimin nr.2, datë 29.03.2024, për zbatimin e rekomandimeve të lëna (hyrje në OST SHA nr. 889/4, datë 28.03.2024).

Që nga dhënia e rekomandimit të tillë për këtë projekt deri tani, nuk ka nisur asnjë projekt i ri që të gjente vend ky rekomandim, për të implementuar një sistem eficient të menaxhimit të projekteve të huaja, duke përfshirë të gjithë proceset e zhvillimit të projektit me qëllim arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit, për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e risqeve që kërcënojnë shoqërinë. Në këto kushte nuk mund të disponohet asnjë dokument për këtë pikë.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar

MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Penalitete të pa mbajtura, gjatë zbatimit të kontratës së Konsulentit.

Me anën e faturave D17/1327 dhe D17/1328 datë 24.04.2017, është kërkuar nga “F. G. & C.” pagesa prej **371,169.00 €**, ose 60 % nga fondi i fazës A prej 618,615.00 €, si edhe pagesa prej **27,041.25 €**, ose 75 % të shtesës nga amendamenti nr. 01 i kontratës nr. 1585/1 Prot., datë 24.03.2017, prej 36,055 € për fazën A.

Raporti mbi mjedisin (E. Report) është dorëzuar me shkresën me nr. 1210 Prot., datë 03.03.2017 me një vonesë prej 11 javësh.

Raporti i Detajuar i Projektimit dhe Planifikimit (Detailed Planning and Design Report), është dorëzuar me shkresën me nr. 2301 Prot., datë 26.04.2017, me një vonesë prej 19 javësh.

Referuar pikës Ad 3.4 “kushtet speciale” të kontratës, janë përcaktuar afatet kur konsulenti duhet të raportojë mbi progresin e shërbimeve që ka kryer, si më poshtë:

-Raporti i Fillestar 8 javë pas hyrjes në fuqi ose 11.11.2016;

-Raporti mbi ambientin E. 8 javë pas hyrjes në fuqi ose 11.11.2016;

-Raporti i Planifikimit dhe Projektimit të Detajuar 12 javë pas hyrjes në fuqi ose 09.12.2016.

Veprimet për dorëzimin e shërbimeve të kryera nga konsulenti bien në kundërshtim me kushtet speciale paragrafin Ad.3.4 të kontratës së konsulentit.

Për këtë arsye: Referuar paragrafit 4.2 “Penalitete për Vonesën”, në kontratën e konsulentit, si edhe periudhës së vonesës nga data 11.11.2016 - 26.04.2017, ose 21 javë, llogaritja e penalitetit në **ngarkim të F. G. & C.** është **38,973 €** ose **4,745,742.21 lekë**.

1.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë dhe Drejtorja e Projekteve të Huaja, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **38,973 euro**, si penalitete për vonesat e shkaktuara në prezantimin e

Raportit të Mjedisit E. dhe Raportit të Projektimit dhe Planifikimit të Detajuar (Detailed Planning and Design Report) nga konsulenti F. G.& C.

Qëndrimi i OST SHA për Rekomandimin: Me shkresën nr. 435 Prot., datë 20.01.2022, Administratori i OST SHA, i është drejtuar KLSH-së duke kundërshtuar masën.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I papranuar

3.1/2 Auditim mbi veprimtarinë dhe shkallën e zbatimit të rekomandimeve në Operatorin e Sistemit të Transmetimit për projektin “Ndërtim i linjës së transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë”.

Projekti “Ndërtim i linjës së transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë” në Operatorin e Sistemit të Transmetimit është audituar nga KLSH në bazë të programit nr. 477/2 Prot., datë 13.07.2017, për periudhën e veprimtarisë nga fillimi i projektit deri në datë 31.04.2017. Në përfundim të auditimit, pranë OST SHA është dërguar me shkresën nr. 477/9 Prot., datë 26.09.2017, regjistruar në OST SHA me nr. 2453/20 Prot, datë 27.09.2017, Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet.

Me shkresën nr. 2453/22 Prot., datë 12.10.2017, është lëshuar nga Administratori i OST SHA Klodian Gradeci, njoftimi “Mbi masat e rekomanduara nga KLSH në Raportin Përfundimtar për auditimin e ushtruar në OST SHA.” ku janë vënë në dijeni Drejtoritë Përkatëse.

Me shkresën nr. 2185 Prot., datë 19.03.2018, administratori K. G. i dërgon informacion KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve në lidhje me Raportin Përfundimtar të auditimit të projektit.

Protokolluar pranë OST SHA me nr. 3022/4 Prot., datë 14.05.2018 është mbajtur akt-verifikimi i KLSH (në zbatim të programit nr. 482 Prot., datë 20.04.2018 si dhe autorizimit nr. 482/5 Prot., datë 24.04.2018) për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Me shkresën nr. 482/8 Prot., datë 28.05.2018 dhe protokolluar pranë OST SHA me nr. 3022/3 Prot., datë 30.05.2018, është dërguar projekt raporti i zbatimit të rekomandimeve për projektin “Ndërtim i linjës së transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë”.

-Nga ana PIU për projektin “Ndërtim i linjës së transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë” është respektuar afati 20 ditor i kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimit në përputhje me nenin 15, gërma “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” me shkresën nr. 2453/22 Prot., datë 12.10.2017.

-Nga ana e PIU për projektin “Ndërtim i linjës së transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë” është respektuar afati 6 mujor i kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimit në përputhje me nenin 30, pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” me shkresën nr. 2185 Prot., datë 19.03.2018.

Zbatimi i rekomandimeve është realizuar si më poshtë vijon:

MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Projekti “Ndërtim i linjës së transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë” është ratifikuar me ligjin nr. 10248, datë 11.03.2010 “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe KfW, projekti ishte parashikuar të përfundonte në 30 qershor 2013. Për shkak të vonesave për zhvillimin e tenderit të punimeve të projektit dhe fazës së ritenderimit është bërë i pamundur realizimi i projektit në afatin e parashikuar duke sjellë domosdoshmërinë e zgjatjes së afatit të realizimit të tij. Gjatë periudhës objekt auditimi është zgjatuar afati i zbatimit të projektit dy herë, konkretisht me ligjin nr. 12/2014 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe projektit” dhe me ligjin nr. 64/2016 datë 19.06.2016 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe projektit”,

duke e shtyrë afatin e zbatimit të tij deri në 31.12.2017 ose 3.5 vite më shumë se sa ishte parashikuar në marrëveshjen fillestare.

1.1 Rekomandimi: OST SHA dhe PIU të marrin masa që në të ardhmen për projektet me financime të huaja të zbatojnë me korrektësi afatet kohore për realizimin e projekteve sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjet financiare dypalëshe.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

OST SHA, në vazhdimësi ka në proces marrjen e masave, për zbatimin e rekomandimit, lidhur me të gjitha projektet me financime të huaja për zbatimin e afateve kohore sipas kushteve të parashikuara në marrëveshjet financiare dypalëshe.

Komenti i grupit të auditimit: Rekomandimi është në proces zbatimi.

2. Gjetje nga auditimi: Projekti “Ndërtim i linjës së transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë” ka përfunduar punimet e ndërtimit për dy lotet e para (si pjesë fillestare e projektit) në datë 14.06.2016, linja është testuar dhe kolauduar dhe e marrë dorëzim nga OST SHA por nuk është vënë në eficientë të plotë pasi:

-Projekti që përfshin dy vendet (Shqipëri-Kosovë) renditet ndër projektet më të rëndësishme për sistemin tonë energjitik dhe me impakt pozitiv për të gjithë rajonin e Evropës Juglindore. Edhe pse është nënshkruar Marrëveshja Operacionale ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST SHA) dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, në bazë të kërkesave dhe standardeve të përshkruara në Manualin Operacional të E.-E, që mundëson kryerjen e të gjitha detyrave të kontrollit të operimit të sistemit dhe ruajtjen e besueshmërisë së funksionimit të Sistemeve të interkonektuara, kjo marrëveshje bëhet efektive me njohjen e K. si zonë kontrolli e pavarur.

-Ndërmjet K. dhe E.-E është nënshkruar marrëveshja më datë 10.12.2015, por nuk është bërë ende efektive për shkak të mosplotësimit të kushtit të vendosur në nenin 16.1(b) e Marrëveshjes, sipas të cilit, Kosova duhet të licencojë një furnizues nga Serbia që të furnizojë një pjesë të veriut të vendit në zonat e banuara nga popullsia serbe.

Në këto kushte të bllokimit të marrëveshjes së lidhjes ndërmjet K. dhe E.-E, dhe meqë kanë përfunduar punimet për pjesën shqiptare të interkonektorit të ri 400 kV, OST SHA dhe K. i kanë drejtuar një letër Sekretarit të Përgjithshëm të E.-E si dhe komiteteve respektive të Operimit dhe Tregut, në të cilën i bëjnë me dije për situatën e krijuar ku si pasojë e mosnjohjes së K. si zonë kontrolli, ekziston risku i mos vënies në operim të interkonektorit të ri 400 kV si dhe i mosfunksionimit të marrëveshjes për rregullimin sekondar ndërmjet OST dhe K.. K. gjithashtu rikujton se ka nënshkruar tashmë marrëveshjet e operimit me të gjitha vendet fqinje (Shqipëri, Maqedoni, Serbi, Mali i Zi), të cilat përcaktojnë qartë kufijtë e zonës/bllokut të kontrollit të K. me vendet fqinje.

Gjithashtu i është kërkuar Sekretarit të Përgjithshëm dhe strukturave të menaxhimit të E.-E për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të adresuar këtë çështje dhe për të zbatuar detyrimet kontraktuale sipas marrëveshjes së interkonskesionit dhe Lidhjes së Marrëveshjes me E.-E. Në këtë kontekst, K. dhe OST SHA i kanë kërkuar E. që të bëjnë amendimin e Marrëveshjes së Lidhjes duke hequr kushtin joteknik të vendosur në nenin 16.1 (b) që pengon fillimin e funksionimit të K. si bllok kontrolli dhe të mundësojnë K. -in të kryejnë detyrimet ligjore. Meqë Marrëveshja e Lidhjes ndërmjet K. dhe E.-E nuk ka hyrë në fuqi, Marrëveshja Kornizë nuk mund të zbatohet plotësisht.

2.1 Rekomandimi: OST SHA në bashkëpunim me Ministrinë e linjës të marrë masat për të vënë në dijeni Parlamentin dhe Qeverinë lidhur me:

- Impaktin negativ nga mos vënia në punë e projektit të përfunduar.

- Rrezikun e dështimit në rast se nuk zgjidhet problemi i anëtarësimit të Republikës së Kosovës në E.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

OST SHA i është drejtuar Parlamentit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për trajtimin e problematikës sipas rekomandimit të lënë nga KLSH, me shkresën zyrtare nr. 1958, datë 08.03.2018.

Nga data e dërgesës së kësaj shkrese e në vazhdim nuk ka patur ndonjë shkresë zyrtare kthim-përgjigje.

Komenti i grupit të auditimit: Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

3. Gjetje nga auditimi: Në bazë të detyrimeve të marrëveshjes së huas huamarrësi duhet të shlyej huanë në 18 këste gjashtëmujore në datat 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti, duke filluar nga 30 dhjetori i vitit 2016 deri në 30 qershor të vitit 2024, në transhe të barabarta prej 2.333.333 euro.

Nga auditimi rezulton se deri në fund të periudhës objekt auditimi janë kryer 2 pagesa (këste) për shlyerjen e principalit në shumën 4.666.666 euro dhe 6 pagesa (këste) për shlyerjen e interesit të huas në shumën 1.466.556 euro. Gjithashtu konstatohet se pagesat e 6-mujorit të dytë të vitit 2016 janë kryer jashtë afatit të parashikuar, rreth tre muaj me vonesë, por pa efekte financiare në kundërshtim me pikën 5.1 të Marrëveshjes së Huas.

3.1 Rekomandimi: OST SHA, PIU dhe Drejtoria Ekonomike të marrin masa që të përmbushin të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e huave brenda afateve të përcaktuara, pasi mos pagesa në kohë sjell akumulim të detyrimeve duke rënduar situatën financiare të shoqërisë por edhe prishje imazhi dhe besueshmërie te donatorët.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

PIU, në vazhdimësi, ka në proces marrjen e masave për përcjelljen e menjëhershme Drejtorisë Ekonomike të shkresave për miratimin e pagesave, ndërsa Drejtoria Ekonomike ka në proces marrjen e masave për kryerjen e pagesave pa vonesa.

Komenti i grupit të auditimit: Rekomandimi është në proces.

4. Gjetje nga auditimi: Për shërbimin e konsulencës dhe mbikëqyrjes është lidhur kontrata datë 24.09.2009 midis M.G., OST SHA dhe K.O SHA, me afat 33 muaj. Nga auditimi i zbatimit të kontratës së konsulentit M. G. rezulton se janë kryer 7 amendime të kontratës, respektivisht katër për Fazën 1 dhe tre për Fazën 2.

Amendimet e kontratës gjatë Fazës 1:

-Me shkresën datë 12.03.2010 konsulenti M.G. ka informuar se për shkak të një ristrukturimi projekti do të përcillet një kompanie tjetër, e cila do të përmbushi detyrimet e kontratës së lidhur. Të gjendur para këtij fakti është kryer Amendimi nr. 1, datë 08.09.2010 ku konstatohet se është ndryshuar konsulenti nga "M.G." në "G.. G.". Ky ndryshim është kryer pa analizuar nëse konsulenti i ri "G. G." plotëson apo jo kushtet që plotësonte "M.G." që u vlerësua mbi kushtet që ishin vendosur në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, ky ndryshim denatyron edhe vetë procedurën e tenderit e cila u zhvillua për të përzgjedhur konsulentin që plotëson kushtet e vendosura me një ofertë ekonomike. Ky ndryshim është në kundërshtim me nenin 1.3 të Kontratës së Konsulencës ku shprehet se "Konsulenti nuk ka të drejtë të caktojë apo transferojë asnjë të drejtë apo detyrim pjesor ose të plotë të kontratës pa marrë një apo detyrim pjesor ose të plotë të kontratës pa marrë një miratim nga punëdhënësi".

4.1 Rekomandimi: OST SHA dhe PIU të marrin masa që në të ardhmen në kontratat e konsulencës për projekte me financime të huaja të ruajnë marrëdhëniet kontraktuale me operatorët ekonomik të shpallur fitues nga procedura e tenderimit dhe jo duke i ndryshuar me amendime kontratash.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

OST SHA dhe PIU, ka në proces marrjen e masave për zbatimin e këtij rekomandimi, lidhur me kontratat e konsulencës të të gjitha projekteve.

Komenti i grupit të auditimit: Rekomandimi është në proces.

5. Gjetje nga auditimi: Nisur nga shtyrja e afatit të disbursimeve me 1.5 vjet dhe shuma e konsiderueshme e fondeve të kursyera nga huaja prej rreth 7 milion euro me ligjin nr. 64/2016, datë 19.06.2016 për “Ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe projektit” OST SHA pa të arsyeshme që fondet e mbetura të përdoren për zgjerimin e nënstacionit Koman me një transformim 400/220 KV në kuadër të projektit “Ndërtimi i linjës së transmetimit 400 KV Kosovë-Shqipëri”. Për zgjerimin e nënstacionit Koman me një transformim 400/220 KV është tenderuar dhe është nënshkruar kontrata me kontraktorin po ende nuk kanë filluar punimet. Afati i shtyrjes së disbursimeve është deri në datë 31.12.2017 duke bërë të vështirë që zgjerimi i kësaj linje të bëhet brenda afatit të përcaktuar nga KfW pasi afati i mbetur nga shtyrja është 5 muaj dhe punimet për këtë nënstacion nuk kanë filluar ende.

5.1 Rekomandimi: Nga OST SHA, të merren masa që të nisin sa më parë punimet për linjën e zgjerimit të nënstacionit Koman që të arrihet të kryhet brenda afatit në datë 31.12.2017 të parashikuar me ligjin nr. 64/2016, datë 19.06.2016 për “Ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe projektit”.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Duke qenë se data e përfundimit të kontratës së zbatimit të projektit “Zgjerimi 400kV i N/stacionit të HEC Koman”, ishte 31 Maj 2018, OST SHA me shkresën nr. 5180 Prot., datë 02.10.2017 drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ka kërkuar nisjen e procedurës për shtyrjen e afatit të disbursimit të kredisë deri në 30 Dhjetor 2018, duke kërkuar mbështetjen e saj për angazhimin e Huamarrësit-Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në këtë proces. Pas kryerjes së procedurave përkatëse, është amenduar midis Huamarrësit dhe Bankës, marrëveshja e veçantë e projektit sipas së cilës afati i disbursimit të kredisë të shtyhej deri në 30 Dhjetor 2018.

Komenti i grupit të auditimit: Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar plotësisht.

MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë” u konstatuan se është financuar operatori ekonomik “E.” S. me drejtues ligjor z. E. C., për punime të pakryera në objekt dhe mos argumentim të kryerjes së shërbimeve të përgjithshme me dokumentacion justifikues duke përfituar padrejtësisht për punë të pakryer në shumën 241.239 euro duke shkaktuar kështu një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

1.1 Rekomandimi: OST SHA të marrë masa, që ti kërkojë operatorit ekonomik “E.” S. duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e shumës 241,239 euro, të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit: OST SHA ka ndërmarrë fazën e parë për zgjidhjen e çështjes. Me shkresën nr. 5637 Prot., datë 23.10.2017 OST SHA drejtuar “E.”-it, është kërkuar nga kontraktori kthimi i shumës prej 241,239 euro. Me shkresën me nr.ref KD/BH/I-3838/17, datë 26.10.2017 me nr. 5892 Prot., datë 31.10.2017, kontraktori është përgjigjur duke ritheksuar dhe argumentuar me dokumentacionin bashkangjitur kësaj shkrese, se faturimi është kryer në përputhje të plotë me kontratën dhe punimet e kryera prej tij si dhe nuk ka pasur ndonjë pagesë për punime të pakryera. Lidhur me etapën vijuese i është kërkuar këshillim Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit me shkresat nr. 7131 Prot., datë 20.12.2017 si dhe nr. 7350/1 Prot., datë

01.11.2018. Me shkresën nr. 728 Prot., datë 07.02.2019, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit A. M. i është drejtuar OST SHA duke i theksuar se OST SHA të bëjë një analizë të gjetjeve të KLSH-së si dhe një vlerësim të kostove në rastin e një procedure të mundshme arbitrazhi. Me shkresën nr. 1054/1 Prot., datë 03.04.2019 ende nuk është mbajtur një qëndrim i caktuar në lidhje me çështjen në fjalë. Me shkresën nr. 728/2 Prot., datë 16.04.2019 Avokatura e Shtetit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si me shkresën nr. 728 Prot., datë 07.02.2019. Me shkresën nr. 1054/3 Prot., datë 24.06.2019 si kthim përgjigje për shkresën e mësipërme OST SHA i është ridrejtuar Avokaturës së Shtetit duke risjellë në vëmendje të njëjtën problematikë dhe duke kërkuar sugjerim për kostot që përmban një procedurë arbitrazhi si dhe hapat e mëtejshëm për tu ndjekur për realizimin e këtij rekomandimi. Nga kjo datë e në vazhdim nuk ka ndonjë dokumentacion ligjor justifikues ose procedurë të ndjekur për zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit: Rekomandimi është pranuar dhe është në proces.

2. Gjetje nga auditimi: Për realizimin e shërbimit të konsulencës është lidhur kontrata me datë 24.09.2009, e llojit “lump sum” me M.D. Pagesa e parë për shërbimin e konsulencës është kryer në datë 22.10.2009 në bazë të kushteve të kontratës për parapagimin në vlerën 42.059 euro për kompaninë M. D. G. Ndërkohë që me Amendimin nr. 1 datë 08.09.2010 konstatohet se është ndryshuar konsulenti nga M. D. G. në G.-I. E. C. G.. Vlera prej 42.059 euro është përfituar padrejtësisht nga konsulenti M. D. G. pasi ai ka ndërprerë shërbimin e konsulencës në datë 08.09.2010 dhe është vazhduar me shërbim nga kompania I.-G.

2.1 Rekomandimi: OST SHA dhe PIU të marrin masa për arkëtimin e parapagimit të kryer ndaj MVV Decon në shumën 42,059 euro, si pagesë të përfituar padrejtësisht, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe kontabilizuar detyrimin.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

OST SHA me shkresën nr. 5828 Prot., datë 27.10.2017 drejtuar kompanisë konsulente “D. i.” – pasuese e “M. D.”, ka kërkuar kthimin e shumës prej 42.059 euro. Konsulenti “D. I.” është përgjigjur me shkresën nr. 5828/1 Prot., datë 13.11.2017 dhe dokumentet bashkangjitur saj, ku “D. I.G.”- Gjermani parashtrohet se kjo pagesë paradhënie nuk konsiderohet thjesht si paradhënie, por si pjesa e parë e skedulit të pagesave sipas kontratës. Nga ana e kësaj kompanie konkludohet se nuk ka asnjë bazë në kërkimin për tu kthyer pagesa e paradhënies drejtuar “M. D.”-it apo “decon international”-it, si pasues i tij. Lidhur me etapën vijuese të zgjidhjes së çështjes sipas rekomandimit, i është kërkuar këshillim Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit me shkresat nr. 7131 Prot., datë 20.12.2017 si dhe nr. 7350/1 Prot., datë 01.11.2018.

Me shkresën nr. 728 Prot., datë 07.02.2019 Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, A. M. i është drejtuar OST SHA duke i theksuar se OST SHA të bëjë një analizë të gjetjeve të KLSH-së si dhe një vlerësim të kostove në rastin e një procedure të mundshme arbitrazhi.

Me shkresën nr. 1054/1 Prot., datë 03.04.2019 ende nuk është mbajtur një qëndrim i caktuar në lidhje me çështjen në fjalë.

Me shkresën nr. 728/2 Prot., datë 16.04.2019 Avokatura e Shtetit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si me shkresën nr. 728 Prot., datë 07.02.2019.

Me shkresën nr. 1054/3 Prot., datë 24.06.2019 si kthim përgjigje për shkresën e mësipërme OST SHA i është ridrejtuar Avokaturës së Shtetit duke risjellë në vëmendje të njëjtën problematikë dhe duke kërkuar sugjerim për kostot që përmban një procedurë arbitrazhi si dhe hapat e mëtejshëm për tu ndjekur për realizimin e këtij rekomandimi.

Nga kjo datë e në vazhdim nuk ka ndonjë dokumentacion ligjor justifikues ose procedurë të ndjekur për zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit: Rekomandimi është pranuar dhe është në proces.

SHPENZIMET E KRYERA JO NË PËRPUTHJE ME PARIMET E EFEKTIVITETIT, EFICIENCËS DHE EKONOMICITETIT (3E)

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se për projektin “Linja e transmetimit 400KV Shqipëri-Kosovë” (Tiranë-Prishtinë) OST SHA i ka paguar Ministrisë së Financave tarifën e disbursimit për periudhën për vitet 2010-2016 në shumën 590.538 euro. Kjo shumë përbën një shpenzim jo efektiv të kryer nga OST SHA në shumën 590.538 euro për shkak të tejzgjatjes së procedurave të tenderit dhe rindërtimit. Për çdo pagesë Ministria e Financave i ka dërguar OST SHA detyrimin përkatës për këto shuma dhe më pas është kryer pagesa nga OST SHA. Në përgjithësi pagesat janë kryer brenda afateve të parashikuara në marrëveshje vetëm me devijime të vogla në disa raste.

1.1 Rekomandimi: OST SHA dhe PIU të marrin masa që të mos ketë shtyrje të mëtejshme të procesit të zbatimit të projektit duke eliminuar thellimin e mëtejshëm të efektit negativ prej 590,538 euro si pasojë e pagesës së tarifës së disbursimit.

OST SHA dhe PIU të marrin masa që në të ardhmen për projektet me financime të huaja të zbatojnë me përpikmëri afatet në çdo fazë të implementimit të tij (nga tenderimi e deri te zbatimi i punimeve) me qëllim arritjen në kohë të objektivave të tij dhe minimizimin e efekteve financiare nga pagesa e tarifave të disbursimit.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

OST SHA dhe PIU ka në proces të vazhdueshëm marrjen e masave në vijimësi për zbatimin e rekomandimit, gjatë implementimit në projektet aktuale.

Komenti i grupit të auditimit: Rekomandimi është në proces.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së tenderit Loti 1 “Ndërtimi i linjës 400kV Shqipëri-Kosovë”, rezulton se vendimi për anulimin e procedurës së tenderit është marrë nga OST SHA bazuar në faktin se oferta e renditur e dyta është teknikisht e përgjegjshme dhe me një diferencë të madhe nga operatori i renditur i pari. Por kriteri i tenderit e bënte të pamundur vazhdimin e negociatave me të. Konstatohet gjithashtu se vetëm procesi i anulimit të tenderit ka zgjatur 1 vit dhe gjithë periudha nga tenderi i 1-rë e deri në rindërtim është 2.5 vite. Ky ka sjellë vonesa të paarsyeshme dhe ka sjellë dhe një anomali të projektit pasi OST SHA është gjetur para faktit që duhet të bënte edhe ndryshime të projektit pasi OST SHA është gjetur para faktit që duhet të bënte edhe ndryshime të marrëveshjes pasi do të fillonte periudha e shlyerjes së kredisë akoma pa filluar disbursimi. Vetëm për këtë periudhë tarifa e angazhimit të huas së projektit e përcaktuar në marrëveshje është 287.583 euro vlerë e cila ka rritur koston e projektit dhe një shpenzim jo efektiv. Gjithashtu, për hartimin dhe zhvillimin e procedurës së rindërtimit OST SHA ka kryer Amendimin nr.2 të kontratës së konsulentit me vlerë 140.000 euro, vlerë e cila është paguar nga vetë OST SHA pasi nuk mbulohet nga asnjë nga fazat. Ky shpenzim i kryer nga OST SHA është joefektiv pasi vjen si pasojë e një anulimi të gabuar të procedurës së tenderit.

2.1 Rekomandimi: OST SHA dhe PIU të marrin masa që në të ardhmen në procedurat e tenderimit me financime të huaja të përcaktojnë si kriter kualifikues të fazës përfundimtare çmimin më të ulët me qëllim përdorimin e fondeve me ekonomicitet, efektivitet dhe efizienz.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

OST SHA dhe PIU ka në proces të vazhdueshëm marrjen e masave në vijimësi për zbatimin e rekomandimit, gjatë procedurave aktuale si dhe të ardhshme të tenderimit.

Komenti i grupit të auditimit: Rekomandimi është në proces.

Nga auditimi lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm për projektin “Ndërtim i linjës së transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë”, rezultoi se niveli i zbatimit të rekomandimeve të lëna, është si më poshtë:

Janë rekomanduar 5 masa organizative, të cilat janë pranuar. Nga këto 3 masa janë në proces, 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe 1 masë është zbatuar plotësisht. Janë rekomanduar dhe pranuar 2 masa shpërblim dëmi të cilat janë në proces. Janë rekomanduar 2 masa për shpenzime pa efektivitet të cilat janë në proces zbatimi. Veprimet e meprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

3.2- Për marrëveshjen e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i tyre, lidhur me projektin/tet.

U shqyrtua dokumentacioni: Marrëveshjet e Huas dhe Projektit; Amendimet përkatëse.

Nga auditimi rezultoi sa vijon:

1. Projekti “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë (Tiranë-Prishtinë)”

Ky projekt bëhet i mundur nëpërmjet Marrëveshjes së Huas dhe Projektit, të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit, (OST SHA) si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main. Marrëveshja e Huas dhe Projektit, është ratifikuar me ligjin nr. 10 248, datë 11.3.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 12/2014, datë 13.02.2014 dhe ligjin nr. 64/2016, datë 2.6.2016. Huaja e vënë në dispozicion është 42,000,000 Euro.

Projekti ka filluar në vitin 2010, dhe huamarrësi e ka kanalizuar huanë plotësisht tek OST SHA, si Agjencia Zbatuese e Projektit, e cila së bashku me KfW, përcakton hollësitë e projektit si dhe mallrat dhe shërbimet që financohen nga huaja në një marrëveshje të veçantë, ku përcaktohet në pajtim me nenin 1.2: hollësitë e projektit, si dhe mallrat dhe shërbimet që financohen nga huaja; neni 3.1: procedura e disbursimit, veçanërisht provat që provojnë se shumtat e disbursuara të huas përdoren për qëllimin e parashikuar; neni 11.2: hollësitë që i përkasin nenit 11.1 (Zbatimi i projektit dhe informacioni i veçantë), që miratohet nga huamarrësi.

OST SHA si Agjenci Zbatuese e Projektit, më datë 30.06.2010 ka nënshkruar një marrëveshje nënhuaje me Ministrinë e Financave prej 42.000.000 euro, për “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë”. E drejta e OST SHA për të tërhequr fonde nga huaja parashikuar me nenin 3.2 do të jetë deri më 30 qershor 2013.

Tatimet, detyrimet e tjera publike dhe detyrimet doganore që duhet të paguhet nga huamarrësi ose nga OST SHA por, nuk mund të financohen nga huaja.

KfW Frankfurt Am Main jep hua në pajtim me dispozitat e kushteve të kësaj marrëveshjeje huaje dhe projekti, si kusht që Republika Federale Gjermane të japë një garanci për këtë hua. KfW do t’i japë huamarrësit një hua që nuk e kalon shumën 42,000,000 euro.

Financimi total i projektit paraqitet si më poshtë vijon:

Financuesi	Huamarrësi	Agjencia e Zbatimit të Projekteve	Vlera e Angazhuar	Tarifa e angazhimit	Tarifa e menaxhimit	Norma e interesit	Pagesa e Principalit
KfW	MF	OST SHA.	42.000.000 €	0.25%	1%	3.21%	30.06.2016-30.12.2024

Linja 400 kV Tirana 2- Kosova B, ka një gjatësi të përgjithshme 242 km, e cila në pikëpamjen e shtrirjes gjeografike, kalon në luginën e Drinit dhe fare pranë HEC-ve të kaskadës së këtij lumi.

Projekti është i ndarë në dy lote të përfunduara, përkatësisht:

Loti 1 përfshin ndërtimin e linjës 400 kV, që për pjesën Shqiptare përbëhet nga plotësimi i qarkut të dytë në pjesën e Linjës 400 kV Tirana 2 – Podgoricë, tashmë të ndërtuar me shtylla për dy

qarqe (segmenti Tirana2 – Vau i Dejës, rreth 80.5 km), dhe segmentin e linjës me një qark Vau i Dejës – Kufi (Morinë) me një gjatësi prej 75 km.

Loti 2 përfshin pajisjet përkatëse të linjës në N/stacionet 400 kV, instalimin e një shunt reaktori në N/st 400 kV Tirana 2 për ruajtjen e nivelit të tensionit në rrjetin 400 kV si dhe ndërtimin e një sistemi të kontrollit fuqi – frekuence të përbashkët midis sistemit elektroenergjetik të Shqipërisë dhe atij të Kosovës.

Procedura e tenderimit për Lotin 1, për pjesën Shqiptare të linjës, ka përfunduar me lidhjen e kontratës ndërmjet OST SHA dhe E.d.d., Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë, për pjesën e linjës së transmetimit në Shqipëri ndërmjet Nënstacionit Tirana 2 dhe kufirit me Kosovën. Kontrata është nënshkruar më 12.12.2013 dhe ka hyrë në fuqi me 16.04.2014.

Vlera fillestare e kontratës është 28,938,189,89 Euro, ndërsa pas Amendamentit 1, vlera u bë 28,878,994,97 Euro. Me Amendamentin 3, është përcaktuar vlera përfundimtare e kontratës 28,025,479.62 Euro dhe koha e përfundimit të projektit për këtë lot data 16.06.2016.

Procedura e tenderimit për Lot 2, është finalizuar me kontratën e lidhur më 14.06.2013 ndërmjet OST SHA, K. dhe kontraktorit A. A., Mannheim, Gjermani, për zgjerimet e nënstacioneve dhe funksionet e sistemit të frekuencës së ngarkesës në Shqipëri dhe Kosovë. Data e hyrjes në fuqi të kontratës është 30.04.2014.

Vlera fillestare e kontratës për OST SHA është 5,058,112,00 Euro. Me Amendamentin nr. 3, vlera përfundimtare kontratës për pjesën shqiptare është bërë: 4,954,911.00 Euro.

Lot 3: Pas zbatimit të dy loteve të mësipërme, nga kjo kredi ka mbetur e papërdorur një shumë prej rreth 7 milionë Euro. Në përputhje me sa parashikohet në marrëveshjen e kredisë dhe projektit (I. Plani i projektit, 1. Hollësitë e projektit) vlera e mbetur e papërdorur nga projekti, është investuar për zgjerimin e mëtejshëm të projektit të Linjës 400 kV Tiranë-Prishtinë: Zgjerimi i Nënstacionit të Komanit me një autotransformator të ri 400/220 kV. Studimi për këtë komponent, është kryer nga konsulenti I.-G. I.

Ky studim, konsiston në shfrytëzimin sa më optimal të rrjetit 400 kV dhe 220 kV nëpërmjet balancimit të flukseve të fuqisë dhe do të japë mundësinë e lidhjes direkt në rrjetin 400 kV, të dy agregateve në HEC Koman.

Sipas studimit:

-Investimi do të çojë në uljen e humbjeve të fuqisë, sidomos në rrjetin 220 kV, ku ato janë mjaft të larta.

-Impakti është i dukshëm kur ka gjenerim të lartë të Kaskadës dhe në rastin më të mirë, humbjet e fuqisë ulen me 6.4 MW. Sipas llogaritjeve reduktimi i humbjeve të energjisë do të jetë mesatarisht 8 milionë kWh në vit.

Kostoja e përgjithshme e parashikuar sipas studimit, për Zgjerimin e Nënstacionit të Komanit, me një transformator të ri 400/220 kV, është afërsisht 10 milionë EURO.

Nga auditimi i projektit “Programi për eficiency e energjisë në sektorin e transmetimit -ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220 kV Tiranë – Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës”, rezultoi se ky projekt ishte parashikuar të përfundonte në qershor të vitit 2019, por ende nuk ka përfunduar, pra projekti është me 5 vite vonesë deri më datë 23.12.2023. Në pikën 2.2 të Marrëveshjes së Huas me datë 30.06.2015, parashikohet se afati i fundit për të kërkuar disbursimet është data 30.06.2019. Realisht vetëm implementimi i projektit për secilin lot, në kushtet normale (edhe pa iu referuar amendimeve përkatëse të deritanishme për të dy lotet dhe të pritshme), do të zgjasë 3 vjet, kjo referuar amendimeve përkatëse të deritanishme për të dy lotet me kohëzgjatje 36 muaj secila duke filluar nga viti 2019, kur këto kontrata kanë hyrë në fuqi, pa marrë në konsideratë këtu, periudhën e domosdoshme për:

- Zhvillimin e procedurës së tenderimit për përzgjedhjen e konsulentit (periudha 2015 – 2016);
- Hartimin nga Konsulenti të raporteve që i paraprijnë procedurës së tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit (periudha 2016 -2017).
- Zhvillimin e procedurës së tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorëve të dy loteve (2017, 2018, 2019 dhe hyrja në fuqi e kontrata e të dy loteve);
- Fazën e klarifikimit të kontratave dhe hyrjes në fuqi të tyre (disa muaj);
- Fazën e implementimit e cila është penguar dhe rrjedhimisht zgjatuar në kohë nga një sërë faktorësh sikurse janë situata e pandemisë Covid 19, lufta Rusi Ukrainë, vonesa të tejkzgjatura në zbardhjen e lejeve të ndërtimit, moslejimin nga banka financuese që të nisin punimet në pjesë të linjës/sheshit ku nuk janë paguar kompensimet e personave të prekur nga projekti.

Nga auditimi i tarifës së angazhimit për kredinë e marrë për projektin rezulton se pagesat e kryera nga OST SHA për tarifën e angazhimit deri në fund të vitit 2023, janë në shumën 710,625.42 Euro, nga 430,945.16 Euro që ishte parashikuar deri në përfundim të projektit, ose janë paguar 279,680.26 Euro më tepër nga programimi, vlerë e cila përbën kosto shtesë për projektin, pra

zgjatja e afatit të disbursimeve shoqërohet dhe me pagesa shtesë për tarifën e angazhimit, në kundërshtim me kriterin e Marrëveshjes së Huas.

Rekomandimi: Operatori i Sistemit të Transmetimit, Drejtoria e Projekteve të Huaja, Njësia e Zbatimit të Projekteve, në propozimin për përcaktimin e afateve të marrëveshjeve duhet të marrë në konsideratë afatet e procedurave ligjore dhe të zbatimit të projektit, deri në realizimin e plotë të punimeve dhe jo të propozojë afate marrëveshje huaje vetëm për realizimin e punimeve.

Nga auditimi i financimit të projektit “Programi për efikasitetin e energjisë në sektorin e transmetimit -ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220 kV Tiranë–Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës”, rezulton se:

- Disbursimet kanë ecur me ritme të ulëta dhe vonesa të theksuara nga ku për vitet 2015, 2016 dhe 2018 nuk është kryer asnjë disbursim.
- Kontratat për dy lotet dhe konsulentin nga 40,141,726.36 EURO vlerë të kontraktuar, mbas amendimeve rezultojnë në shumën 49,173,745.10 EURO. Nga kjo kosto shtesë 2,000,000 EURO janë me financim nga OST (5 % të vlerës së Kredisë) sipas Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të OST, me nr. 12 datë 21.12.2021. Për këtë projekt koston shtesë të pambuluara me fonde janë në shumën **7,173,745 EUR**. Fakt që tregon për planifikim jo të duhur të fondeve.
- Vlera e kontratës së konsulentit është rritur me 75% pasi ai luan rrolin e mbikëqyrësit dhe me shtimin e afatit të kontratave të punimeve rritet edhe vlera e kontratës së tij. Pra, zgjatja e afatit të punimeve ka sjellë rritje të koston së konsulentit/mbikëqyrësit në vlerën 1,845,986 EURO.

Rekomandimi: Operatori i Sistemit të Transmetimit, Drejtoria e Projekteve të Huaja, në bashkëpunim me Njësinë e Zbatimit të Projekteve, në propozimin për përcaktimin e afateve të marrëveshjeve duhet të marrë në konsideratë afatet e procedurave ligjore dhe të zbatimit të projektit, deri në realizimin e plotë të punimeve dhe jo të propozojë afate marrëveshje huaje vetëm për realizimin e punimeve, për të eliminuar në këtë mënyrë koston shtesë që lindin për tarifën e angazhimit dhe kontratën e konsulentit.

Për sa trajtuar është paraqitur komenti i protokolluar në KLSH me nr. 135/2, datë 08.04.2024, me numër shkresë përcjellëse 889/13 (OST SHA), datë 05.04.2024

Komentet: Për akt konstatimin nr. 1, datë 28.03.2024 (hyrje në OST SHA me nr. 889/1, datë 28.03.2024) nr.prot OST 889/10, date 05.04.2024

Duke ju referuar që në fillim pjesës së konkluzionit ku përmendet që projekti ishte parashikuar të përfundonte në qershor të vitit 2019, por ende nuk ka përfunduar, pra projekti është me 5 vite vonesë deri më datë 23.12.2023, ju sqarojmë se në pikën 2.2 të Marrëveshjes së Huas datë 30.06.2015, parashikohet se afati I fundit për të kërkuar disbursimet është data 30.06.2019. Afati i mësipërm ka qenë vetëm parashikues, pasi realisht vetëm implementimi i projektit për secilin lot, në kushtet normale (edhe pa iu referuar amendimeve përkatëse të deritanishme për të dy lotet dhe të pritshme), do të zgjasë 3 vjet, kjo referuar amendimeve përkatëse të deritanishme për të dy lotet me kohëzgjatje 36 muaj secila duke filluar nga viti 2019, kur këto kontrata kanë hyrë në fuqi, pa marrë në konsideratë këtu, periudhën e domosdoshme për:

- Zhvillimin e procedurës së tenderimit për përzgjedhjen e konsulentit (periudha 2015 – 2016);
- Hartimin nga Konsulenti të raporteve që i paraprijnë procedurës tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit (periudha 2016 -2017).
- Zhvillimi i procedurës së tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorëve të dy loteve (2017 - 2018 dhe 2019 hyrja në fuqi e kontrata e të dy loteve);
- Fazës së klarifikimit të kontratave dhe hyrjes në fuqi të tyre (disa muaj);

- Fazës së implementimit e cila është penguar dhe rrjedhimisht zgjatuar në kohë nga një sërë faktorësh sikurse janë situatë pandemie Covid 19, lufta Rusi Ukraine, vonesa të tejzgjatura në zbardhjen e lejeve të ndërtimit, moslejimin nga banka financuese që të nisin punimet ne pjesë të linjës/ sheshit ku nuk janë paguar kompensimet e personave të prekur nga projekti.

Për arsyet e mësipërme që dalin jashtë vullnetit të OST SHA është zgjatur periudha e realizimit të projektit dhe për këto arsye për shtyrje janë pranuar si nga banka financuese si dhe nga këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Aksionarëve të OST SHA. Kështu me miratimin e bankës dhe vendimet e organeve të lartpërmendura është amenduar edhe afati i realizimit të projektit.

Shtyrja në kohë e projektit për arsyet që nuk varen nga OST SHA, ndërlidhet dhe ka patur impakt të drejtpërdrejtë në ritmet e disbursimeve; në vijimin e pagesës së tarifës së angazhimit – pagesë e cila është detyrim i huamarrësit sipas pikës 3.1 të marrëveshjes së Huas.

Shtyrja në kohë e realizimit të projektit evidentohet në amendimet përkatëse të kontratave të zbatimit për të dy lotet, para lidhjes së të cilave është marrë gjithmonë miratimi i Bankës financuese. Si rrjedhojë është amenduar edhe kontrata e konsulentit pasi është detyrim i huamarrësit OST SHA i parashikuar në Marrëveshjen e Huas që të kontraktojë një konsulent për të mbuluar me konsulencë dhe mbikëqyrje projektin deri në mbylljen e plotë të tij.

Lidhur me kohëzgjatjen e projekteve të reja të marrëveshjes së huas sikurse edhe ju e keni përmendur në akt konstatim, do tja parashtrojmë huadhënësit afatet e duke marrë në konsideratë afateve ligjore të procedurave.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa keni trajtuar ju pohoni sa është trajtuar në akt konstatimin e mbajtur.

II- Projekti “Ndërtimi i linjës 400 kV Shqipëri-Maqedonia e Veriut (Fier - Elbasan - Qafë Thanë)”

Me ligjin nr. 3/2017 dhe nr. 4/2017, datë 26.01.2017 është bërë Ratifikimi i Marrëveshjes Ndërqeveritare midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale Gjermane për Bashkëpunimin Financiar 2010 dhe 2016, ku parashikohet financimi i këtij projekti, nëpërmjet një huaje të bankës gjermane KfW në favor të huamarrësit OST SHA. Me ligjin nr. 101/2017 datë 09.11.2017 është ratifikuar Marrëveshja e Garancisë ndërmjet dy qeverive tona të përfaqësuara përkatësisht nga banka KfW për palën gjermane dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë si institucion garantor i huas, për palën shqiptare. Në datë 18.11.2016 është nënshkruar Marrëveshja e Huas ndërmjet KfW si huadhënës dhe OST SHA si huamarrës. Në datë 18.11.2016 është nënshkruar Marrëveshja e Financimit dhe Projektit me fonde të akorduara nga WBIF (Komisioni Evropian) të kanalizuar nëpërmjet KfW si institucion financiar. Në datë 28.04.2016 janë nënshkruar dy grantet e akorduara nga WBIF dhe Bashkëpunimi për Zhvillim Gjermano-Shqiptar të kanalizuar nëpërmjet KfW si institucion financiar. Projekti “Linja e Transmetimit 400 kV Shqipëri – Maqedoni (Fier-Elbasan-Qafë Thanë)” financohet si më poshtë:

Tabela 2.3-II/1

Në euro

Kredia/ granti- në euro	Vlera
Kredi nga KfW / Vlera e angazhuar	50,000,000
Grant nga WBIF	14,000,000
Grant nga WBIF dhe Bashkëpunimi për Zhvillim Gjermano-Shqiptar	1,131,000
Financim me fonde të OST	5,000,000
Totali	70,131,000

Burimi: OST

Me amendimin e grantit WBIF, me shkresën nga banka KfW datë 20.11.2020, KfW nga vlera prej 14 milion euro ka zbritur vlerën prej 280,000 euro, si shpenzime për KfW si institucion financiar. Vlera e fondit të grantit të WBIF e përdorshme nga OST SHA për projektin është në shumën 13,720,000 euro.

Pagesa/ detyrime të kredisë *Tabela 2.3-II/2*

Në euro

Viti	Periudha	Principali		Pagesa interesi	Tarifa e	
		Vlera	Pagesë pjesore		Menaxhimit	Angazhimit
2017	6 mujori i pare				500,000.00	45,833.03
	6 mujori i dyte					62,500.00
2018	6 mujori i pare					62,500.00
	6 mujori i dyte					62,500.00
2019	6 mujori i pare					62,500.00
	6 mujori i dyte					62,500.00
2020	6 mujori i pare					62,500.00
	6 mujori i dyte					62,500.00
2021	6 mujori i pare			14,871.05		59,525.78
	6 mujori i dyte			43,857.50		53,728.49
2022	6 mujori i pare			48,391.63		52,821.67
	6 mujori i dyte			52,051.27		52,089.75
2023	6 mujori i pare			54,965.61		51,506.88
	6 mujori i dyte	4,545,454.53		65,319.33		49,436.14
Totali detyrimeve të kredisë		4,545,454.53		279,456.39	500,000.00	802,441.74

Burimi: OST

Detyrimet e kredisë deri me 31.12.2023 në shumën **6,127,352.66 euro**

Detyrimet e kredisë të paguara nga OST SHA deri me 31.12.2023 në shumën **6,127,352.66 euro**.

Për projektin “Linja 400 kV Shqipëri Maqedoni (Fier Elbasan Qafë Thanë)”, afati i fundit të disbursimeve (sipas marrëveshjes së Huas) është data 6/30/2020. Në lidhje me disbursimet janë bërë shtyrje të afatit të tyre dy herë e konkretisht në datat 12/30/2023 dhe 12/30/2025.

Sipas marrëveshjes së huas disbursimet ishin dakordësuar:

Në euro

Nr.	Periudha	Disbursimet e parashikuara:		Nr.	Periudha	Disbursimet faktike nga kredia	
		Tranche I	Tranche II			Tranche I	Tranche II
<i>Disbursimet e parashikuara (sipas marrëveshjes së Huas, datë 18.11.2016)</i>				<i>Disbursimet faktike nga fondet e kredisë</i>			
1	9/30/16	12/30/16	0	1	6/30/21	2,533,702.88	1,577,118.59
2	1/1/17	6/30/17	6,000,000	2	12/30/21	2,225,728.12	1,355,104.00
3	7/1/17	12/30/17	4,000,000	3	6/30/22	235,419.12	
4	1/1/18	6/30/18	4,000,000	4	12/30/22	592,978.19	201205.1434
5	7/1/18	12/30/18	4,000,000	5	6/30/23	117,709.56	
6	1/1/19	6/30/19	7,000,000	6	12/30/23	1,515,194.35	756,528.10
7	7/1/19	12/30/19	3,000,000		Total:	7,220,732.21	3,889,955.84
8	1/1/20	6/30/20	2,000,000				
Vlera totale e huas			30,000,000				20,000,000

Në total kontratat bazë, shtesat, financimi me fonde të kredisë, granteve dhe të OST, dhe disbursimet dhe financimet e mbetura nga kredia dhe OST janë sipas tabelës në vijon:

Tabela 2.3-II/3

Në euro

Projekti	Vlera originale e kontratës	Vlera e kontratës së amenduar	Financim me fonde të Kredisë	Financim me fonde të Granteve	Për tu disbursuar nga Kredia	Për tu Financuar Granti WBIF	Për tu Financuar nga OST
Lot 1: Linjat	24,642,478	33,688,227	6,257,915.47	1,663,496.52	18,194,475.51	5,318,448.48	2,253,890.55
Lot 2: N/Stacionet	21,173,500	29,379,991	3,345,413.00	889,287.00	19,935,771.06	5,209,519.94	
Shërbime Konsulence	2,464,620	3,512,943	1,507,359.56	1,032,422.7	1,163,109.08	328,056.41	
Buxheti total i RAP/LACP		2,078,203					2,078,203.00
Kosto totale e	48,280,598	68,659,364					

projektit							
Totali		11,110,688.03	3,585,206.21	39,293,355.65	10,856,024.83	4,332,093.55	
Vlera e Kredisë (Loan BMZ ID: 2010 66 992 & 2016 67 898)				50,000,000.00			
Vlera e Granteve të përdorura/ ezaurura (EU-WBIF)				607,270.00			
Vlera e Granteve (WBIF)				13,720,000.00			
Financim me fonde të OST				5,000,000.00			
Vlera e mbetur nga fondet në dispozicion				667,906.47			

Afati i fundit për të kërkuar disbursimet, sipas marrëveshjes së kredisë është: KfW ka të drejtë të refuzojë të bëjë disbursimet pas 30 qershor 2020.

Disbursimet e kredisë kanë filluar në vitin 2021 për të cilat është paguar tarifa e angazhimit në shumën **802,441.74 euro**, e cila ka filluar të paguhet që në 6 mujin e parë të vitit 2017 (Pagesa/ detyrime të kredisë *Tabela 2.3-II/2*).

Disbursimet e kredisë në vite paraqiten sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Tabela 2.3-II/4 Në euro

Viti	Grant	Kredia	Totali
2018	91,090.50	-	91,090.50
2019	485,816.00	-	485,816.00
2020	-	-	-
2021	2,082,327.39	7,691,653.59	9,773,980.98
2022	282,339.59	1,029,602.45	1,311,942.03
2023	643,632.74	2,389,432.01	3,033,064.75
Total disbursime	3,585,206.22	11,110,688.04	14,695,894.26

Sipas kontratave kredia paraqitet:

Tabela 2.3-II/5 Në euro

Projekti	Kosto e projektit/ amendimeve për lotet nr. 1 & 2 e konsulenca	Disbursime faktike nga kredia	Për tu disbursuar nga kredia
Linja 400 kV Shqipëri – Maqedoni e Veriut	68,659,364	11,110,688.04	38,889,311.97
Vlera e kredisë	50,000,000		
Fonde të mbetura nga kredia	0		

Sipas kontratave granti paraqitet:

Tabela 2.3-II/6 Në euro

Projekti	Kosto e projektit/ amendimeve për lotet nr. 1 & 2 e konsulenca	Disbursime faktike grantet (EU/WBIF) & (WBIF)	Për tu disbursuar nga grantet (WBIF)
Linja 400 kV Shqipëri – Maqedoni e Veriut	68,659,364	3,585,206.22	10,742,063.78
Vlera e granteve të përdorura (EU/WBIF)	607,270.00		
Vlera e granteve (WBIF)	13,720,000.00		
Fonde të mbetura nga grantet (EU/WBIF) & (WBIF)			

Ndërsa vlera totale e kostove shtesë paraqitet sipas tabelës sa vijon:

Tabela 2.3-II/7 Në euro

Projekti	Vlera totale e kostove shtesë/ amendimeve të pa mbuluara nga vlera e kredisë dhe granteve	Për tu financuar nga OST
Linja 400 kV Shqipëri – Maqedoni e Veriut	4,332,093.53	4,332,093.55
Financim me fonde të OST	5,000,000	
Fonde të mbetura nga fondi i OST	667,904.47	

Në tabelën në vijim paraqitet kostoja totale e projektit “Ndërtimi i linjës 400 kV Shqipëri-Maqedonia e Veriut (Fier - Elbasan - Qafë Thanë)” sipas amendimeve të kontratës së

konsulencës dhe amendimeve të kontratave të zbatimit të Lot 1 & Lot 2 ("Rregullimet e Çmimeve" – përshkallëzim kostoje (për shkak të rritjes së kostos së materialeve, transportit, punës dhe energjisë), duke qene së indeksit dhe kursi i këmbimit EUR/USD do të vazhdojnë të luhaten, vlerat e amenduara në këto kontrata zbatimi, janë vetëm për orientim.

Tabela 2.3-II/8

Në euro

Projekti	Vlera origjinale e kontratës	Vlera e amenduar e kontratës	Shtesa në %
Loti 1- nënstacionet	24,642,478.02	33,688,226.53	36.7
Loti 2 - linjat	21,173,500.00	29,379,991.00	38.8
Shërbime konsulence	2,464,620.00	3,512,943.00	42.5
Buxheti total i LACP/RAP		2,078,203.00	
Totali	48,280,598.02	68,659,363.53	42.2

Projekti është i ndarë në dy lote dhe data e përfundimit të projektit për të dy lotet është parashikuar dhjetor 2025.

Kostoja totale e projektit “Ndërtimi i linjës 400 kV Shqipëri-Maqedonia e Veriut (Fier - Elbasan - Qafë Thanë)”, sipas amendimeve të kontratës së konsulencës dhe amendimeve të kontratave të zbatimit të Lot 1 & Lot 2 "Rregullimet e Çmimeve" – përshkallëzim kostoje paraqitet me një rritje **42.2 %** ndaj kontratave fillestare, për shkak të rritjes së kostos së materialeve, transportit, punës dhe energjisë), duke qenë së indeksit dhe kursi i këmbimit EUR/USD kanë patur luhate.

Kontratat dhe amendimet Tabela 2.3-II/9

Në euro

Kontraktori	Referenca e Kontratës	Kontrata bazë		Amendime			Kon. + Ame.
		Vlera (Euro)	Data e lidhjes	Nr. Amend.	Vlera (Euro)	Data e lidhjes	Vlera (Euro)
J. M.& D.	Lot 1 - Linjat	24,642,478	14/01/2021	01	9,045,748.51	2/2/2023	33,688,226.53
M.	Lot 2 - Nënstationet	21,173,500	14/04/2021	01	-	6/24/2021	21,173,500.00
				02	8,206,491.00	8/1/2023	29,379,991.00
F.G.& C.K.	Konsulenca	2,464,620	1/9/2018	01	198,843.00	6/8/2022	2,663,463.00
				02	849,480.00	7/6/2023	3,512,943.00
Totali		48,280,598			18,300,563		

Fondet e akorduara në forme granti nga EU – WBIF janë përdorur/ezaurura për financim të fazës A, të kontratës të konsulencës, ndërsa faza e implementimit të projektit (faza B), financohet me fonde në formë kredie dhe fonde në formë granti, të akorduara nga WBIF si edhe nga fondet e vetë OST-së, në vlerë 5,000,000 euro (parashikuar që në fillim si pjesë e financimit të projektit).

Buxheti total i LACP/RAP prej 2,078,203 Euro (sipas legjislacionit shqiptar dhe standardeve ndërkombëtare) është dakordësuar të paguhet nga OST SHA.

Referuar situatës aktuale të kontratave të zbatimit dhe konsulencës (sipas amendimeve të tyre), nga zëri “Financim me fonde të OST SHA” me vlerë 5,000,000 Euro, mbetet ende i papërdorur fondi prej 667,906.47 euro nga kredia.

Projekti: sipas loteve/ kontraktorëve deri më datë 31.12.2023, **paraqitet me një realizim financiar sipas tabelës sa më poshtë vijon:**

Tabela 2.3-II/10

Në euro

Objekti	Kontraktorët / Konsulentit	Vlera e kontratës së amenduar	Mallra të lëvruar; punime të kryera; konsulence të kryera	% e realizimit
Lot 1: Linjat	JV – M. E. and M.C.I. – D.	33,688,226.53	4,811,564.57	14.28
Lot 2: N/Stationet	M. S.A	29,379,991.00	-	0.00
Shërbime konsulence	F. G. & C.K.	3,512,943.00	2,677,777.25	76.23
	Totali	66,581,160.53	7,489,341.82	11.25

Ndërsa rimbursimi i TVSh, në lekë paraqitet:

Tabela 2.3-II/11

Në euro

Objekti	Kontraktorët / Konsulenti	Vlera total sipas faturave	Vlera e paguar	% e pa paguar
Lot 1: Linjat	J. – M. E. and M.C. I. – D.	89,745,323.43	89,745,323.16	0.00
Lot 2: N/Stacionet	M. S.	41,324,200.00	41,324,200.00	0.00
Shërbime Konsulence	F. G. & C.K.	63,106,459.06	61,684,145.20	2.25
		194,175,982.50	192,753,668.36	0.99

Arsyet e këtij realizimi me % të ulëta sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion janë:

- pasojat vijuese të situatës pandemike Covid-19, e cila që nga viti 2020 e në vijim ka sjellë vonesa të konsiderueshme për vazhdimin e projekteve të shoqëruara me kohë dhe kosto shtesë, siuate kjo e thelluar më tej nga lufta Rusi- Ukrainë;
- amendime të kontratave të zbatimit të projektit për të dy lotet, të shoqëruara me kohë dhe kosto shtesë, që kanë lindur dhe mund të lindin gjatë implementimit të indikuara nga vonesat e mbartura të lartpërmendura nga situata pandemike dhe e luftës, të shoqëruara me përshkallëzim të koston;
- amendime të kontratës së konsulencës të shoqëruara me kohë dhe kosto shtesë, të cilat vijnë domosdoshmërisht të ndërlydhura dhe paralel me amendimet e kontratave të zbatimit të projektit për të dy lotet.

Nga auditimi i ecurisë kronologjike të projektit: “Linja 400 kV Shqipëri Maqedonia e Veriut”, rezulton se nga data e finalizimit të nënshkrimit të marrëveshjes e deri në miratimin e lejes së ndërtimit ka kaluar një periudhë kohe prej 7.3 vjet (88 muaj) , konkretisht tabela sa më poshtë vijon:

Hapat kronologjike të projektit që nga nënshkrimi i marrëveshjes dhe grantit		Periudha
Finalizimi	Nënshkrimi i Marrëveshjes së Huas dhe Grantit	nëntor 16
Tenderi për përzgjedhjen e konsulencës:		
Faza e parakualifikimit:	Nisja - dërgimi nga Agjenti i Tenderit (i kontraktuar nga vete financuesi KfW) i Dokumenteve të fazës së parakualifikimit	janar 16
	finalizimi – marrja e miratimit të Raportit të Parakualifikimit nga KfW	korrik 16
Faza teknike:	Nisja- Dërgimi nga Agjenti i Tenderit i Dokumenteve të Tenderit	nëntor 16
	finalizimi – marrja e miratimit nga financuesi KfW mbi Raportin e Vlerësimit Teknik	nëntor 17
Faza Financiare:	Nisja - Hapja e zarfeve financiare	nëntor 17
	finalizimi - marrja e miratimit nga KfW për Raportin e Vlerësimit Financiar.	dhjetor 17
Kontrata e konsulencës:		
Klarifikimi dhe negociimi i kontratës:	Nisja – dhjetor 2017 draft kontrata nga Agjenti Tenderit	Hyrja në fuqi 16.4.18
	finalizimi – firmosja e kontratës së konsulencës në 9.01.18.	30.04.18
Zbatimi i kontratës së konsulencës: Faza A: Raportet që i paraprijnë procedurës së tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit. Inception Report, Planning and Design Report, up datë i (ESIA, ESMP), nisja – data e fillimit të kontratës së konsulencës dhe vijim. Procesi i tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit.		
Kontratat e ndërtimit		
Faza a parakualifikimit	Lot 1: Nisja - shkurt 2019, paraqitja nga Konsulenti e draft Dokumenteve të Parakualifikimit dhe finalizimi - në Nëntor 2019 miratimi nga KfW i Raportit të Vlerësimit të Fazës së Parakualifikimit.	nëntor 19
	Lot 2: Nisja – shkurt 2019, paraqitja nga Konsulenti e draft Dokumenteve të Parakualifikimit dhe finalizimi në Dhjetor 2019 - miratimi nga KfW i Raportit të Vlerësimit të Fazës së Parakualifikimit.	dhjetor 19

Faza teknike	Lot 1: Nisja – Nëntor 2019 paraqitja nga Konsulenti e draft Dokumenteve të Tenderit (për fazën teknike dhe financiare) dhe finalizimi në Tetor 2020- miratimi nga KfW i Raportit të Vlerësimit Teknik.	tetor 20	
	Lot 2: Nisja – Nëntor 2019 paraqitja nga Konsulenti e draft Dokumenteve të Tenderit (për fazën teknike dhe financiare) dhe finalizimi në Dhjetor 2020 - miratimi nga KfW i Raportit të Vlerësimit Teknik.	dhjetor 20	
Faza financiare	Lot 1: Nisja – Nëntor 2020, hapja e zarfeve me ofertën financiare dhe finalizimi në Dhjetor 2020- miratimi nga KfW i Raportit të Vlerësimit Financiar.	dhjetor 20	
	Lot 2: Nisja – Dhjetor 2020, hapja e zarfeve me ofertën financiare dhe finalizimi në Shkurt 2021- miratimi nga KfW i Raportit të Vlerësimit Financiar.	shkurt 21	
Klarifikimi i Kontratës së zbatimit	Lot 1: nisja - dhjetor 2020 dërgimi i njoftimit ofertuesit të klasifikuar në vend 1 dhe finalizimi në 14 Janar 2021 - nënshkrimi i kontratës së zbatimit për këtë lot.	14.01.21	
	Lot 2: nisja - mars 2021 dërgimi i njoftimit ofertuesit të klasifikuar në vend 1 dhe finalizimi në 14 Prill 2021-nënshkrimi i kontratës së zbatimit për këtë lot.	14 .04.21	
Hyrja në fuqi e kontratave të zbatimit	Lot 1:	10.03.21	
	Lot 2	27.07.21	
Faza e zbatimit: (e cila është në vijim për të dy lotet).			
Leja e ndërtimit	Lot 1: linjat	Aplikuar për leje ndërtimi	01.11.21
		Miratuat leja e ndërtimit ne parim nga KKT	24.11.21
		Leja e ndërtimit nga AZHT.	17.05.23
		dorëzimi i sheshit dhe fillimi i punimeve	21.08.23
	Lot 2: nënstacionet	Aplikuar për leje ndërtimi	17.02.22
		Miratuat leja e ndërtimit ne parim nga KKT	26.04.22
		Leja e ndërtimit nga AZHT	23.08.23
		dorëzimi i sheshit	19.09.23

Nga auditimi rezulton se projekti “Linja 400 kV Shqipëri Maqedonia e Veriut”, ishte parashikuar të përfundonte në dhjetor të vitit 2020, por ende nuk ka përfunduar, pra projekti është me 3 vite vonesë deri më datë 23.12.2023. Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se ecuria kronologjike e këtij projekti nga data e finalizimit të nënshkrimit të marrëveshjes e deri në miratimin e lejes së ndërtimit, ka kaluar një periudhë kohe prej 7.3 vjet (88 muaj). Për projektin “Linja 400 kV Shqipëri Maqedoni (Fier Elbasan Qafë Thanë)”, afati i fundit të disbursimeve (sipas marrëveshjes së Huas), është data 30.06.2020. Në lidhje me disbursimet janë bërë shtyrje të afatit të tyre dy herë, konkretisht në datat 30.12.2023 dhe 12.30.2025. Për rastin konkret është parashikuar të realizohet plotësisht për një periudhë kohore 3.5 vjet me të gjithë fazat e në fakt kemi një realizim 11.25 % deri në datë 31.12.2023, ose mbas tre vjetësh nga data e përcaktuar e përfundimit në marrëveshjen bazë.

Realisht vetëm implementimi i projektit për secilin lot, në kushtet normale (edhe pa iu referuar amendimeve përkatëse të deritanishme për të dy lotet dhe të pritshme), do të zgjaste 2 vjet, që nga hyrja në fuqi e kontratave të zbatimit për të dy lotet, pa llogaritur këtu periudhën e domosdoshme për: Zhvillimin e procedurës së tenderimit për përzgjedhjen e konsulentit; Hartimin nga Konsulenti të raporteve që i paraprijnë procedurës tenderimit, për përzgjedhjen e kontraktorit; Zhvillimi i procedurës së tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorëve të dy loteve; Fazës së sqarimit të kontratave dhe hyrjes në fuqi të tyre (disa muaj); Fazës së implementimit e cila është penguar dhe rrjedhimisht zgjatuar në kohë nga një sërë faktorësh sikurse janë situata pandemike Covid 19, lufta Rusi Ukraine, vonesa të tejzgjata në zbardhjen e lejeve të ndërtimit, moslejimin

nga banka financuese që të nisin punimet në pjesë të linjës/sheshit ku nuk janë paguar kompensimet e personave të prekur nga projekti.

Nga auditimi i tarifës së angazhimit për kreditë e marrë për projektin “Linja 400 kV Shqipëri Maqedonia e Veriut”, pagesat e kryera nga OST për tarifën e angazhimit deri në fund të vitit 2023, janë në shumën 802,441.74 EURO, nga 458,750 EURO që ishte parashikuar deri në përfundim të projektit, ose janë paguar **343,691.74 EURO më tepër** nga programimi, vlerë e cila përbën kosto shtesë për projektin, pra zgjatja e afatit të disbursimeve shoqërohet dhe me pagesa shtesë për tarifën e angazhimit.

Rekomandimi: Operatori i Sistemit të Transmetimit, Drejtoria e Projekteve të Huaja, në bashkëpunim me Njësinë e Zbatimit të Projekteve, në propozimin për përcaktimin e afateve të marrëveshjeve, duhet të marrë në konsideratë afatet e procedurave ligjore dhe të zbatimit të projektit, deri në realizimin e plotë të punimeve dhe jo të propozojë afate marrëveshje huaje vetëm për realizimin e punimeve.

Nga auditimi i financimit të projektit “Linja 400 kV Shqipëri Maqedonia e Veriut”, rezultojnë se:

- disbursimet kanë ecur me ritme të ulëta dhe kanë nisur në vitin 2021, ndërkohë që sipas marrëveshjes bazë disbursimi i fundit duhej të realizohej më 30.06.2020.
- Kontratat për dy lotet dhe konsulentin nga 48,280,598.02 EURO vlerë të kontraktuar, mbas amendimeve rezultojnë në shumën 66,581,160.53 EURO, ose me 37.9% më shumë.
- Vlera e kontratës së konsulentit është rritur me 42.5 %, pasi ai luan rolin e mbikëqyrësit dhe me shtimin e afatit të kontratave të punimeve rritet edhe vlera e kontratës së tij. Pra zgjatja e afatit të punimeve ka sjellë rritje të kostonë së konsulentit/mbikëqyrësit në vlerën 1,048,323 EURO.

Rekomandimi: Operatori i Sistemit të Transmetimit, Drejtoria e Projekteve të Huaja, në bashkëpunim me Njësinë e Zbatimit të Projekteve, në propozimin për përcaktimin e afateve të marrëveshjeve duhet të marrë në konsideratë afatet e procedurave ligjore dhe të zbatimit të projektit, deri në realizimin e plotë të punimeve dhe jo të propozojë afate marrëveshje huaje vetëm për realizimin e punimeve, për të eliminuar në këtë mënyrë kostot shtesë që lindin nga shtyrja e afateve të disbursimit apo shtesën në vlerë të kontratës së konsulentit të projektit.

Për sa trajtuar është paraqitur komenti i protokolluar në KLSH me nr. 135/2, datë 08.04.2024, me numër shkresë përcjellëse 889/13 (OST SHA), datë 05.04.2024

Komentet: me shkresën nr. 889/11, datë 05.04.2024, për akt konstatimin nr.2, datë 28.03.2024 (hyrje në OST SHA nr. 889/3, datë 28.03.2024).

Duke ju referuar që në fillim pjesës së konkluzionit ku përmendet që projekti ishte parashikuar të përfundonte në dhjetor të vitit 2020, por ende nuk ka përfunduar, pra projekti është me 3 vite vonesë deri më datë 23.12.2023, ju sqarojmë se në pikën 2.2 të Marrëveshjes së Huas datë 18.11.2016, parashikohet se afati i fundit për të kërkuar disbursime është data 30.06.2020. Ndërsa në marrëveshjen e veçantë parashikohet që projekti të përfundojë 2017 -2020.

Afati i mësipërm ka qenë vetëm parashikues, pasi realisht vetëm implementimi I projektit për secilin lot, në kushtet normale (edhe pa iu referuar amendimeve përkatëse të deritanishme për të dy lotet dhe të pritshme), do të zgjaste 2 vjet, që nga hyrja në fuqi e kontratave të zbatimit për të dy lotet pa llogaritur këtu, periudhën e domosdoshme për:

- Zhvillimin e procedurës së tenderimit për përzgjedhjen e konsulentit.
- Hartimin nga Konsulenti të raporteve që i paraprijnë procedurës tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit.
- Zhvillimi i procedurës së tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorëve të dy lotëve.
- Fazës së klarifikimit të kontratave dhe hyrjes në fuqi të tyre (disa muaj).
- Fazës së implementimit e cila është penguar dhe rrjedhimisht zgjatuar në kohë nga një sërë faktorësh sikurse janë situatë pandemike Covid 19, lufta Rusi Ukraine, vonesa të tejzgjatura

në zbardhjen e lejeve të ndërtimit, moslejimin nga banka financuese që të nisin punimet në pjesë të linjës/ sheshit ku nuk janë paguar kompensimet e personave të prekur nga projekti.

Për arsyet e mësipërme që dalin jashtë vullnetit të OST SHA është zgjatur periudha e realizimit të projektit dhe për këto arsye për shtyrje janë pranuar si nga banka financuese si dhe nga Këshilli Mbikëqyrës i OST SHA dhe Asambleja e Aksionarëve të OST SHA. Kështu me miratimin e bankës dhe vendimet e organeve të lartpërmendura është amenduar edhe afati i realizimit të projektit.

Shtyrja në kohë e projektit për arsyet që nuk varen nga OST SHA, ndërlihet dhe ka patur impakt të drejtpërdrejtë në ritmet e disbursimeve; në vijimin e pagesës së tarifës së angazhimit – pagesë e cila është detyrim i huamarrësit sipas pikës 3.1 të marrëveshjes së Huas.

Shtyrja në kohë e realizimit të projektit evidentohet në amendimet përkatëse të kontratave të zbatimit për të dy lotet, para lidhjes së të cilave është marrë gjithmonë miratimi I Bankës financuese. Si rrjedhojë është amenduar edhe kontrata e konsulentit pasi është detyrim i huamarrësit OST SHA i parashikuar në Marrëveshjen e Huas që të kontraktojë një konsulent për të mbuluar me konsulencë dhe mbikëqyrje projektin deri në mbylljen e plotë të tij.

Lidhur me kohëzgjatjen e projekteve të reja të marrëveshjes së huas sikurse edhe ju e keni përmendur në akt konstatim, do t'ja parashikojmë huadhënësit afatet e duke marrë në konsideratë afatet ligjore të procedurave.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa keni trajtuar ju pohoni sa është trajtuar në akt konstatimin e mbajtur.

III- Projekti: “Ndërtimi i linjës së transmetimit 400 kV Shqipëri – Kosovë”.

Projekti është i ndarë në dy lote të përfunduara:

Loti i parë përfshin ndërtimin e linjës 400 kV, që për pjesën Shqiptare përbëhet nga plotësimi i qarkut të dytë në pjesën e Linjës 400kV Tirana 2-Podgoricë, për dy qarqe (Segmenti Tirana 2-Vau i Dejës, rreth 80,5 km) dhe segmentin e linjës me një qark Vau i Dejës – Kufi (Morinë) me një gjatësi prej 75 km.

Loti i dytë përfshin pajisjet përkatëse të linjës në Nënstacionet 400kV, instalimin e një shunt reaktori në Nënstacionin 400 kV Tirana 2 për ruajtjen e nivelit të tensionit në rrjetin 400 kV si dhe ndërtimin e një sistemi të kontrollit fuqi-frekuence të përbashkët midis sistemit elektroenergetik të Shqipërisë dhe atij të Kosovës.

KfW nga ana e saj me shkresën më datë 09.08.2013 ka propozuar shtyrjen e afatit të fundit të kërkesës për disbursime dhe rishikimin e grafikut të pagesave të marrëveshjes, si dhe ndryshimin e marrëveshjes ku OST SHA shprehet dakord. Për ndryshimin e marrëveshjes së huas dhe projektit për realizimin e linjës së transmetimit 400 kV Shqipëri - Kosovë për sa i takon afatit të fundit të disbursimit, duke e ndryshuar datën nga data 30.06.2013 në 31.12.2015. Si dhe periudha e ripagesave nga data 30.06.2016-30.12.2024 e detajuar me afate dhe këste si më poshtë:

Tabela 2.3-III/1

Në euro

Kësti	Datat	Shuma (Euro)	Kësti	Datat	Shuma (Euro)
1	30.06.2016	2.333.333,33	10	31.12.2020	2.333.333,33
2	31.12.2016	2.333.333,33	11	30.06.2021	2.333.333,33
3	30.06.2017	2.333.333,33	12	31.12.2021	2.333.333,33
4	31.12.2017	2.333.333,33	13	30.06.2022	2.333.333,33
5	30.06.2018	2.333.333,33	14	31.12.2022	2.333.333,33
6	31.12.2018	2.333.333,33	15	30.06.2023	2.333.333,33
7	30.06.2019	2.333.333,33	16	31.12.2023	2.333.333,33
8	31.12.2019	2.333.333,33	17	30.06.2024	2.333.333,33
9	30.06.2020	2.333.333,33	18	31.12.2024	2.333.333,33

Nga realizimi i projektit janë kursyer 7,394,457 euro. Duke qenë se periudha e disbursimeve është zgjatuar me 1.5 vite dhe kursimit nga huaja, OST SHA me Vendimit e Këshillit Drejtues nr. 14 datë 06.05.2016, për “Miratimin dhe autorizimin ligjor përkatës për përdorimin e fondeve të mbetura të papërdorura nga marrëveshja e huas të ratifikuar me ligjin nr. 10248, datë 11.03.2010 për financimin e projektit Linja e transmetimit 400kV Shqipëri-Kosovë (Tiranë-Prishtinë)” ka vendosur:

1. Miratimin dhe autorizimi ligjor përkatës për përdorimin e fondeve të mbetura të papërdorura nga marrëveshja e huas.

2. Miratimi i një procedure prokurimi sipas udhëzuesit të KfW për fondet e mbetura të kredisë që përfshin: a) zgjerimin e nënstacionit të Komanit (përfshirë nënstacionet dhe linjat); b) shërbimin e konsulentit (që konsiston në amendimin e konsulencës për projektin e ri) që do të përfshijë:

b 1- Design dhe specifikimet teknike (dokumentet e tenderit) ku përfshihen përveç nënstacionit dhe linjave dhe hartimi i specifikimeve teknike që do të nevojitet për procesin e prokurimit të ardhurave të fuqisë me fondet e OST SHA; b 2- supervizimin gjatë implementimit të projektit; b 3- përgatitjen e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Rregullave të Tregut të Balancimit.

Me shkresën me datë 30.05.2016 KfW ka shprehur dakordësinë e saj për mundësinë e zgjerimit të nënstacionit Koman me një transformim 400/220 kV dhe fondet e mbetura të shkojnë 894,195 Euro shërbim konsulence për Lotin 3 dhe 6,500,000 Euro për realizimin e projektit.

Në përfundim të punëve/ shërbimeve /mallrave burimi dhe përdorimi i fondeve paraqitet:

Tabela 2.3-III/2

Në euro

Burimi i fondeve	datë 31.12.2022	Përdorimi i fondeve	datë 31.12.2022
Fonde nga KfW	41,812,666	Shërbime konsulence	2,678,143
Kontributi i OST	20,758,359	Kontrata punime	39,366.470
		Rimbursimet	88,945
		Tarifat e kredisë	20,613,358
Total	62,571,025	Total	62,571,025

Nga kjo kredi kanë mbetur fonde të papërdorura, e konkretisht *Tabela 2.3-III/3*

Kontrata/ kontraktori	shuma e disbursuar në euro
Loti I –K.	27,953,534.62
Loti II- A. A.	4,954,911.00
Loti III- A. S.	6,371,078.64
Shërbime konsulence	2,130,846.90
Shuma totale e disbursuar deri më 31.12.2018	41,410,371.16
Fondet e mbetura	589,628.84

Kontributi i OST për këtë projekt është: *Tabela 2.3-III/4*

Në euro

Kontributi i OST	Vlera
- tarifat e angazhimit	3,685
- interesi i kredisë	6,072,557
- Principali	7,309,053
Total	13,385,296

Konkluzion: Ky projekt rezulton i mbyllur nga ana e financiare me fonde të mbetura në shumën 589,624.84 euro.

3.4- Mbi auditimin e zbatimit të kritereve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshjet me huadhënësit ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Ndërtimi i linjës 400kV Shqipëri-Maqedoni” rezulton se: Me shkresën e datës 07.02.2019, Konsulenti F. ka dërguar draft dokumentacionin e para kualifikimit për Lotin 1 dhe Lotin 2, drejtuar znj. V. dhe Znj. B. përfaqësuese e KfW-së për komente ose për no objection nga ana e KfW-së. Me urdhrin e brendshëm nr. 33, datë 11.02.2019 është ngritur komisioni për dokumentet e tenderit lidhur me “Ndërtimi i linjës 400kV Shqipëri-Maqedoni” të përbërë nga:

- | | | | |
|----|--------|-----|-------|
| 1. | K. S. | 7. | A. N. |
| 2. | A. Sh. | 8. | A. P. |
| 3. | I. P. | 9. | N. D. |
| 4. | F. F. | 10. | A. V. |
| 5. | R. Dh. | 11. | J. K. |
| 6. | G.D. | 12. | M. C. |

Komisioni është ngarkuar që në bashkëpunim me konsulentin të përpunojë dhe të dakordësojnë draftin përfundimtar dokumenteve të tenderit që ti dërgohet për komente/no-objection bankës KfW. Me proces verbalin nr. 2393 Prot., datë 03.04.2019, Komisioni për dokumentet e tenderit shprehet se nuk ka komente të tjera për sa është dakordësuar në mbledhjen e nivelit menaxherial. Pas dërgimit të draft dokumentacionin e para kualifikimit për Lotin 1 dhe Lotin 2, me e-mailin e datës 15.05.2019, KfW ka thyer përgjigje ku shprehet se nuk ka komente apo kundërshtime mbi dokumentacionin e paraqitur ose no objection to the Prequalification Documents for Lot 1 and Lot 2. Me shkresën nr. 3311 Prot., datë 16.05.2019, komisioni për dokumentet e tenderit ka rënë dakord me dokumentacionin e konfirmuar edhe nga ana e KfW-së dhe propozon për vazhdimin nga ana e konsulentit për vendosjen publikimit për ofertat. Me shkresën nr. 3374 prot., datë 20.05.2019 është vendosur për publikimin në faqen elektronike të OST SHA duke filluar nga datat 24.05.2019 gjithashtu me shkresën nr. 3375 Prot., datë 20.05.2019 është vendosur publikimi në dy gazeta shqiptare në datat 24 dhe 25.05.2019. Me urdhrin e brendshëm nr. 174, datë 08.07.2019 është ngritur komisioni për vlerësimin e ofertave lidhur me “Ndërtimi i linjës 400kV Shqipëri-Maqedoni” për Lotin 1 dhe Lotin 2, I përbërë nga:

- | | | | |
|----|--------|-----|--------|
| 1. | K. S. | 7. | B. M. |
| 2. | A. V. | 8. | R. Dh. |
| 3. | I.S. | 9. | N.D. |
| 4. | M.C. | 10. | A. D. |
| 5. | A. Sh. | 11. | K. B. |
| 6. | F. F. | | |

Komisioni është ngarkuar për vlerësimin e ofertave të paraqitura nga kompanitë pjesëmarrëse për të dy lotet në bashkëpunim me konsulentin dhe në përputhje me udhëzimin e KfW-së. Me urdhrin e brendshëm nr. 35, datë 04.02.2020 është vendosur zëvendësimi i kryetarit të KVO-së z. K. S. me z. A. P.

Në datën 10.07.2019 është mbajtur takimi midis përfaqësuesve të OST-së dhe përfaqësuesve të konsulentit F. mbi pranimin e ofertuesve për Lotin 1, ofertuesit që kanë marrë pjesë janë:

- | | |
|---|----------------|
| 1 | I.I., S. |
| 2 | C. I. Y. S. S. |
| 3 | D.J. |
| 4 | E. |

- 5 | K.
- 6 | M. E. and M.C.
- 7 | E.
- 8 | V. E. F. T. & T. D. E.

Në datën 10.07.2019 është mbajtur takimi midis përfaqësuesve të OST-së dhe përfaqësuesve të konsulentit F. mbi pranimin e ofertuesve për Lotin 2, ofertuesit që kanë marrë pjesë janë:

- 1 | E. E. e s.
- 2 | C. I.Y S. S.
- 3 | K. I. L.
- 4 | K.K.
- 5 | L. L.
- 6 | M. H.
- 7 | S.A.
- 8 | S. C. L.
- 9 | T. E. Y E.

Me shkresën nr. 4223/2 Prot., datë 15.07.2019 është mbajtur procesverbali mbi hapjen e zarfeve origjinale të aplikimeve për fazën e parakualifikimit për Lotin 1 dhe Lotin 2.

Me shkresën nr. 7180 Prot., datë 29.10.2019 nga ana e KVO-së është mbajtur procesverbali mbi vlerësimin e kompanive që kualifikohen për në fazën tjetër për Lotin 1 sipas udhëzimeve të KTV-së, kompanitë janë:

- 1 | I. I., S.
- 2 | D.J.
- 3 | E.
- 4 | K./L.
- 5 | M.E.and M. C.

Raporti KVP-së në bashkëpunim me Konsulentin i është dërguar KfW-së për miratim dhe KfW ka kthyer përgjigje me datë 06.11.2019 ku shprehet se nuk ka kundërshtime ose “*No objection to the Prequalification Evaluation Report for Lot 1*”.

Me shkresën nr. 4803/1 Prot., datë 18.11.2019 nga ana e KVO-së është mbajtur procesverbali mbi vlerësimin e kompanive që kualifikohen për në fazën tjetër për Lotin 2 sipas udhëzimeve të KfW-së, kompanitë janë:

1	E. E. e s.
2	C. I. Y S. S.
3	K. I. L.
4	M. H.
5	S.A.
6	T.E. Y E.

Raporti KVP-së në bashkëpunim me Konsulentin i është dërguar KfW-së për miratim dhe KfW ka kthyer përgjigje me datë 09.12.2019 ku shprehet se nuk ka kundërshtime ose “*No objection to the Prequalification Evaluation Report for Lot 2*”. Nga ana e konsulentit janë njoftuar kompanitë të cilat kanë kaluar fazën e parakualifikimit për Lotin 1 dhe Lotin 2.

Ofertat teknike Loti 1: Me urdhrin e brendshëm nr. 11, datë 10.01.2020 është urdhëruar organizimin dhe pjesëmarrjen në terrenin ku do të investohet për procedurën e tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit për Lotin 1 dhe Lotin 2. Grupi i punës për Lotin 1 do të organizohet

në datat 15.01.2020 dhe për Lotin 2 në datën 22.01.2020 në bashkëpunim me Konsulentin. Me shkresën nr. 3686 Prot., datë 18.06.2020 është mbajtur protokoli i mbledhjes midis grupit të punës së OST-së dhe përfaqësuesit të KfW-së znj. A. P. mbi hapjen e zarfeve të paraqitura nga kompanitë e kualifikuara me ofertat e tyre përkatëse. Për këtë proces është marrë konfirmimi nga ana e KfW-së me datë 05.10.2020 me kushtin që ti përcillet një kopje e versionit final të raportit e firmosur nga ana e grupit të punës së OST-së dhe Konsulentit, nga dokumentacioni rezulton se ky kusht është plotësuar. Me shkresën nr. 5923 Prot., 06.10.2020 është mbajtur protokoli i takimit midis grupit të punës së OST-së dhe konsulentit F. mbi vlerësimin e propozimeve teknike të paraqitura nga ana e kompanive për Lotin 1 nga ky vlerësim rezulton se kompanitë e kualifikuara janë:

- | | |
|---|-----------------|
| 1 | D. J. |
| 2 | E. |
| 3 | K./L. |
| 4 | M. E. and M. C. |

KfW ka kthyer përgjigje ku shprehet se nuk ka kundërshtime ose “*No objection to the Technical Bids for Lot 1*”.

Ofertat Financiare: Pas marrjes së konfirmimit “no objection” nga KfW, me shkresën nr. 6688 Prot., datë 05.11.2020 është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave financiare, ofertat financiare të paraqitura nga kompanitë janë si më poshtë:

	Ofertuesit	Vlera në euro
1	D.	25.943.452,00
2	E.	28.863.130,00
3	K./L.	25.999.000,00
4	M. E.and M. C.	24.642.481,08

Me shkresën nr. 6926 Prot., datë 17.11.2020, është bërë vlerësimi i ofertave financiare të paraqitura për Lotin 1, ku është shpallur fitues oferta më e ulët e paraqitur nga kompania M. E. and M. C. Inc-D. sh.p.k. Konsulenti ka propozuar që të vazhdohet me përcaktimin e kushteve të kontratës me Kompaninë fituese pas marrjes së konfirmimit nga ana e KfW-së. Me e-mailin e datës 27.11.2020 KfW ka kthyer përgjigje mbi raportin e paraqitur nga komisioni dhe konsulenti ku shprehet se nuk ka kundërshtime ose “*No objection to the Financial & final Evaluation report for Lot 1*”. Me urdhrin e brendshëm me nr. 7309 Prot., datë 04.12.2020, Administratori i OST-së urdhëron ngritjen e komisionit të klarifikimit të kontratës të projektit “*Ndërtimi i linjës 400kV Shqipëri-Maqedoni*” Loti 1, i përbërë nga:

- | | | | |
|----|-------|----|-------|
| 1. | A. P. | 3. | M. C. |
| 2. | A. V. | 4. | A. A. |

Në datën 11.12.2020 është mbajtur takimi në Stuttgart midis përfaqësuesëve të OST-së, KfW-së, Konsulentit dhe përfaqësuesëve të kompanisë të shpallur fituese për Lotin 1 mbi përcaktimin e kushteve të kontratës së zbatimit. Është arritur dakordësi dhe është nënshkruar kontrata në datën 14.01.2021.

LOTI 2: Është përgatitur raporti përfundimtar nga Konsulenti F. dhe është dërguar për dakordësi KfW-së, ku me emailin e datës 19.11.2019 është kthyer përgjigje nga KfW ku shprehet “*No objection to the tender documents for Lot 2*”. Me urdhrin e brendshëm nr. 11, datë 10.01.2020 është urdhëruar organizimin dhe pjesëmarrjen në terrenin ku do të investohet për procedurën e tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit për Lotin 2, i përbërë nga:

- | | | | |
|----|--------|----|-------|
| 1. | A. P. | 4. | R. Z. |
| 2. | A. Sh. | 5. | A. K. |
| 3. | R. Dh. | | |

Me shkresën nr. 3687 Prot., datë 18.06.2020 është mbajtur protokoll i mbledhjes midis grupit të punës së OST-së dhe përfaqësuesit të KfW-së znj. A. P. mbi hapjen e zarfeve të paraqitura nga kompanitë e kualifikuara me ofertat e tyre përkatëse. Për këtë proces është marrë konfirmimi nga ana e KfW-së. Me shkresën nr. 7308 Prot., 04.12.2020 është mbajtur protokoll i takimit midis grupit të punës së OST-së dhe konsulentit F. mbi vlerësimin e propozimeve teknike të paraqitura nga ana e kompanive për Lotin 1 nga ky vlerësim rezulton se kompanitë e kualifikuara janë:

- | | |
|---|---------------|
| 1 | E.E.e s. |
| 2 | C. I. Y S. S. |
| 3 | M. H. |
| 4 | S. A. |
| 5 | T. E. Y E. |

Pas marrjes së konfirmimit “no objection” nga KfW, me shkresën nr. 7465 Prot., datë 10.12.2020 është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave financiare, ofertat financiare të paraqitura nga kompanitë janë si më poshtë:

	Ofertuesit	Vlera në euro
1	E. E. e s.	21.966.931,00
2	C. I. Y S. S.	27.076.437,57
3	M. H.	20.980.000,00
4	S.A.	25.091.836,34
5	T. E. Y E.	30.908.318,63

Me shkresën nr. 1208 Prot., datë 16.02.2021, është bërë vlerësimi i ofertave financiare të paraqitura për Lotin 2, ku është shpallur fitues oferta më e ulët e paraqitur nga kompania M. S.A. Konsulenti ka propozuar që të vazhdohet me përcaktimin e kushteve të kontratës me Kompaninë fituese pas marrjes së konfirmimit nga ana e KfW-së. Me e-mailin e datës 24.03.2021 KfW ka kthyer përgjigje mbi raportin e paraqitur nga komisioni dhe konsulenti ku shprehet se nuk ka kundërshtime ose “No objection to the Financial&final Evaluation report for Lot 2”. Është arritur dakordësi dhe është nënshkruar kontrata në datën 14.04.2021.

3.5- Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime.

2.5/1- Projekti “Ndërtimi i linjës 400 kV Shqipëri-Maqedonia e Veriut (Fier - Elbasan - Qafë Thanë)”

Projekti zbatohet në dy Lote:

Lot 1 (Linjat) me dy seksione	Kontrata e Lotit 1 është lidhur më 14.01.2021 midis OST SHA. dhe kontraktorit “JV M. E. and M. C.Inc” Turqi & “D.” sh.p.k, Shqipëri. Objekti i kontratës është “Ndërtimi i një linje 400 kV me një qark ndërmjet Elbasanit dhe Qafë-Thanës (kufiri shqiptaro - maqedonas) si dhe ndërtimi i një linje 400 kV me një qark midis Elbasanit dhe Fierit”. Kontrata ka hyrë në fuqi në datë 10.03.2021, është me “çelësa në dorë”, me termin CIP site (vend), në objektin e së cilës përshihen furnizimi i mallrave /pajisjeve, instalimi i tyre dhe punimet e ndërtimit.
-------------------------------	--

Lot 2 (Nënstacione t), me dy seksione	Kontrata e Lotit 2 është lidhur më 14.04.2021 midis OST SHA. dhe Kontraktorit “M. S.A.”- Greqi. Objekti i saj është “Ndërtimi i nënstacionit të ri 400 kV Elbasan 3 si dhe forcimi dhe zgjerimi i nënstacionit ekzistues të Fierit”. Kjo kontratë ka hyrë në fuqi në datë 27.07.2021, është me “çelësa në dorë”, me termin CIP site (vend), në objektin e së cilës përshihen furnizimi i mallrave/pajisjeve, instalimi i tyre dhe punimet e ndërtimit.
--	--

Data e përfundimit të projektit për të dy lotet është parashikuar dhjetor 2025. Projekti për të tre kontratat (përfshirë dhe konsulentin), nuk ka përfunduar dhe është në fazën e zbatimit.

Sa i takon implementimit, nga ana e Kontraktorëve të dy loteve, janë paraqitur klema/shkresa me pretendime të njëpasnjëshme ku janë kërkuar kosto shtesë të konsiderueshme si pasojë e vonesave në marrjen e lejes së ndërtimit, mbajtjes në angazhim për një periudhë të konsiderueshme të resurseve të tyre për këtë projekt, për të nisur mobilizimin dhe me tej punimet.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultojnë nga kontraktorët e të dy loteve, janë paraqitur që në fund të vitit 2021 ankesat/prendimet përkatëse ka patur në mënyrë të vazhdueshme kërkesa të përsëritura për shtyrje afati dhe/ose kosto shtesë për arsye të:

- Forcës madhore të shkaktuar nga pandemia.
- Kushteve të tregut ndërkombëtar të mallrave të ndikuara nga pandemia dhe lufta Rusi – Ukrainë, gjatë vitit 2022 të cilat kanë ndikuar në rritje të çmimit të kontratës.
- Vonesat e shkaktuara nga ana e kontraktorit të lotit i për përfundimin e punimeve në seksionin 1 (zgjerimi i nënstacioneve Rrashbull dhe Tirana 2) si dhe mungesën e mobilizimit të tij sa i takon seksionit 2 (ndërtimi i nënstacionit Tirana 3) e ardhur si pasojë e procesit të riprivatizimit/riorganizimit të kompanisë. Kjo ka sjellë si rezultat njoftimin e ndërprerjes së kontratës për këtë seksion.

Konsulenti/Inxhinieri (Mbikëqyrësi) ka sugjeruar, që të pranohej pretendimi i Kontraktorëve sa i takon rritjes së çmimit kontraktual për mallrat dhe punimet objekt kontrate, duke propozuar aplikimin e një formule të përshkallëzimit të koston, në analogji me klauzolat përkatëse të kontratës FIDIC Yellow. Konsulenti/Inxhinieri ka propozuar formalizimin e këtij përshkallëzimi kostoje, nëpërmjet amendimit të kontratës të secilit lot. Po kështu edhe KfW ka shprehur pranimin për zbatimin e këtij përshkallëzimi kostoje të kontratave të projektit si dhe amendimet e këtyre të fundit për këtë qëllim.

Më tej, me miratimin e Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 10, datë 18.05.2022 “Për kompensimin financiar të çmimit për disa materiale ndërtimi, sipas përcaktimeve në kontratat publike për punë, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg gjatë vitit 2022”, Konsulentit/Inxhinierit dhe KfW-së i është përcjellë ky Akt Normativ. Në vijim të komunikimeve, Konsulenti/Inxhinieri dhe KfW janë shprehur së akti nuk mund të jetë i aplikueshëm për kontratat e zbatimit të dy loteve të këtij projekti, pasi ka mospërputhje me kontratën e projektit tip FIDIC Yellow Book.

Në lidhje me shpronësimet: Në lidhje me shpronësimet, për të dy lotet kanë dalë VKM mbi shpronësimin dhe kompensimin e pronarëve për seksionin 2, ndërsa seksioni 1, implementohet në nënstacionet - pronë e OST-së dhe s’ka patur nevojë për procedurë shpronësimi. Për Lotin 2, kanë dalë VKM-të e shpronësimit për të dy seksionet e këtij loti. Është marrë no-objection nga KfW lidhur me raportin LARP i cili konsiston në kompensimin tërësor të pronarëve sipas legjislacionit shqiptar dhe standardeve ndërkombëtare. Lidhur me këtë mënyrë kompensimi, është ndjekur edhe procedura e marrjes së miratimit nga organet vendimmarrëse të OST-së si Këshilli Mbikëqyrës i OST-SHA dhe Asambleja e Aksionerëve/MFE, përkatësisht me Vendimet nr. 9, datë 31.05.2023 dhe nr. 57, datë 07.08.2023.

Më tej, OST-ja është duke ndjekur procedurat e nevojshme për miratimin e këtij kompensimi, me aktet e nevojshme nënligjore (VKM).

Sipas loteve:

Lot 1 - Linjat) me dy seksione	Kontraktori: M. E. and M. C. I. & D..
---------------------------------------	--

Pas marrjes së njoftimit nga OST-PIU për marrjen e Lejes së Ndërtimit në datën 18 Maj 2023, Kontraktori ka nisur procesin e mobilizimit dhe në datën 17 Gusht 2023 ka dërguar një shkresë, ku ka konfirmuar gatishmërinë për fillimin e punimeve. Procesverbali i dorëzimit të kantierit dhe fillimit të punimeve është nënshkruar më 21 Gusht 2023 nga të gjitha palët: Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), F. C. E. dhe Kontraktori “JV M. E. and M. C. Inc-D. sh.p.k” (Turqi & Shqipëri). Ky i fundit ka nisur punën në segmentin e linjës ajrore Fier-Elbasan, duke kryer punimet civile të themeleve. Deri më 31.12.2023, kanë përfunduar punimet e rrugëve hyrëse për 51 shtylla (për 26 % të shtyllave të planifikuara për këtë segment); gërmimi ka përfunduar për 42 shtylla (për 21 % të shtyllave të planifikuara për këtë segment); mbushja me beton e themeleve për 24 shtylla (për 12 % të shtyllave të planifikuara për këtë segment). Ndërsa punimet e ngritjes së shtyllave përfshijnë 7 shtylla (3,5 % të shtyllave të planifikuara për këtë segment).

Për këtë lot janë kryer amendimet sa vijon:

Amendamenti nr. 1 – datë 02.02.2023: Objekti i këtij Amendamenti është prezantimi i opsionit të rregullimit të çmimit bazuar në kontratën FIDIC Yellow, Nën-klauzola 13.8 (Përshtatjet për ndryshimet në kosto). Për shkak të rritjes së ndjeshme të kostonë së materialeve, pajisjeve elektrike, transportit, fuqisë punëtore dhe energjisë, Kontraktori nuk mund të vazhdojë me zbatimin e projektit. Rritja lidhet me shqetësimet e tregjeve globale të shkaktuara fillimisht nga pandemia Covid dhe më pas nga lufta në Ukrainë.

Me qëllim të minimizimit të rreziqeve dhe kostove të mundshme të përfundimit eventual të kontratës, dhe me synimin për të ruajtur projektin, palët ranë dakord të ndryshojnë kontratën me këtë amendament, duke përcaktuar rregullimet e çmimit, indeksat përkatëse dhe burimet e tyre. të paraqitura në shtojcat 1-3 të amendimit.

Situata e detajuar që çoi në këtë amendim:

Kontraktori ka paraqitur që në fund të vitit 2021 ankesat/ pretendimet përkatëse, ku parashtrojnë vështirësinë e tyre për të rënë dakord me prodhuesit/furnizuesit për blerjen e mallrave/materialeve objekt kontrate, për shkak të rritjes së çmimeve të metaleve në tregun ndërkombëtar si dhe të kostove të punës dhe të transportit, si rrjedhojë e situatës pandemike Covid -19 dhe të situatës së luftës Rusi- Ukrainë.

Konsulenti/Inxhinieri (Mbikëqyrësi) ka sugjeruar në korrespondencat përkatëse që në fillim të vitit aktual, që të pranohet pretendimi i Kontraktorëve sa i takon rritjes së çmimit kontraktual për mallrat dhe punimet objekt kontrate, duke propozuar aplikimin e një formule të përshkallëzimit të kostonë, në analogji me klauzolat përkatëse të kontratës FIDIC Yellow. Sipas Konsulenti/Inxhinierit, përshkallëzimi i kostonë do të aplikohet për rritjen e kostonë së mallrave/materialeve dhe për rritjen e kostonë së pjesës së punimeve dhe të ngritjes/ instalimit. Konsulenti/Inxhinieri ka propozuar formalizmin e këtij përshkallëzimi kostonë, nëpërmjet amendimit të kontratës të secilit lot. Po kështu edhe KfW ka shprehur pranimin për zbatimin e këtij përshkallëzimi kostonë të kontratave të projektit si dhe amendimet e këtyre të fundit për këtë qëllim

Më tej, me miratimin e Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 10, datë 18.05.2022 “Për kompensimin financiar të çmimit për disa materiale ndërtimi, sipas përcaktimeve në kontratat publike për punë, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg gjatë vitit 2022”, Konsulentit/Inxhinierit dhe KfW-së i është përcjellë ky Akt Normativ. Në vijim të komunikimeve, Konsulenti/Inxhinieri dhe KfW janë shprehur së akti nuk mund të jetë i aplikueshëm për kontratat e zbatimit të dy loteve të këtij projekti, pasi ka mospërputhje me kontratën e projektit tip FIDIC Yellow Book (bashkëngjitur letra e konsulentit dhe No-Objection i Bankës). Kështu, referuar neneve respektive të Aktit Normativ: Neni 2, pika 2; Neni 5, pika 2; Neni 5, pika 4; Neni 5, pika 5; Neni 6, pika 3.

Në muajin Korrik 2022, kontraktori i lotit 1, i ka paraqitur OST-së dhe Konsulentit/Inxhinierit, letra ku njofton së në rast të mosmarrjes parasysh të ankesave/premendimeve të tij të vazhdueshme të përcjella që nga viti 2021 për rritjen e çmimit kontraktual, do të ndërpresë kontratën duke iu referuar klauzolave përkatëse të FIDIC, pasi me çmimin aktual dhe kushtet e tregut ndërkombëtar, e ka të pamundur të realizojë detyrimet e tij kontraktuale.

Konsulenti/Inxhinieri dhe banka KfW kanë shprehur në mënyrë të vazhdueshme, opinionin e tyre për zgjidhjen me mirëkuptim të kësaj mosmarrëveshjeje me kontraktorët duke aplikuar përshkallëzimin e kostos, pra rritjen e çmimit kontraktual, duke vënë theksin të vazhdimësia e projektit, pasi një ndërprerje e kontratave të loteve përkatëse nga kontraktorët, do të sillte një sërë pasojash të konsiderueshme për OST-në:

Si rrjedhojë e situatës së mësipërme, OST SHA. i është drejtuar me shkresë MIE-s në cilësinë e Ministrisë propozuese të draft Aktit Normativ Nr. 10, datë 18.05.2022, MFE-së në cilësinë e pronarit dhe Avokaturës së Shtetit si institucioni më i rëndësishëm që përfaqëson dhe mbron interesat e shtetit shqiptar dhe për dijeni KLSH-së me qëllim marrjen e një mendimi juridik të specializuar mbi aplikimin e përshkallëzimit të kostos të kontratave të dy loteve të këtij projekti, bazuar në klauzolat e kontratës FIDIC Yellow nëpërmjet një amendimi, me qëllim shmangien e ndërprerjes së kontratës respektive nga Kontraktorët e të dy loteve.

Avokatura e Shtetit, në përgjigjen e saj thekson së bazuar në Kodin e Procedurave Administrative sipas të cilit: *“nëse për shkak të rrethanave të shfaqura pas lidhjes së kontratës dhe të paparashikueshme në kohën e lidhjes së saj, vazhdimi i ekzekutimit të detyrimeve të kontratës bëhet shumë i vështirë për njërën nga palët kontraktuese, ato mund të bien dakord për ndryshimin apo prishjen e kontratës”*, OST-ja ka diskrecionin për të vendosur ndryshimin e kontratës bazuar në kushtet e marrëveshjes së huas dhe të vetë kontratës objekt ndryshimi (kontrata e zbatimit të projektit).

Ndërsa, MFE-ja, në përgjigjen e saj konkludon: *duke qenë së kemi të bëjmë me marrëdhënie kontraktuale të cilat rregullohen nga legjislacioni ndërkombëtar, si dhe bazuar në klauzolat e kontratës FIDIC Yellow, vlerësojmë së të tilla kontrata/projekte gjejnë vend për të aplikuar përshkallëzimin e kostos nëpërmjet një amendimi, duke mbajtur në vëmendje për zbatim udhëzimet e Avokaturës së Shtetit.*

Në vijim, është firmosur Amendimi i përgatitur nga konsulenti, i miratuar nga KfW dhe dakordësuar nga palët kontraktuale.

Lot 2 - Nënstationet me dy seksione	Kontraktori: M.S.A
--	---------------------------

Pas marrjes së Lejes së Ndërtimit datë 23 Gusht 2023 për nënstationet Fier dhe Elbasan 3, më 19 Shtator 2023, i janë dorëzuar Kontraktorit sheshet e ndërtimit të dy nënstationeve. Procesverbali për dorëzimin e kantierit, përkatësisht për secilin nënstation, është nënshkruar më po këtë datë nga të gjitha palët: Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), F. C. E. dhe Kontraktori “M.

S.A.”- Greqi. Kontraktori është mobilizuar dhe jemi në pritje të njoftimit për të filluar punimet (procedura për fillimin e punimeve duke nënshkruar procesverbalin përkatës me të gjitha palët e përfshira në projekt OST, F. dhe Kontraktori).

Për këtë lot janë bërë këto amendime:

Amendamenti nr. 1 – datë 24.06.2021: Qëllimi i këtij amendimi është zhvendosja e disa zërave në listat e çmimeve si me poshtë: Mallrat dhe pajisjet që do të furnizohen nga brenda vendit të Punëdhënësit, të cilat janë përfshirë në Listën e Çmimeve CIP (mallra) dhe jo si Punime dhe Ngritje, do të zhvendosen, për qëllime faturimi, në pjesën e Listës së Çmimeve që i përket Punimeve dhe Montimit.

Amendament nr. 2 -datë 03.08.2023: Objekti i këtij Amendamenti është prezantimi i opsionit të rregullimit të çmimit bazuar në kontratën FIDIC Yellow, Nën-klauzola 13.8 (Përshtatjet për ndryshimet në kosto). Për shkak të rritjes së ndjeshme të kostonë së materialeve, pajisjeve elektrike, transportit, fuqisë punëtore dhe energjisë, Kontraktori nuk mund të vazhdojë me zbatimin e projektit. Rritja lidhet me shqetësimet e tregjeve globale të shkaktuara fillimisht nga pandemia Covid dhe më pas nga lufta në Ukrainë.

Me qëllim të minimizimit të rreziqeve dhe kostove të mundshme të përfundimit eventual të kontratës, dhe me synimin për të ruajtur projektin, palët ranë dakord të ndryshojnë kontratën me këtë amendament, duke përcaktuar rregullimet e çmimit, indekset përkatëse dhe burimet e tyre. të paraqitura në shtojcat 1-3 të amendimit.

Arsyet:

Kontraktori ka paraqitur që në fund të vitit 2021 ankesat/ pretendimet përkatëse, ku parashtrojnë vështirësinë e tyre për të rënë dakord me prodhuesit/furnizuesit për blerjen e mallrave/materialeve objekt kontrate, për shkak të rritjes së çmimeve të metaleve në tregun ndërkombëtar si dhe të kostove të punës dhe të transportit, si rrjedhojë e situatës pandemike Covid -19 dhe të situatës së luftës Rusi- Ukrainë.

Konsulenti/Inxhinieri (Mbikëqyrësi) ka sugjeruar në korrespondencat përkatëse që në fillim të vitit aktual, që të pranohet pretendimi i Kontraktorëve sa i takon rritjes së çmimit kontraktual për mallrat dhe punimet objekt kontrate, duke propozuar aplikimin e një formule të përshkallëzimit të kostonë, në analogji me klauzolat përkatëse të kontratës FIDIC Yellow. Sipas Konsulentit/Inxhinierit, përshkallëzimi i kostonë do të aplikohet për rritjen e kostonë së mallrave/materialeve dhe për rritjen e kostonë së pjesës së punimeve dhe të ngritjes/ instalimit. Konsulenti/Inxhinieri ka propozuar formalizmin e këtij përshkallëzimi kostonë, nëpërmjet amendimit të kontratës të secilit lot. Po kështu edhe KfW ka shprehur pranimin për zbatimin e këtij përshkallëzimi kostonë të kontratave të projektit si dhe amendimet e këtyre të fundit për këtë qëllim.

Më tej, me miratimin e Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 10, datë 18.05.2022 “Për kompensimin financiar të çmimit për disa materiale ndërtimi, sipas përcaktimeve në kontratat publike për punë, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg gjatë vitit 2022”, Konsulentit/Inxhinierit dhe KfW-së i është përcjellë ky Akt Normativ. Në vijim të komunikimeve, Konsulenti/Inxhinieri dhe KfW janë shprehur së akti nuk mund të jetë i aplikueshëm për kontratat e zbatimit të dy loteve të këtij projekti, pasi ka mospërputhje me kontratën e projektit tip FIDIC Yellow Book (bashkëngjitur letra e konsulentit dhe No-Objection i Bankës).

Kështu, referuar neneve respektive të Aktit Normativ: Neni 2, pika 2: Neni 5, pika 2: Neni 5, pika 4: Neni 5, pika 5: Neni 6, pika 3:

Masat korrektive ndaj operatorit ekonomik (i cili nuk pranon vlerën e vendosur të kompensimit), të parashikuar në këtë pikë, mendojmë së nuk gjejnë vend për kontraktorin në rastin e kontratave tona, pasi:

-zgjidhja e kontratës dhe hapja e një procedure të re duhet të miratohet së pari nga banka KfW, pra nuk vendoset apriori nga OST-ja. Pas miratimit të bankës, zgjidhja e kontratës dhe hapja e një procedure të re do të shoqërohej me kosto të shtuara dhe kohë të gjatë deri në lidhjen e kontratës së re, duke pasur parasysh 3 fazat e procedurës së prokurimit sipas Udhëzimeve të Prokurimit të KfW-se (të detyrueshme për t'u zbatuar për këto procedura tenderimi). Gjithashtu duhen marrë parasysh edhe procedurat për amendimet e Marrëveshjes së Huas (shtyrje të afateve të disbursimit).

-ndaj kontraktorëve nuk mund të zbatohet sanksioni i përjashtimit nga pjesëmarrja në procedura prokurimi të shpallura nga Agjencia e Prokurimit Publik, pasi procedurat e tenderimit të projekteve tona të financuara nga KfW, bazohen jo mbi legjislacionin shqiptar të prokurimit dhe as në koordinimin e shpalljeve me këtë Agjenci, por vetëm në Guideline (Udhëzimet) e Prokurimit të KfW-së si institucioni financiar i këtij projekti.

Konsulenti/Inxhinieri dhe banka KfW kanë shprehur në mënyrë të vazhdueshme, opinionin e tyre për zgjidhjen me mirëkuptim të kësaj mosmarrëveshjeje me kontraktorët duke aplikuar përshkallëzimin e koston, pra rritjen e çmimit kontraktual, duke vënë theksin të vazhdimësia e projektit, pasi një ndërprerje e kontratave të loteve perkatëse nga kontraktorët, do të sillte një sërë pasojash të konsiderueshme për OST-në.

Si rrjedhojë e situatës së mësipërme, OST SHA. i është drejtuar me shkresë MIE-s në cilësinë e Ministrisë propozuese të draft Aktit Normativ Nr. 10, datë 18.05.2022, MFE-së në cilësinë e pronarit dhe Avokaturës së Shtetit si institucioni më i rëndësishëm që përfaqëson dhe mbron interesat e shtetit shqiptar dhe për dijeni KLSH-së me qëllim marrjen e një mendimi juridik të specializuar mbi aplikimin e përshkallëzimit të koston të kontratave të dy loteve të këtij projekti, bazuar në klauzolat e kontratës FIDIC Yellow nëpërmjet një amendimi, me qëllim shmangien e ndërprerjes së kontratës respektive nga Kontraktorët e të dy loteve.

Avokatura e Shtetit, në përgjigjen e saj thekson së bazuar në Kodin e Procedurave Administrative sipas të cilit: *“nëse për shkak të rrethanave të shfaqura pas lidhjes së kontratës dhe të paparashikueshme në kohën e lidhjes së saj, vazhdimi i ekzekutimit të detyrimeve të kontratës bëhet shumë i vështirë për njërën nga palët kontraktuese, ato mund të bien dakord për ndryshimin apo prishjen e kontratës”,* OST-ja ka diskrecionin për të vendosur ndryshimin e kontratës bazuar në kushtet e marrëveshjes së huas dhe të vetë kontratës objekt ndryshimi (kontrata e zbatimit të projektit). Ndërsa, MFE-ja, në përgjigjen e saj konkludon: *duke qenë së kemi të bëjmë me marrëdhënie kontraktuale të cilat rregullohen nga legjislacioni ndërkombëtar, si dhe bazuar në klauzolat e kontratës FIDIC Yellow, vlerësojmë së të tilla kontrata/projekte gjejnë vend për të aplikuar përshkallëzimin e koston nëpërmjet një amendimi, duke mbajtur në vëmendje për zbatim udhëzimet e Avokaturës së Shtetit.*

Në vijim, është firmosur Amendimi i përgatitur nga konsulenti, i miratuar nga KfW dhe dakordësuar nga palët kontraktuale.

II- Kontrata “Programi për eficientë e energjisë në sektorin e transmetimit -ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220 kV Tiranë – Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës”.

Lot 1: N/Stacionet	E. E. e S., S.
--------------------	----------------

Stadi aktual i projektit.

Loti 1:

Për seksionin 1 të këtij loti, afati kontraktual i amenduar i përfundimit të punimeve ka qenë muaji korrik 2022 për nënstacionin Tirana 2 dhe nëntor 2022 për nënstacionin Rrashbull.

Nga ana e Kontraktorit është paraqitur në mënyrë të vazhdueshme një interim claim/prendim, i cili përfshin disa kërkesa të përsëritura për kohë dhe kosto shtesë si rezultat i Forcës Madhore të shkaktuar nga pandemia, duke nisur që nga muaji Mars 2020. Më tej, si rezultat i kushteve të tregut ndërkombëtar të mallrave të ndikuara nga pandemia dhe lufta Rusi – Ukrainë, është paraqitur kërkesa për përshkallëzim të koston – rritje të çmimit kontraktual të kontratës. Në mbledhjen e fundit manaxheriale (shtator 2022) të zhvilluar me Kontraktorin dhe Konsulentin, është përsëritur nga Kontraktori kërkesa e tij për dhënien zgjidhje/pranimin nga OST-ja të klemave të tij, duke amenduar kontratën sa i takon kohës së përfundimit dhe përshkallëzimit të koston, pra rritjes së çmimit të kontratës.

Kontraktori ka paraqitur një Grafik Punimesh të rishikuar, ku ka propozuar përfundimin e punimeve në Nënstacionin Rrashbull në muajin shkurt 2023, ndërsa për punimet në Nënstacionin Tirana 2, ka propozuar afatin e përfundimit të punimeve në muajin prill 2023.

Në kuadër të objektit të kontratës për këtë seksion, është parashikuar edhe lëvrimi dhe instalimi i dy autotransformatorëve të rinj në Nënstacionin e Rrashbullit, shumë të rëndësishëm për përballimin e rritjes së ngarkesave në periudhën e dimrit.

Autotransformatori i parë është instaluar dhe energjizuar në datë 20 korrik 2022, tashmë në operim.

Sa i takon autotransformatorit të dytë, i cili është lëvruar në muajin Dhjetor 2022, nuk është energjizuar dhe vënë në operim por nuk është lëshuar certifikata PTOC, si rrjedhim i problemeve të kontraktorit nuk kanë përfunduar punimet në nënstacionin e Rrashbullit.

Për seksionin 2 që përfshin ndërtimin e nënstacionit të ri Tirana 3, kontraktori ka shtyrë në kohë fillimin e mobilizimit dhe punimeve përtej afateve kontraktuale (qershor 2022).

Gjithashtu nga ana e kontraktorit, është përcjelle kërkesa për kosto kohë/kosto shtesë duke pretenduar rritjen e çmimit të kontratës si për mallra e punime.

Nga ana e OST-së dhe Konsulentit i është tërhequr vëmendja kontraktorit në mënyrë të vazhdueshme mbi mosangazhimin e tyre për mobilizimin dhe fillimin e punimeve.

Në kushtet e këtij mosangazhimi të shprehur të kontraktorit për të plotësuar detyrimin e tij kontraktual për këtë seksion, në mbledhjen manaxheriale të datës 15.12.2022 midis OST-së, Konsulentit dhe KfW-së, është vendosur ritenderimi i këtij seksioni.

Amendimet e kontratës:

Amendimi Nr. 1- datë 03.09.2020: Kontraktori E.-P., është paraqitur kërkesa e datës 01.06.2020 me të cilën kërkohet shtyrje e kohës për implementimin e projektit, sa i takon seksionit nr. 2 të Time Schedulit që ka të bëjë me kryerjen e punimeve. Në kërkesën e tij Kontraktori citon kushtet e kontratës (nenin 2.1. dhe nenin 8.4), ku parashikohet e drejta e tij për akses në sheshin e ndërtimit dhe konkretisht në sheshin e ndërtimit të N/Stacionit të ri Tirana 3 400/110/20 kV, e drejtë - e cila i është penguar nga pronari i tokës. Sqarojmë së përcaktimi i sheshit për ndërtimin e këtij N/Stacioni është bërë nga ana e Bashkisë Tiranë më shkresën 16874/1 datë 21.06.2017, e cila i është dërguar Kontraktorit për t'ia paraqitur pronarit të tokës. Në këtë kërkesë, Kontraktori i është referuar dokumenteve/korrespondencave me të hershme me Konsulentin/Engineer F. (duke filluar nga data 29.12.2019 e deri në datë 21.02.2020), ku është evidentuar pengimi i herëpashershëm i punimeve nga pronari i tokës gjatë punës së subjektit të autorizuar prej Kontraktorit përurvejimin/shpimin e tokës, të cilat do t'i shërbenin Kontraktorit

për hartimin e studimin gjeologjik dhe dizajnin për punimet civile. Ky studim/dizajn është pjesë e dokumentacionit që paraqitet nga Kontraktori, për të aplikuar më tej për marrjen e lejes së ndërtimit.

Për shkak të ndërprerjeve të herëpashershme të punimeve gjeoteknike/gjeologjike në site, kontraktori ka pretenduar në kërkesën e tij të datës 01.06.2020, për një shtyrje prej 17 javësh të kohës së implementimit të projektit, duke filluar nga data 29.11.2019 deri në 28 mars 2020 kur kanë mbaruar punimet gjeoteknike. Lidhur me këtë kërkesë të Kontraktorit, Fichnter- konsulenti ka paraqitur analizën e tij të detajuar, nëpërmjet shkresës të datës 26.06.2020.

Bazuar në kushtet e kontratës (neni 2.1 dhe 8.4 të Kushteve të Përgjithshme & të Veçanta) dhe dokumentet/korrespondencën përkatëse, në këtë analizë të Konsulentit është konkluduar të pranohet shtyrja e kohës, jo që nga data 29.11.2019 (siç pretendon Kontraktori) por nga data 27.01.2020 – deri në datën 28.03.2020 kur kanë mbaruar punimet gjeoteknike, pra 61 ditë.

Nga konsulenti sqarohet së data 27.01.2020 është data nga e cila fillon e drejta e Kontraktorit për të kërkuar shtyrje të kohës, pasi në atë datë Kontraktori (subjekti që kryente shpimet gjeologjike në terren për llogari të Kontraktorit) ka marrë dijeni nga forcat e policisë prezent në terren, së nuk mund të hynin për të bërë shpime në tokën që i përkiste pronarit të saj, pa paraqitur ndonjë kontratë që provon të drejtën e OST-së (ose e ndonjë institucioni tjetër) për të kryer punime aty. Pas shkresave të Kontraktorit për pengimet e vazhdueshme të punimeve nga pronari i tokës, është kërkuar nga ana jonë suporti i organeve policore.

Pas kësaj, Konsulenti ka dërguar Draft-amendimin dhe bashkëngjitur tij praktikën shkresore të lartpërmendur, të cilat përbëjnë anekset e Amendimit. KfW ka dhënë No-Objection datë 21.07.2020.

Në këtë Amendim parashikohet:

-shtyrja me 61 ditë e kohës së implementimit të seksionit nr. 2. Pra përfundimi i këtij seksioni shtyhet në datë 28.05.2022, nga data 22.03.2022 që ishte parashikuar sipas kontratës bazë.

-Paraqitja nga Kontraktori e shtyrjes së Sigurimit të Kontratës.

-Të gjitha klauzolat e tjera të kontratës bazë, do të mbeten të pandryshuara.

Amendimi nr. 2 -datë 23.05.2022: Në vijim të kërkesave/prendimeve të vazhdueshme për shtyrje afati, bazuar mbi Forcën Madhore për shkak të pandemisë Covid-19 – kërkesa të cilat datojnë që nga viti i kaluar si dhe të mbledhjes në nivel menaxherial midis palëve të datës 01.12.2021, Kontraktori ka paraqitur në datë 04.02.2022 Pretendimin Përfundimtar, përmblyllës të këtyre pretendimeve, ku ka propozuar shtyrjen e afateve sa më poshtë:

- Nënstacioni Tirana 2: në datë 26 Korrik 2022.

- Nënstacioni Rrashbull: në datë 18 Nëntor 2022.

- Nënstacioni Tirana 3 dhe punimet në nënstacionet ekzistuese përgjatë linjës së Unazës të Tiranës: në datë 30 Qershor 2023.

Konsulenti ka përgatitur draft-amendimin ku reflektohet shtyrja e afateve kontraktuale sipas datave të mësipërme si dhe bashkëngjitur tij praktikën shkresore përkatëse, të cilat përbëjnë anekset e Amendimit. Draft-Amendimi pasi është rishikuar nga palët, i është përcjellë bankës KfW, e cila ka dhënë No-Objection në datë 26.04.2022.

Amendamenti nr. 3 -datë 21.12.2023: Amendim i diktuar nga situata e kontraktorit: ndryshimi i organizimit strukturor të kompanisë së kontraktorit së aksioneve së bashku me luhatjet e tregut ndërkombëtar të mallrave, të cilat shkaktuan vështirësi të tepruara financiare për E. për të qenë në gjendje të vazhdonte projektin brenda afatit:

E.-ut iu dha nga konsulenti /Inxhinieri një Njoftim zyrtar për Korrigjim më 26 korrik 2022 pasi ato nuk kishin filluar punimet e ndërtimit për Seksionin 2 në përputhje me skedulin e miratuar

me Amendamentin Nr.2. Në mbledhjen mujore shtatori 2022, E. njoftoi së për shkak të inflacionit të kostos në lidhje me luftën në Ukrainë dhe pandeminë Covid-19, ata nuk mund të kryenin punime të mëtejshme për Seksionin-2 pa një përshkallëzim të Çmimit të Kontratës. në takimin pasardhës tetor 2022, E. informoi së për shkak të shitjes (riorganizmit) të kompanisë së tyre së kishte një embargo efektive për lirim të pagesave të projektit për furnitorët, të cilat nuk mund të zgjidheshin vetëm pasi të ishte përfunduar shitja e kompanisë. Pas një takimi midis palëve kontraktuale në nivel të lartë menaxherial më 28 shtator 2022, E.-u dorëzoi një propozim të ri për përshkallëzimin e kostos (çmimit të kontratës).

Nëpërmjet njoftimit të konsulentit/Inxhinieri, datë 08.03.2023 E.-ut iu dha njoftimi për qëllimin e Punëdhënësve për të përfunduar Kontratën bazuar në mospërmbushjen e saj. Pas përgjigjes së E.-ut datë 10.03.2023, palët kontraktuale ranë dakord reciprokisht të përpiqeshin të lidhin një marrëveshje miqësore dhe të binin dakord për një amendim që do të hiqte Seksionin-2 nga objekti i kësaj kontrate, ndërkohë që E. do të vijonte të plotësonte pjesën e mbetur të Seksionit-1. Inxhinieri ka përgatitur dokumentin “Korniza për zgjidhjen miqësore” i cili i është shpërndarë punëdhënësit dhe kontraktorit më 31.05.2023. E. bëri një propozim të rinovuar për të përfunduar seksion 2 (nënstacioni Tirana-3) deri më 31.12.2024 nëpërmjet letrës së tyre datë 29.06.2023, për të cilën ata besonin së tani ishte e realizueshme pasi blerësi i kompanisë E. tashmë ishte konfirmuar. Deri momentin e lidhjes së këtij Amendimi, kishte përfunduar riprivatizimi i E. Pas diskutimeve të mëtejshme, E. paraqiti një propozim të rishikuar për përshkallëzimin e kostos, datë 08.08.2023.

Ky amendament ka të beje me:

- Përshkallëzim të çmimit të kontratës
- zgjatje të Kohës së Përfundimit të Seksionit 2 të Kontratës.
- amendim për rritjen e vlerës (çmimit të kontratës) vetëm për seksionin 2.

Lot 2: Linjat	E. d. S.
----------------------	----------

Stadi aktual i projektit.

Loti 2:

Për seksionin 1 të këtij loti, afati kontraktual i amenduar i përfundimit të punimeve ka qenë muaji prill 2021, ndërsa për seksionin 2, afati i përfundimit ka qenë në muajin maj 2022.

Kontraktori ka kërkuar së fundmi amendimin e kontratës, me kohë shtesë dhe rritje të çmimit (përshkallëzim kostoje). Nga ana e Kontraktorit janë paraqitur në mënyrë të vazhdueshme interim claim që përfshijn disa klema, duke nisur që nga muaji mars 2020:

Klema 1 dhe 2: kohë dhe kosto shtesë si rezultat i Forcës Madhore të shkaktuar nga pandemia;

Klema 3- rritje e çmimit kontraktual për pjesën e kontratës: Mallra;

Klema 4: rritje e çmimit kontraktual për pjesën e kontratës: Punime;

Klema 5- rritja e çmimit të kontratës për pjesën Mallra dhe Punime dhe kohë shtesë.

Kjo e fundit është paraqitur me letrën e datës 12.10.2022, duke iu referuar rritjes së çmimit të materialeve/metaleve në tregun ndërkombëtar si dhe rritjes të çmimit kontraktual për Punimet, si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia dhe lufta Rusi-Ukrainë. Kontraktori është shprehur se deri në marrjen parasysh nga OST-ja të kërkesës së tij për përshkallëzimin e kostove të kontratës, është i detyruar të ndërpresë punimet.

Kontraktori ka paraqitur një Grafik Punimesh të rishikuar, ku propozon përfundimin e punimeve për seksionin 1 (linja Tirana 2- Rrashbull) në qershor 2023, ndërsa për seksionin 2 (Linja unazore e Tiranës) në dhjetor 2023.

Në mbledhjen menaxheriale të datës 15.12.2022 midis OST-së (bashkëngjitur), Konsulentit dhe KfW-së, është vendosur ndryshimi/reduktimi i objektit të kontratës, duke bërë të nevojshme amendimin e kontratës me Kontraktorin për këtë qëllim.

Amendimet e kontratës:

Amendamenti 1: Amendimi i kushteve të veçanta të kontratës pas procesit të negocimit sa i takon:

-kushteve për hyrjen në fuqi të kontratës (me nënshkrimin e këtij amendamenti u be hyrja në fuqi e kontratës të Lotit 1 në 06.05.2019)

-Si pasoje e procesit të diskutimeve me KfW, ne amendim është parashikuar mospagimi i paradhënies Kontraktorit nga OST (si dhe mosparaqitja nga kontraktori e Sigurimit të Paradhënies) - nga KfW.

-amendimi i kushteve të pagesës.

Amendamenti 2 –datë 15.10.2020: a) Gjatë mbledhjes mujore të datës 12.02.2020 të mbajtur midis OST/Employer, Kontraktorit dhe Konsulentit/Engineer mbi ecurinë e projektit është njoftuar nga ana jonë, marrja e një shkrese nga Bashkia Tiranë (nr. 4755 Prot., datë 30.01.2020) ku përcaktoheshin zonat e veçanta, të cilat duhet të shmangeshin gjatë ndërtimit të linjës ajrore Tirana 3- Traktori.

Menjëherë pas mbledhjes (datë 13.02.2020) ka patur një korrespondencë të brendshme me DRRT (shkresa nr. 883/2, datë 13.02.2020), ku nga kjo e fundit i është dërguar PIU- t zgjidhja teknike për të arritur shmangien e kërkuar në letrën e bashkisë. Kjo zgjidhje teknike i është bërë me dije Konsulentit për t'ia dërguar më tej kontraktorit zyrtarisht. Konsulenti në cilësinë e Engineer-it, i ka përcjellë kontraktorit me shkresën e datës 17.02.2020 një planimetri me ortofoto të zonave të lartpërmendura, të cilat duhej të shmangeshin, si dhe i ka sugjeruar zgjidhjen teknike për të realizuar shmangiet e kërkuara. Konsulenti i ka kërkuar kontraktorit që në bazë të parashikimeve të kontratës, të paraqiste propozimin me shkrim për ndryshimin e projektit.

Për këtë qëllim u organizua në datë 26.02.2020 një site visit me pjesëmarrjen e OST/Employer, Kontraktorit dhe Konsulentit/Engineer dhe në vijim Kontraktori paraqiti me shkresën e datës 18.04.2020 propozimin e projektit të ndryshuar, duke kërkuar edhe një kohë shtesë prej 4 javësh për përfundimin e seksionit 2 të Lotit 2. Propozimi i projektit të ndryshuar gjeti aprovimin e sektorit të projekteve të DRRT-së. Në përfundim u dakordësuar një kohë shtesë prej 2 javësh për përfundimin e këtij seksioni.

b) Gjatë mbledhjes së datës 17.03.2020, OST/Employer njoftoi Kontraktorin për një problem lidhur me linjën ajrore Tirana 3-Selita, seksioni 2 të Lotit 2, për të cilin ishte bërë me dije së për një parcelë toke ku ishte planifikuar të kalonte kjo linjë, bashkia kishte dhënë miratimin për një projekt tjetër (shkresa drejtuar OST-së e zhvilluesit të projektit tjetër A.-K. si dhe dokumentacioni) dhe linja duhej të devijojë për ta shmangur atë.

Për këtë qëllim ka patur një komunikim të brendshëm me sektorin e projekteve dhe sektorin e shpronësimeve pranë DRRT-së, përkatësisht lidhur me gjetjen e një zgjidhjeje teknike si dhe konstatimin e gjendjes juridike të parcelës (ekzistenca e një leje zhvillimore të dhënë A. K.-it). Kjo zgjidhje teknike i është bërë me dije Konsulentit për t'ia dërguar më tej kontraktorit zyrtarisht. Konsulenti në cilësinë e Engineer-it, i ka dërguar kontraktorit shkresën e datës 26.05.2020 ku i ka sugjeruar një rregullim alternativ të trasesë së linjës si dhe i ka kërkuar që në bazë të parashikimeve të kontratës, kontraktori të paraqiste propozimin me shkrim lidhur me ndryshimin e projektit.

Nëpërmjet korrespondencës: shkresës së datës 03.06.2020 të Kontraktorit dhe përgjigjes së konsulentit me shkresën e datës 12.06.2020, u diskutuan dhe dakordësuar zgjidhjet teknike dhe letër propozimi i kontraktorit për amendimin u paraqit në datë 15.06.2020. Në këtë letër propozim u kërkua kohë shtesë prej 15 ditë pune ose 3 javë si dhe 5000 Euro kosto shtesë, të cilat gjetën miratimin e OST/F. Site visit (OST/Employer, Kontraktorit dhe Konsulentit/Engineer), e cila ishte e domosdoshme për të analizuar vendet e reja të propozuara, u arrit të bëhej vetëm më 10 shtator 2020, si rezultat i pengesave nga situata e Covid-19. Pas kësaj u vijua me paraqitjen nga kontraktori të propozimit për ndryshimin e trasesë së linjës - propozim i cili u miratua nga sektori i projekteve të DRRT-së.

Konsulenti ka përgatitur dhe dërguar Draft-amendimin dhe bashkëngjitur tij praktikën shkresore të lartpërmendur, të cilat përbëjnë anekset e Amendimit.

Draft-Amendimi pasi është rishikuar nga ana jonë dhe kontraktori, i është përcjellë bankës KfW, e cila ka dhënë No-Objection në datë 5.10.2020.

Në këtë Amendim parashikohet:

-Shtyrja e kohës së përfundimit të seksionit 2 të Lotit 2 me 35 ditë kalendarike. Ndërsa koha e përfundimit të seksionit 1 të Lotit 2 ngelet e njëjtë si në kontratën bazë 24 muaj.

-Vlera e kontratës bazë për lotin 2 prej 18,405,408.36 Euro, shtohet me 5000 Euro.

-Paraqitja nga Kontraktori e shtyrjes së Sigurimit të Kontratës.

-Të gjitha klauzolat e tjera të kontratës bazë, do të mbeten të pandryshuara.

Amendamenti 3 –datë 29.01.2021: Kontraktori “E.”, duke ndjekur Testet Tip për shtyllat 400 kV dhe 110 kV, ka konstatuar së në ofertën e tij, këto teste ishin përfshirë si çmime CIP (sikurse mallrat), në vend që të ishin të përfshirë në pjesën Price Schedule për Punime. Për qëllime të faturimit të këtyre testeve, është kërkuar nga Kontraktori që të lejohet të bëjë rivendosjen e këtyre zërave në vendin e duhur të Price Schedulit.

Kjo kërkesë iu përcoll nga Kontraktori konsulentit (Engineer) F. dhe pasi u konsiderua i pranueshëm nga ky i fundit, u përgatit draft-Amendimi me qëllim dakordësimin e të dyja palëve kontraktuale, për zhvendosjen e këtyre zërave nga lista e çmimeve CIP të mallrave të lista e çmimeve për Punime, duke e evidentuar këtë zhvendosje në Aneksin nr. 2, bashkëngjitur këtij Amendimi (nr. 3). Të gjitha kushtet e tjera kontraktuale, nuk preken nga ky Amendim.

Pasi draft-Amendimi i konsulentit u dakordësua nga Punëdhënësi OST dhe Kontraktori Energoinvest dhe nga KfW u mor No Objection në datë 11.01.2021.

Amendamenti 4 – datë 03.03.2021: Kontraktori “E.”, ka paraqitur disa kërkesa me radhë (datë 20.03.2020, 08.06.2020 dhe 10.09.2020 - bashkëngjitur) për shtyrje kohe dhe pagim dëmsh (kosto shtesë), duke pretenduar së ka qenë në kushtet e Forcës Madhore, si rezultat i situatës pandemike të Covid 19.

Konsulenti ka bërë një analizë të detajuar (datë 17.11.2020) të kërkesave të Kontraktorit, duke propozuar pranimin nga ana jonë të një shtyrjeje prej 75 ditësh: nga 15 Mars 2020 deri në 29 Maj 2020 – kohë kur ishte periudha e lockdoën-it në Shqipëri. Në analizë është hedhur poshtë kërkesa e kontraktorit për pagesë të dëmeve të pretenduara të shkaktuara nga kjo situatë (kosto shtesë), duke qenë së ky pretendim nuk gjen mbështetje në kontratë. Pas mbledhjes (audio konferencë) të mbajtur midis palëve: OST – E. si dhe nën drejtimin e F. (Engineer), u konkluduar vetëm për sa ka propozuar konsulenti në analizë si dhe për formalizimin e këtij konkludimi në një amendament të kontratës.

Nga ana e F. u përgatit draft-Amendimi nr. 4 dhe pasi u dakordësua nga Punëdhënësi OST, Kontraktori Energoinvest dhe nga KfW u mor No Objection.

Në këtë Amendim parashikohet:

- Shtyrja e kohës së përfundimit të seksionit 1 dhe seksionit 2 me 75 ditë kalendarike secili.
- Çmimi i kontratës bazë për këtë lot bëhet 18,320,418.36 Euro. Kjo për arsye së nga çmimi fillestar i kontratës për këtë lot, u zbrit vlera që kanë në Skedulit e Çmimeve të Kontraktorit shpenzimet për pjesëmarrjen tonë si Employer në disa testimet në fabrikë. Për shkak të situatës pandemike nuk pati pjesëmarrje nga ana jonë.
- Paraqitja nga Kontraktori e Time Schedulit të rishikuar duke përfshirë këtë kohë shtesë.
- Paraqitja nga Kontraktori e shtyrjes së Sigurimit të Kontratës.
- Të gjitha klauzolat e tjera të kontratës bazë, do të mbeten të pandryshuara.

Amendamenti 5 –datë 14.02.2022: Gjatë kësaj faze të projektit, janë evidentuar situatat e mëposhtme:

- Për shkak të situatës së Covid 19, OST-ja nuk ka marrë pjesë në testet e pranimit në fabrikë të disa pajisjeve (OPGW/izolatorë), kështu që zërat përkatës të shpenzimeve të Kontraktorit që do të mbulonin një pjesëmarrje të tillë të parashikuara në Listën e Çmimeve, nevojiteshin të hiqeshin prej saj (listës);
- Pas miratimit Inxhinier-OST të projektit përfundimtar të Kontraktorit, nevojitej që të përditësohej Lista e Çmimeve në përputhje me sasinë e korrigjuara të pajisjeve (shtylla, bazamente, përçues dhe OPGW) që rezultuan nga ky projekt.
- Pas miratimit Inxhinier-OST të projektit përfundimtar të linjës Tirana 2 - Rrashbull të paraqitur nga Kontraktori dhe vizatimeve përkatëse, nevojitej të bëhej rregullimi i çmimit lidhur me diferencën e vërejtur në peshën e shtyllave 400 kV. Rregullimi i çmimit është bërë me anë të formulës llogaritëse të pranuar nga palët në mbledhjen e datës 14.11.2018 për qartësimin e kontratës (dokumenti MoM në shtojcën nr. 4, bashkëlidhur Amendimit).

Lidhur me situatat e mësipërme, nga ana e Inxhinierit u përgatit draft-Amendimi nr. 5 dhe pasi u dakordësua nga OST, Kontraktori E. dhe nga KfW u mor No Objection në datë 27.01.2022.

Në këtë Amendim parashikohet:

- Çmimi i kontratës bazë për këtë lot bëhet 18,703,913.55 Euro.
- Kjo për arsye së nga çmimi i kontratës për këtë lot u zbritën vlera që kanë në Listën e Çmimeve të Kontraktorit shpenzimet për mospjesëmarrjen tonë si Employer në testimet në fabrikë dhe vlera për shkak të reduktimit të peshës së shtyllave si dhe u shtua vlera për shkak të ndryshimeve në projekt.*
- Paraqitja nga Kontraktori e shtyrjes së Sigurimit të Kontratës.
- Të gjitha klauzolat e tjera të kontratës bazë, do të mbeten të pandryshuara.

Amendamenti 6: Gjatë muajit Dhjetor 2021 nga E. është dorëzuar dokumentacioni për lëvrimin e parë të kablllove. Në mbledhjen mujore të datës 16.12.2021, nga ana e Konsulentit/Inxhinierit u shpreh së sasinë e kabullit nuk përputheshin me dizajnin e propozuar dhe u kërkua një shpjegim teknik nga E. për sasinë e lëvruara, pasi ato ishin sjellë të pasqyruara në faturë “si lëvrime në fakt” (Shtojca 1 e amendamentit).

Në mbledhjen teknike të datës 21.12.2021, E. ka paraqitur një tabelë me disa përlllogaritje ku tregohet së sa do të jetë gjatësia reale e kablllove për të cilën do të faturojnë (Shtojca 2). Pas takimit u ra dakord që OST-ja të kompensohet për gjatësinë e matur të kabullit “vetëm siç është shtruar”. Në rast së pjesa CIP-it (Skedulit të Çmimeve për Mallrat) tejkalohej për ndonjë nga linjat kablllore, atëherë E. do të kompensojë OST-në me vlerën e plotë të shtesës duke përfshirë rimbursimi e çmimit të TVSH-së. Shuma e kompensuar do të rikuperohet nga Mbajtja e Parë (Shtojca 3 e amendamentit).

Lidhur me situatat e mësipërme, nga ana e Inxhinierit u përgatit draft-Amendimi nr. 6 dhe pasi u dakordësua nga OST, Kontraktori E. dhe nga KfW u mor No Objection.

Bazuar në parashtrimin e mësipërm, në këtë Amendim parashikohet:

-Çmimi i kontratës bazë për këtë lot bëhet 18, 838,064.23 Euro.

-Paraqitja nga Kontraktori e shtyrjes së Sigurimit të Kontratës.

-Të gjitha klauzolat e tjera të kontratës bazë, do të mbeten të pandryshuara.

Amendamenti 7: Kontraktori ka paraqitur një kërkesë për shtesë kohe për implementimin e Lotit 2 të projektit, duke qenë së gjatë vitit 2022 kishte hasur vështirësi nga autoritetet boshnjake për transferimin e fondeve nga Bosnja në Shqipëri me qëllim pagesën e detyrimeve përkatëse të lidhura me këtë projekt, për shkak së afati i kontratës OST & E. ka përfunduar.

Kontraktori informoi Inxhinierin për sa më sipër si dhe ka kërkuar lëshimin e dy letrave nga ana jonë, që vërtetojnë së ka një kontratë midis palëve tona dhe së kjo kontratë do të zgjatej në vijim.

Lidhur me situatat e mësipërme, nga ana e Inxhinierit u përgatit draft-Amendimi nr. 7 dhe pasi u dakordësua nga OST, Kontraktori E. dhe nga KfW u mor No Objection.

Bazuar në parashtrimin e mësipërm, në këtë Amendim parashikohet:

- Shtyrja e afatit kontraktual për të dy seksionet këtij loti deri në 30 Qershor 2023.

- Të gjitha klauzolat e tjera të kontratës bazë, do të mbeten të pandryshuara.

Amendamenti 8: Nga ana e Kontraktorit janë paraqitur në mënyrë të vazhdueshme kërkesa/pretendime për kohë shtesë dhe rritje të çmimit kontraktual, nisur që nga muaji mars 2020 e deri në tetor 2022, duke iu referuar rritjes së çmimit të materialeve/metaleve në tregun ndërkombëtar si dhe rritjes të çmimit kontraktual për Punimet, si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia dhe lufta Rusi-Ukrainë. Këto kërkesa/pretendime janë shqyrtuar dhe dhënë të detajuara në Raportin e Analizës së Kërkesave të hartuar nga Konsulenti/Inxhinieri (në Aneksin-1 të këtij amendimi), referuar kryesisht kërkesave nr. 3-5 të kontraktorit. Në këtë raport-analizë është pranuar pretendimi i kontraktorit për shtyrje të afatit kontraktual si dhe përshkallëzimi i kostos. Pra bazuar në këtë raport- analizë, është bërë rishikimi i Listave të Çmimeve (të cilat janë të përfshira në Aneksin 2 të këtij amendimi) ku janë pasqyruar: reduktimi i sasisë/zërave të punimeve pjesë e objektit të kontratës bazë; rishikimi i zërave të punimeve që ende nuk kanë filluar si dhe zëra shtesë lidhur me linjën për punime të cilat tashmë janë ndërmarrë më parë dhe që trajtohen në raport- analizë.

-Duke qenë së nga Bashkia Durrës është konstatuar së shtylla nr. 8 e linjës Tirana 2 -Rrashbull, ishte planifikuar sipas trasesë të linjës, që të pozicionohej pranë argjinaturës të digës Xhafzotaj, është zhvilluar një korrespondencë e gjatë e OST-së me institucionet përkatëse si Bashkia Durrës, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Komiteti Kombëtar i Digave për zgjidhjen e këtij problemi si dhe takime të here pas hershme, ku është kërkuar prej tyre zhvendosja e kësaj shtylle. Në përfundim, është dakordësuar midis OST SHA. dhe Bashkisë Durrës zhvendosja e shtyllave nr. 8 dhe nr. 9, të kësaj linje ajrore. Në vijim të kërkesë-aplikimit përkatës drejtuar Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, i është përcjellë OST-së, Vendimi i Këshillit të Basenit Ujor Erzen, me të cilin miratohet Autorizimi për OST-në për ndërtimin e shtyllave nr. 8 dhe nr. 9 në ujëmbledhësin Xhafzotaj sipas koordinatave të përcaktuara në këtë vendim. Korrespondenca përkatëse për këtë pikë, ndodhet në Aneksin 3 të këtij amendimi.

-Duke qenë së Punëdhënësi OST nuk ka marrë pjesë në disa testime në fabrikë, të cilat ishin parashikuar në kontratë dhe përfshiheshin në Listën e Çmimeve të Kontratës dhe meqenëse nuk kërkohej teste të mëtejshme të pranimit në fabrikë, sasisë/zërat janë rregulluar në përputhje me rrethanat. Kjo pasqyrohet në Listën e rishikuar të Çmimeve të përfshira në Aneksin 2 të këtij amendimi.

-Duke qenë së nga Kontraktori nuk kërkohet asnjë rrugë aksesi e përhershme, atëherë zërat përkatës në Listën e rishikuar të Çmimeve të përfshira në Aneksin 2 të këtij amendimi, janë reduktuar në zero.

Lidhur me situatat e mësipërme, nga ana e Inxhinierit u përgatit draft-Amendimi nr. 8 dhe pasi u dakordësua nga OST, Kontraktori E. dhe nga KfW u mor No Objection në 12 korrik 2023.

Bazuar në parashtrimin e mësipërm, në këtë Amendim parashikohet:

- *Shtyrja e afatit kontraktual: 10 muaj nga hyrja në fuqi e këtij amendimi;*
- *Si pasojë e arsyeve të lartpërmendura, çmimi i kontratës bëhet 19,904,234.94 Euro;*
- *Paraqitja e garancisë bankare të Sigurimit të Kontratës, e rishikuar në përputhje me çmimin e mësipërm kontraktual.*
- *Hyrja në fuqi e amendimit: pas marrjes së “No objection” të bankës dhe nënshkrimit nga palët.*
- *Të gjitha klauzolat e tjera të kontratës bazë, do të mbeten të pandryshuara.*

3.6- Mbi administrimin e veprave të dorëzuara, funksionimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve.

I- “Linja 400 kV Shqipëri – Kosovë”

Marrja në dorëzim e kësaj linje është realizuar sipas hapave të mëposhtëm:

Taking Over Certificate dhe Performance Certificate, “Linja 400 kV Shqipëri – Kosove”,

Loti 1 LINJA

1. Certifikata e Marrjes në Dorëzim (Taking Over Certificate – TOC)

Data	Procesi
15.03.2016	E. njofton përfundimin e punimeve në segmentin e parë të linjës (Tirana 2- Vau i Dejës). 11.03.2016
17.03.2016	Urdhri i Brendshëm për kontrollin paraprak të punimeve në segmentit e parë të linjës – kontroll ky që kryhet përpara procesit të energjizimit.
04.04.2016	Grupi i punës ka hartuar Relacionin e Kontrollit Paraprak të segmentit të parë të linjës.
17.05.2016	E. njofton së punimet kanë përfunduar për segmentin e dytë të linjës (Vau i Dejës – Morinë).
18.05.2016	Pas këtij njoftimi ka dalë Urdhër i brendshëm mbi kontrollin paraprak të segmentit të dytë të linjës.
30.05.2016	Është hartuar nga grupi i punës, Relacioni i Kontrollit Paraprak për segmentin e dytë të linjës, nga ku ka rezultuar së segmenti është gati për energjizim.
03.06.2016	Ka dalë urdhri i brendshëm për ngritjen e Grupit të Kolaudimit për segmentin e parë të linjës (Tirana 2 deri Vau i Dejës)
13.06.2016	Ka dalë Akt Kolaudimi për segmentin e parë të linjës, nga ku rezultoi pas kalimit të testimeve përkatëse, së punimet janë kryer sipas projektit dhe nuk ka rezultuar asnjë defekt/vërejtje.
13.06.2016	Është hartuar një relacion – vazhdim i kontrollit paraprak të punimeve të segmentit të dytë të linjës të datës 30.05.2016. Kontrolli i segmentit të dytë të linjës ka përfunduar me 15.06.2016 (Relacionin Përfundimtar i datës 15.06.2016) ku përcaktohet së vërejtjet nuk ndikojnë në procesin e energjizimit.
21.06.2016	Ka dalë urdhri i brendshëm për ngritjen e Grupit të Kolaudimit për segmentin e dytë të linjës
28.06.2016	Ka dale Akt Kolaudimi për segmentin e dytë të linjës, pas kalimit të testimeve përkatëse dhe ka bashkëngjitur listën e vërejtjeve për t'u ndrequr nga Kontraktori.
26.08.2016	E. paraqet kërkesën për lëshimin e TOC.
16.09.2016	Ka dale Akti Përfundimtar i Kolaudimit (Final Inspection Report) për segmentin e dytë të linjës, ku është evidentuar së Kontraktori ka ndrequr listën e vërejtjeve të lëna me Akt Kolaudimin e datës 28.06.2016.
21.09.2016	Është lëshuar Certifikata e Marrjes në Dorëzim - Taking Over Certificate (TOC). Konsulenti ka paraqitur draft- Performance Certifikatën, e cila pasi është dakordësuar nga palët kontraktuale, është lëshuar e nënshkruar nga OST, Konsulenti dhe Kontraktori.
16.12.2016	PIU i drejtohet sektorit të Drejtorisë së Shfrytëzimit Mirëmbajtjes për marrjen në shfrytëzim të punimeve të Linjës.

2. Certifikata e Përfundimit (Performance Certificate – PC)

Data	Procesi
16.10.2017	Meqenëse në Dhjetor 2017 përfundonte afati i garancisë teknike të punimeve të kryera, doli Urdhri i Brendshëm për ngritjen e grupit të punës për rikontrollimin e këtyre punimeve.
27.10.2017	Grupi i punës paraqiti një Relacion ku evidentoheshin problematikat/defektet e konstatuara në terren
07.11.2017	OST i ka kërkuar me shkresë kontraktorit, që të ndreqe problematikat/defektet që rezultuan nga kontrolli.
14.11.2017	E. i ka kthyer përgjigje OST-se që do të inspektoje në vend problematikat/defektet për zgjidhjen e tyre.
21.12.2017	E. ka paraqitur kërkesën për lëshimin e certifikatës së Përfundimit (Performance Certificate) (hyrje në OST 28.1.2017)
10.01.2018	Grupi i punës, ka bërë një rikontroll për të gjitha problematikat/defektet e konstatuara në relacionin e datës 27.10.2017.
